

BIBLIOTEKA

949.65

837



SH. DEMIRAJ

K. PRIFTI

# KONGRESI I MANASTIRIT


949.65

15 37

SH. DEMIRAJ — K. PRIFTI

No fushat e terezit armen që vinte  
fotile te heq që bese që te shkrua  
ajo, te shypile u shkrua që Shqipetar  
do  
**KONGRESI I MANASTIRIT**  
**NGJARJE ME RËNDËSI**  
**NË LËVIZJEN KOMBËTARE SHQIPTARE**

(Me rastin e 70-vjetorit të tij)



SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

Në kushtet e terrorist otoman nuk ishte lehtë të bëje atë që bënë ata — të shkruaje, të shtypje e të dërgoje në Shqipëri mijëra abetare e libra të tjerë, të hapje shkollën e parë shqipe më 1887, të organizoje një Kongres të tërë si ai i Manastirit për caktimin e alfabetit unik shqip. Dhe të tëra këto patën pa dyshim reperkusione të mëdha, të cilat gjetën pasqyrimin e tyre më të mirë në rritjen e vrullshme të lëvizjes revolucionare dhe të kryengritjes së armatosur.

**ENVER HOXHA**

## P A R A T H È N I E

Këtë vit populli shqiptar së bashku me 100-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit (1878-1881), që përbën një nga periudhat më të rëndësishme në luftën e tij për mbrojtjen e tërësisë territoriale të vendit dhe për çlirimin kombëtar, kremton edhe 70-vjetorin e Kongresit të Manastirit (1908) që është një ngjarje e shënuar në luftën për zhvillimin e kulturës kombëtare dhe demokratike shqiptare, për lëvrimin e gjuhës shqipe.

Ndonëse ndahen prej njëra-tjetrës nga disa dhjetëvjeçarë, të dyja këto ngjarje janë të lidhura ngushtë dhe përbëjnë dy hallka në vargun e përpjekjeve shekullore që populli shqiptar ka bërë «me pushkë dhe me penë» për të mbrojtur ekzistencën e vet kombëtare, për të siguruar lirinë dhe pavarësinë e vendit. Si Lidhja Shqiptare e themeluar në Prizren ashtu edhe Kongresi i Manastirit i kanë rrënjet e tyre në luftën shumëshekullore të popullit shqiptar kundër pushtuesve të huaj që shkelën truallin shqiptar, kundër reaksionit feudal osman dhe atij klerikal, kundër qarqeve shoviniste fqinje dhe Fuqive të Mëdha që i përkrahnin ato. Në zjarrin e kësaj lufte të pabarabartë, nëpërmjet sakrificash të mëdha, me çmimin e gjakut të mijëra patriotëve, populli ynë

*krijoi dhe mbrojti kulturën kombëtare demokratike shqiptare.*

Në këtë broshurë përveç punimeve të Kongresit të Manastirit, janë trajtuar edhe një histori e shkurtër e shkrimit si edhe ngjarjet e lidhura me lëvizjen politike e kulturore, që krijuan kushtet përmajtjen e këtij Kongresi. Gjithashtu është trajtuar shkurt edhe lufta, që zhvilloi populli shqiptar përmët vënë në jetë vendimet e Kongresit të Manastirit, përmët mbrojtur e çuar më tej arritjet në lëmin e përhapjes së shkrimit shqip dhe të lëvrimit të gjuhës shqipe.

Në ripunimin e kësaj broshure, e cila përmët herë të parë u botua në vitin 1968, janë shfrytëzuar edhe studimet e këtyre dhjetë vjetëve të fundit kushtuar Kongresit të Manastirit.

**Autorët**

## 1. DY FJALË MBI HISTORIKUN E SHKRIMIT SHQIP

Kongresi i Manastirit është një ngjarje me rëndësi në lëvizjen kombëtare të popullit shqiptar, në luftën e tij për mbrojtjen dhe zhvillimin e kulturës shqiptare, të gjuhës dhe të shkrimit shqip.

Duke luftuar me një vendosmëri të veçantë kundër të gjitha rrebesheve, që kaluan mbi tokën e tij gjatë shekujve, duke përballuar përpjekjet e perandorive të ndryshme për ta asimiluar dhe për ta zhdukur, populli shqiptar ka ruajtur veçoritë e veta kombëtare dhe ka shfaqur një dashuri të zjarrtë përgjuhën dhe kulturën e vet, për zhvillimin e tyre dhe përparimin e vendit. Në këtë mënyrë ai provoi vendosmërinë e tij të plotë për t'i mbrojtur ato me po atë heroizëm dhe trimëri legjendare, me të cilat ka luftuar shekuj me radhë për lirinë e atdheut.

«Populli shqiptar — ka theksuar shoku Enver Hoxha — gjatë shekujve ka luftuar për të mbrojtur veten si popull e si komb dhe kuptohet që njëkohësisht ai ka mbrojtur edhe kulturën e tij...

Vetë fakti që populli ynë i vogël nuk u zhduk dhe nuk u asimilua as nga popujt e mëdhenj që e robëruan dhe as nga kultura e tyre e zhvilluar, pro-

von se në këtë drejtim ka kontribuar tok me rezistencën e armatosur edhe kultura e popullit tonë...»<sup>1)</sup>

Në kushtet e sundimit të pushtuesve të huaj dhe në mënyrë të veçantë të zgjedhës më të egër dhe barbare të feudalëve osmanë, që ndiqnin politikën e asimilimit dhe të shkombëtarizimit të shqiptarëve, duke u mohuar atyre kombësinë dhe mësimin e gjuhës amtare, në një kohë kur Patrikana greke e Stambollit dhe qarqet shoviniste të shteteve fqinje synonin të zhduknin emrin dhe gjuhën e shqiptarëve, lufta për kulturën dhe shkrirmin shqip merr një rëndësi të veçantë dhe bëhet pjesë e luftës politikë dhe të armatosur të popullit shqiptar kundër robërisë osmane, reaksionit klerikal dhe fqinjëve shovinistë, për çirimin kombëtar.

Me qëndresën e tij heroike, me luftën dhe kryengritjet e shumta fshatare, që mbushën shekujt e historisë së tij, populli shqiptar ruajti të gjallë jo vetëm dashurinë e zjarrtë për lirinë e humbur, por edhe individualitetin e tij kombëtar, kulturën dhe veçanërisht gjuhën e vet.

Vetë Kongresi i Manastirit u bë i mundur në saje të luftës së masave popullore të vendit tonë kundër zgjedhës së huaj, në saje të përpjekjeve të popullit dhe të patriotëve të Rilindjes sonë kombëtare për shkrimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe.

\* \* \*

Gjuha shqipe është një nga gjuhët më të vjetra të Gadishullit Ballkanik, ashtu sikurse edhe vetë

---

1) Enver Hoxha, Vepra, Vëll. 17, f. 481-482.

populli shqiptar është një nga popujt më të vjetër të këtij gadishulli. Ashtu si dy gjuhë të tjera indoевropiane, rumanishtja<sup>2</sup>) dhe lituanishtja<sup>3</sup>), gjuha shqipe ka filluar të shkruhet relativisht vonë. Libri i parë shqip, që njohim gjer më sot, është «Meshari» i Gjon Buzukut i vitit 1555. Por kjo datë nuk duhet konsideruar si fillimi i shkrimit shqip. Fakte të ndryshme dëshmojnë se shqipja duhet të jetë shkruar që mjaft kohë përpëra Buzukut. Këtu nuk është fjalë vetëm për tri dokumentet e njoitura, «Formula e pagëzimit» e Pal Engjellit, «Fjalorthi» i Arnold fon Harfit dhe «Perikopeja e Ungjillit», por për një traditë të vërtetë shkrimi. Për ekzistencën e një tradite të tillë janë shprehur edhe disa dijetarë shqiptarë e të huaj si albanologu austriak Norbert Jokl, arbëreshi Gaetano Petroti, Eqrem Çabej, Mahir Domi etj. Argumentet, që kanë sjellë këta dijetarë për të vërluetuar se shqipja ka qenë shkruar edhe përpëra Buzukut, mbështeten në vetë gjuhën e veprës së këtij autori si edhe në disa dëshmi historike.

N. Jokli, duke bërë fjalë për shkronjën **ë** të Buzukut, që është përdorur edhe në disa shkrime bosnjake, pohon se në vendet e Shqipërisë Veriore shqipja ishte shkruar që «shumë kohë përpëra Buzukut»<sup>4</sup>.

Duke u mbështetur në gjuhën e Buzukut, e cila paraqitet «me një qëndrueshmëri fonetike dhe mor-

2) Shkrimet e para të rumanishtes i përkasin shekullit XVI.

3) Teksti më i vjetër i lituanishtes është i vitit 1547.

4) Për mendimin e Joklit se gjuha shqipe ka qënë shkruar shumë kohë përpëra Buzukut shih edhe E. Çabej, BSHSH 1, 1955, 10.

fologjike, me një raport të përcaktuar midis shenjës [shkronjës] dhe tingullit», G. Petrota pohon: «Kjo do të dëshmonte se... ekzistonte në Shqipëri qysh përpara shekullit XVI një traditë ortografike e ndoshta edhe një gjuhë e përbashkët, të paktën në shkrimet e përdorimit praktik»<sup>5).</sup>

Mendimin që shqipja ka qenë shikruar para Buzukut, e kanë miratuar edhe Eqrem Çabej e Mahir Domi.

Eqrem Çabej, si vë në dukje se gjuha e veprës së Buzukut «nuk është një arë fare e papunuar më parë» dhe si miraton edhe mendimin e Petrotës, shton: «Edhe duke e shikuar këtë çështje nga ana e historisë së vendit, me një vështrim të gjithanshëm të gjendjes kulturore në Shqipërinë mesjetare, kjo tezë do të dilte më fort e përforuar sesa e kundërshtruar, sepse shkalla e kulturës së popullit shqiptar në atë kohë nuk ka qenë ndryshe nga ajo e vendeve përreth, sidomos e atyre të brigjeve të Adriatikut»<sup>6).</sup>

Mahir Domi, nga ana e tij, vënënd me të drejtë se Buzuku «s'na flet për ndonjë vështirësi të vegantë që të ketë hasur në çështje të alfabetit, gjë që do të ndodhë, po t'i duhej atij të krijonte alfabetin që përdori»<sup>7).</sup>

---

5) Shih Parathënien e shkruar nga G. Petrota për studimin e Paolo Skiroit (*Il più antico testo di lingua albanese*, botuar në revistën «Indo-Greco-Italica», 1932, f. 47.

6) BShSh 1 (1955), 10.

7) BShSh 1 (1955), 7.

Ka se përfundet qëndra e shkallës së bëllit; që dëm  
fisurën e njerëzit e shkallës së bëllit e njerëzit  
Zotit e qëndrës përkufizohet atëh

Qëndra e shkallës së bëllit, regjitet e  
firat e shkallës së bëllit e ndërket e tashme.  
Finis.

### Er Lazarus Hocer vnde requiem defuncto.

Wor iub kom bat lebdebet Wu Lachut. Tue s' chalindlame herre sëb  
gjist a loneb nachebis; kaat u bëb: disgwom: en seb i cunome legjite.  
En seb osjunk seb botifik sencb dësa mesedigwuch per gaa mafrah  
meh difurk. Af eb Eftlure pach mendere e zimic hifte endiglo  
grindoh. përpert axq. teb n' wiðet mernet: tan bimale eti salutunc  
Ebis per millet lermi ante fortun. Annels 7. i kah de onc em Mich Lenn ce zg lus  
enbas ledi maal pët seb vali em osjuk per seb he obil mib tekunie or, enbice e  
ne. Et e camb uchenbar offid. Louneb ieb cheteb iolsterer enbil austeeli: Et g  
mondatoneb dijeri: tas meca mos o incanolog. ush. ed o thil seb: Et lejuntje rimez  
Eot se per berre, festine chasneb, et lejch mih lus; Et rimb en dlech pñ. Et h. des  
relieve: et lejch loneb stremtene: et cheteb banch sonute et a h. flac crs  
der han: seb seb coruse talu nob en gjatech dierie enach vielas seb vielateb dier  
sie en seb en biles esmaa duac h. ur barogn reperech teme em. Eot rimb pila  
karem: endek vieler. M. 2. II. v. endek calidon. v. dit e seb pñt: nroch seb em  
endek ekologje rand schinem: o duob rimb seb lejch salib: odu kuchalej ma blid  
salib seb zg: et alu salib etas rimb ekologje: endek wile: per seb nroch: endek tem:  
et seb pco salib: et cheteb chlencb mas epura veperi: et seb f salib: o rimb  
veperi em zube qibet tash. Pter seb ateb: i statiponimib chlencb: et ismash  
gashit temje such a munkie: et logjinech salib: teb mos beginkuje: per sej: zg derre  
endek rimb zube muoden. L. seb: o rimb endek tash: qibet chlencb endek seb chl  
salib: et seb zube moshazam: et zg lejch salib: zg lejch schindatash. Eot  
zotit e qëndrës per namob.

### 1. Pasthënia e veprës së Buzukut (1555)

Përvëç ketyre argumenteve, është edhe një fakt  
tjetër i rendit drejtshkrimor, që dëshmon për ekzis-  
tencën e një tradite shkrimi më të vjetër se Buzuku.  
Siç dihet, Buzuku dhe autorët e tjerë veriorë, që

erdhën pas tij (Budi, Bardhi, Bogdani)<sup>8</sup>), zanoret e gjata i dallojnë nga të shkurtrat duke ua dyzuar shkronjat përkatëse: p.sh. *juu, dyy, kaa* etj. [ju, dy, ka]. Një normë të tillë drejtshkrimore e gjejmë të përdorur edhe në veprën e arbëreshit L. Matrënga<sup>9</sup>), që u botua më 1592, dmth vetëm 37 vjet pas librit të Buzukut, si edhe në shkrimet e pothuaj të gjithë shkrimtarëve arbëreshë të shekujve XVIII-XIX. Mundësia që Matrënga ta ketë marrë këtë normë drejtshkrimore prej Buzukut, përjashtohet patjetër, jo vetëm sepse në kushtet historike të shekullit XVI kjo ishte e pamundur, por edhe sepse Matrënga, po ta kishte njojur veprën e Buzukut, duhej të kish pasur prej saj edhe ndonjë ndikim tjetër, të paktën në punë të alfabetit. Prandaj ekzistenca e një normë tillë drejtshkrimore tek shkrimtarët më të vjetër shqiptarë përkëtej dhe përtej Adriatikut flet qartë për ekzistencën e një tradite të vjetër shkrimi, trashëgimtar dhe vazhdues i së cilës ishte jo vetëm Buzuku në Shqipëri, por edhe Matrënga tek arbëreshët e Italisë.

Përveç argumenteve me karakter gjuhësor nuk mungojnë edhe dëshmi historike, që vërtetojnë se

---

8) Këtë normë drejtshkrimore e gjejmë të përdorur, me gjithëse jo në mënyrë konsekiente, edhe në shkrimet e «Anonimit» të Elbasanit e të Dhaskal Todhrit.

9) Do pasur parasysh se një normë e tillë drejtshkrimore nuk është përdorur në shkrimet greke, latine dhe italiane, në të cilat gjatësia e zanoreve shënohej ndryshe.

shqipja ka qenë shkruar që përpara Buzukut. Këtu është fjala në radhë të parë për dëshminë e murgut frëng Brokard, pas emrit të të cilit fshihet kryepesh-kopi i Tivarit, Guilemos Adae. Në një relacion të vitiit 1332<sup>10</sup>) ai flet qartë për shkrimin e shqipes në përdorim të përditshëm si edhe për libra në gjuhën shqipe. Ja si shkruan ai: «Sadoqë shqiptarët kanë një gjuhë fare të ndryshme nga latinishtja, megjithatë kanë në përdorim edhe në të gjitha librat e tyre shkronjën latine».

Kjo dëshmi gjen vërtetim edhe në pohimin e Marin Barletit, biografit të njojur të Skënderbeut, i cili në veprën e tij latinisht «De obsidione Scodrensis», f. 27, shkruan: «Por na patën rënë në dorë disa shkrime, që më tepër mund t'i quash fragmente sesa analë, në të cilat flitej më shumë për meremetimin, që i bënë këtij qyteti [= Shkodrës] stërgjyshërit tanë sesa për ndërtimin e tij.

Aty ishte shkruar në gjuhën popullore se një farë Roza me motrën e vet të quajtur Fa qenë themeluesit e parë të Shkodrës e prandaj fortesa e saj quhet Rozafa»<sup>11</sup>).

Në dritë të këtyre faktave nuk mund të mos nxirret përfundimi që gjoha shqipe ka qenë shkruar të paktën që nga shekulli XIII e ndoshta edhe që më përpara.

Sidoqoftë, në krahasin me disa gjuhë të tjera indoevropiane shqipja ka nisur të shkruhet relativisht vonë. Arsyet e kësaj vonese mund të kuptohen lehtë, po të kihet parasysh fakti që vendi ynë qysh

---

10) Shih Historia e Letërsisë Shqipe, I, 155-156.

11) Shih Marin Barleti, Rrethimi i Shkodrës (përkthyer nga Henrik Lacaj), bot. II Tiranë, 1967, f. 35.

nga koha romake e këtej ka qenë nën sundimin shekullor të pushtuesve të huaj, të cilët janë përpjekur me të gjitha mjetet për ta asimiluar atë. Në të tilla rrethana stërgjyshërve tanë u është dashur të qëndrojnë vazhdimishit me shpatë në dorë për të mbrojtur jetën, nderin dhe gjuhën e tyre. Në lidhje me këtë duhet pasur parasysh edhe roli negativ, që kanë luajtur fetë, të cilat i janë imponuar popullit tonë. Këto, siç dihet, janë përdorur nga të huajt për të rrënjosur në popullin tonë ideologjinë dhe kulturën e huaj. Mjafton të përmendim se katolicizmi si gjuhë liturgjike lejonte vetëm latinishten, dmth gjuhën e pushtuesve romakë, kurse ortodoksizmi si gjuhë liturgjike lejonte vetëm greqishten, dmth gjuhën zyrtare të Perandorisë Bizantine. Edhe islamizmi, i përhapur në Shqipëri nga pushtuesit osmanë, si gjuhë liturgjike pranonente vetëm arabishten, ndërsa si gjuhë e administratës ishte turqishtja.

Pra, arsyet që shqipja ka nisur të shkruhet relativisht vonë në krahasim me disa gjuhë të tjera indoevropiane, duhen kërkuar në rrethanat historike dhe politike, që i kanë penguar të parët tanë të lëvronin që heret gjuhën amtare.

Veprat e para në gjuhën shqipe, që njohim gjer më sot, janë shkrime me karakter fetar e didaskalik. Të tilla janë veprat e Buzukut, Budit, Bogdanit, etj. Këto vepra kanë dalë në një kohë kur kisha katolike, e cila e ka kundërshtuar kurdoherë përdorimin e gjuhës amtare si gjuhë liturgjike, duke u ndodhur përpëra prezikut të përhapjes së islamizmit dhe të ideve të reformacionit, u detyrua të lejonte botimin e kufizuar të disa veprave fetare përmësimin e dogmave fetare në disa gjuhë amtare.

Autorët e këtyre veprave kanë përdorur një al-

fabet të mbështetur në alfabetin latin dhe të plotësuar edhe me disa shkronja cirilike. Ky alfabet, që e gjejmë të përdorur së pari tek Buzuku, në formën e përpunuar nga autorët e mëpastajmë veriorë, u bë tradicional në shkrimet fetare katolike dhe ka vazhduar të përdoret në Shkodër gjer në vitin 1909, dmth. gjer pas Kongresit të Manastirit.

Ndërsa gjatë shekuve XVI-XVII, në bazë të të dhënave që kemi gjer më sot, gjuha shqipe u shkrua vetëm prej autorësh nga Shqipëria e Veriut (si edhe tek arbëreshët e Italisë), në shekullin XVIII shkrimi i saj u përhap edhe në Shqipërinë e Mesme e Jugore, sidomos në Elbasan, Voskopojë, Berat etj., dmth. në ato qendra, që gjatë atij shekulli patën njëfarë zhvillimi të mirë ekonomik e kulturor. Autorë të ndryshëm shqiptarë, që kanë jetuar gjatë shekullit XVIII, na kanë lënë vepra të shkruara me alfabetet nga më të ndryshmet, gjë që ishte e pashmangshme në kushtet e sundimit të huaj dhe të ndikimit të kulturave të ndryshme të huaja në Shqipërinë e asaj kohe. Ndërsa Gjon Nikollë Kazazi prej Gjakove botoi në Romë më 1743 një libër të vogël katekizmi me alfabetin tradicional të Veriut me ndonjë ndryshim të vogël, një autor anonim, me origjinë ende të papercaktuar<sup>12)</sup>, që duhet të ketë jetuar në Elbasan, ndoshta, aty nga gjysma e parë e shekullit XVIII, përktheu në gjuhën shqipë disa shkrime fe-

12) Për këtë shih Mahir Domi, «Rreth autorit dhe kohës së dorëshkrimit elbasanas me shqipërim copash të Ungjillit», botuar në vëllimin «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», (Tiranë, 1965) f. 270 e vazhdim, si edhe diskutimet e Dhimitër Shuteriqit e të Injac Zamputit, po aty, f. 396 v. dhe 399 v.

tare duke i shkruar me një alfabet të veçantë prej më se 40 shkronjash. Pas tij Theodhor Haxhifilipi (Dhaskal Todhri) prej Elbasani përktheu gjithashtu disa shkrime fetare duke i shkruar ato me një alfabet tjetër të veçantë prej 52 shkronjash. Kurse vosa-kopojarët Theodhor Kavaljoti dhe Danil Haxhiu, ky i fundit propagandues i helenizimit të shqiptarëve<sup>13)</sup>, botuan nga një libër me karakter shkollor, ku pjesët në gjuhën shqipe i shkruan me alfabetin grek. Gjatë po atij shekulli zë fill në qendra të tilla si Berati etj. një letërsi e ndikuar thellë nga ideologjia e fesë islame dhe nga kultura turkoorientale. Eshtë fjala për vjershat e bejtexhinjve Nezim Frakulla i Beratit, Hasan Zyko Kamberit prej Kolonje etj., të cilët shkruan varje me alfabetin arab në një shqipe të mbushur me fjälë të huaja turke, arabe e persiane.

Lëvrimi i gjuhës shqipe mori një hov të madh gjatë shekullit XIX, sidomos gjatë gjysmës së dytë të atij shekulli, kur si rezultat i ndryshimeve ekonomiko-shoqërore, i lindjes së elementeve kapitaliste, zhvillohet procesi i formimit të kombit shqiptar edhe i lëvizjes nacionale-borgjeze në Shqipëri. I zhvilluar në kushte shumë të vështira të zgjedhës së egër osmane, të prapambetjes së madhe ekonomiko-shoqërore, të sundimit të marrëdhënieve gjysmëfeudale dhe të copëtimit administrativ të tokave shqiptare, të politikës asimiluese të feudalëve osmanë që monhonin kombësinë shqiptare, të propagandës dhe të synimeve shoviniste të shteteve fqinje, procesi i formimit të kombit shqiptar hasi në pengesa të mëdha, që e ngadalësuan në një farë mase ritmin e këtij procesi. Megjithatë, pavarësisht nga ritmet dhe


---

13) Shih Historia e Letërsisë Shqipe, I, f. 312.

thellësia e tij, ky proces e çau rrugën e vet dhe bashkë me të filloj të zhvillohej edhe lëvizja kombëtare në Shqipëri.

Në këto rrethana formohen edhe ideologët e lëvizjes kombëtare shqiptare dhe fillon ajo lëvizje politike, shoqërore dhe kulturore, që njihet me emrin Rilindja Kombëtare. Periudha e Rilindjes karakterizohet nga një ngritje e ndërgjegjes kombëtare dhe e luftës çlirimtare të armatosur të popullit shqiptar kundër zgjedhës osmane, nga formimi i mendimit politik shqiptar, që gjeti shprehjen e vet në programin e lëvizjes kombëtare dhe në mënyrë të veçantë në kërkesën e autonomisë së Shqipërisë. Rilindja karakterizohet gjithashtu nga një luftë e ashpër, që bënë iluministët më të përparuar shqiptarë kundër ideologjisë reaktionare dhe klerikale të feudalëve osmanë dhe shqiptarë për zhvillimin e kulturës kombëtare dhe demokratike, dhe në mënyrë të veçantë nga një zhvillim letrar me frysë patriotike dhe demokratike.

Duke karakterizuar këtë epokë të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar, shoku Enver Hoxha në fjalimin e vet të 7 Marsit 1968 «Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë» vë në dukje se «epoka e Rilindjes është një epokë revolucionare demokratike me shumë rëndësi në historinë dhe letërsinë e popullit tonë, është një epokë e ndritur e udhëhequr nga idetë iluministe, nga njerëzit tanë të shquar të asaj periudhe, që me të drejtë është quajtur Rilindja e Kombit, dalja nga errësira mesjetare-feudale-imperialiste në dritë, në kryengritje, në luf-



të për liri, pavarësi, demokraci, për dritë dhe arsim»<sup>14)</sup>.

Një vend të posaçëm në epokën dhe veprimtarinë e rilindasve zë lufta për lëvrimin e gjuhës shqipe, për njësimin e shkrimit të saj, gjë kjo që është e lidhur me procesin e formimit të ndërgjegjes kombëtare dhe të unitetit kombëtar.

Në vlerësimin që i bën procesit të formimit të kombit dhe të lëvizjeve nacionale, V.I. Lenini vë në dukje, midis të tjerash, rëndësinë e gjuhës si një nga tiparet e këtij procesi. «Baza ekonomike e këtyre lëvizjeve nacionale — shkruante Lenini — qëndron në atë që për fitoren e plotë të prodhimit të mallrave është i domosdoshëm pushtimi i tregut të bendarshëm nga borgjezia, bashkim i shtetëror i vendeve me popullsi që flet të njëjtën gjuhë, duke zhdukur të gjitha pengesat për zhvillimin e kësaj gjuhe dhe për fiksimin e saj në literaturë»<sup>15).</sup>

Zhvillimi i elementeve kapitaliste sjell si rezultat formimin e një tregu unik, forcon lidhjet ekonomike midis krahanave të ndryshme, bashkimin e tyre në një të tërë. Këto procese kërkojnë medoemos edhe njësimin e gjuhës, që është një mjet komunikimi, ndihmon unitetin politik dhe formimin e shtetit nacional.

Në kushtet e sundimit të pushtetit politik të feudalëve osmanë, kur zgjedha e rëndë ekonomike shoqërohej me politikën e shkombëtarizimit dhe të asimilit më të egër, kur mohohej vetë ekzistenca e kombësisë shqiptare, që zëvendësohej nga Porta

14) Enver Hoxha, Raporte e fjalime 1967-1968, Tiranë 1969, f. 368.

15) V. I. Lenin, Vepra V. 20, f. 452.

e Lartë dhe Patrikana e Stambollit me ndarjen e popullsisë sipas dallimeve fetare, kur sundonte obskurantizmi i plotë i klerit reaksionar mysliman, ortodoks dhe katolik në fushën e arsimit shumë të kufizuar që jepej në gjuhë të huaj (turqisht, greqisht, italisht) dhe u shërbente të huajve, kur ndalohej me të gjitha mjetet mësimi dhe shkrimi i gjuhës amtare shqipe, lufta për gjuhën dhe shkrimin shqip merr në lëvizjen kombëtare shqiptare një rëndësi të veçantë. Qysh në fillimet e Rilindjes shqiptare lufta për shkrimin dhe shkollën shqipe shndërrohet në një pjesë përbërëse të programit politik të rilindasve, të luftës së tyre për autonominë dhe lirinë e popullit, dhe përshkon si një fill i kuq ngjarjet më të rëndësishme të lëvizjes kombëtare shqiptare që nga koha e veprimtarisë së N. Veqilharxhit dhe gjer në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë.

Në të tilla kushte dolën nga gjiri i popullit tonë një varg atdhetarësh të ndritur, të cilët, të shtytur nga dashuria për atdhenë, iu përveshën punës me vetëmohim për t'i ndriçuar popullit të tyre rrugën drejt lirisë. Midis këtyre një vend të shquar zenë shkrimtarët patriotë Naum Veqilharxhi, Kostandin Kristoforidhi, vëllezërit Naim e Sami Frashëri, Jani Vretoja, Vaso Pasha etj. Këta, duke dashur t'i hapnin sytë popullit shqiptar e ta drejtonin atë në rrugën e përparimit e të qytetërimit, në mënyrë që ta kuptonte më mirë gjendjen e rëndë, në të cilën ndodhej, i dhanë një rëndësi të madhe përhapjes së arsimit e të diturisë në gjuhën amtare. Madje, të mësuarit në gjuhën amtare ata e ngrinin si një problem të madh kombëtar. Naum Veqilharxhi, p.sh. në «Enqiklikën për tërë të pasurit e të mësuarit shqiptarë ortodoksë» të vitit 1836 shkruante:

«Sa kombe që kanë mbetur ndë padije u ngjasin gjithënë robëvet duke punuar nga dita për fatbardhësin' e të qytetëruarve e të fuqishmëve, të cilët vetëm atëhere kanë për të dalë nga gjendja e bagëtishme ku ndodhen, kur të nisin të lërojnë gjuhën e tyre kombëtare. Po kjo nuk fitohet ndryshe veçse me shkronja të veçanta kombëtare që janë filluar para meje. Po me të përzjerit e të huajvet edhe me dinakërítë e disa njerëzve të nakartë mbetnë të gji-tha pa marrë fund».<sup>16)</sup>

Dyzet e tre vjet më vonë Sami Frashëri në «Alfabetaren e gjuhësë shqip» të Stambollit (1879), duke shprehur edhe ndjenjat e shqetësimet e bashkëko-hësve të vet, e shtron këtë çështje në mënyrë më kategorike. Të shkruarit e të lexuarit në gjuhën am-tare Samiu e quante si një mjet të domosdoshëm për të shpëtuar ekzistencën e shqiptarëve si komb. Ja si shkruante ai:

«Është për t'u çuditur qysh ka rrojturë gjer më sot komb' i shqipëtarëvet, duk me mos shkruar' e duk me mos kënduarë gjuhën' e tyre, kur janë humburë kaqë kombe, që shkruanin' e këndoninë gjuhën' e tyre, si syrjanëtë, kaldenjasitë, finiqasitë, llatinët' e të tjerë». <sup>17)</sup>

Dhe më poshtë:

«Komb' i shqipëtarëvet nga të mosshkruarët e gjuhës së vet ka humburë gjer më sot më të shumët' e njerëzet; po, në ka humburë aqë në kaqë mijë vjet, ata që kanë mbeturë do t'i humpnjë në fort pakë

16) Nxjerrë nga përkthimi shqip i botuar në «Kalendar Kombiar», 1906, f. 52-53.

17) Alfabetare e gjuhësë shqip (Stamboll, 1879), f. 28.

kohë, se koh' e sotme nukë ngjan me kohërat e vjetëra; sot kombetë piqen' e përzihenë fort çpejt, edhe ata që janë më të fortë e më të diturë, mundinë kur doherë ata që janë të dobët' e më të paditurë».<sup>18)</sup>

Këto fjalë gjithë shqetësim, të shprehura nga një njeri që e donte dhe e çmonte shumë gjuhën e vet, tregojnë qartë se grëndësi të madhe i jepnin patriotët tanë të shekullit të kaluar shkrimit të shqipes dhe lëvrimit të saj. Por duket qartë që Samiu e ka mbivlerësuar me qëllim këtë faktor, kur thotë se kombi shqiptar «nga të mosshkruarit' e gjuhës së vet ka humburë gjer më sot më të shumtët' e njerëzet». Të moslëvruarit e gjuhës amtare, sigurisht, e ka favorizuar procesin e asimilimit të një pjese të shqiptarëve nga të huajt gjatë shekujuve. Por në këtë proces kanë ndikuar më fort faktorë politikë, në mënyrë të veçantë zgjedha e huaj. Për më tepër, në kohën që shkroi Samiu këto radhë, shqipja nuk ishte një gjuhë e pashkruar. Ajo kishte nisur të shkruhej qysh disa shekuj më përrpara. Por në atë kohë numëroheshin me gishta ata shqiptarë, që dinin të shkruanin e të lexonin në gjuhën amtare. E kjo gjendje e krijuar dhe e mbajtur me qëllim nga sunduesit osmanë dhe qarqet klerikale, e pengonte së te-përtimi zgjimin e përgjithshëm të popullit shqiptar dhe bashkimin e tij në luftën kundër sunduesve osmanë dhe intrigave të të huajve. Patriotët shqiptarë të shekullit të kaluar e shihnin qartë se një popull i paditur e i prapambetur mund të gënjehej më lehtë nga armiqëtë, të cilët synonin t'i mbanin shqiptarët të pérçarë e të nënshtruar përgjithmonë duke nxitur për këtë qëllim edhe dasitë fetare. Prandaj,

---

18) Alfabetare e gjuhësë shqip (Stamboll, 1879) f. 29.

duke u përpjekur ta nxirrin popullin nga prapambetja shekullore e ta drejtonin në rrugën e përparrimit e të jisë, ata i dhamë një rëndësi shumë të madhe përhapjes së arsimit e të diturisë në gjuhën amtare. Në këtë mënyrë ata mendonin t'ia arrinin një qëllimi të dyfishtë — të forconin sa më shumë ndërgjegjen kombëtare dhe bashkimin e popullit të tyre e në të njëjtën kohë t'i tregonin edhe botës se shqiptarët ishin një komb më vete me një gjuhë amtare të veçantë dhe nuk ishin as turq, as grekë, as latinë, siç orvateshin t'i paraqitnin armiqtë e huaj.

Duke vlerësuar këto përpjekje të jashtëzakonshme të rilindasve tanë të shquar, shoku Enver Hoxha ka theksuar se «rilindasit tanë të lavdishëm na kanë lënë një thesar të madh kulture që lulëzoi dhe ndriti nën një shtypje të egër dhe të errët. Ata luftuan, si ata, për lirimë e atdheut, për dituri dhe dritë. U shkri si qiriu i madhi Naim Frashëri për t'i dhënë dritë Shqipërisë, për ta parë zonjë Shqipërinë. Për dituri luftotonin Samiu i pavdekshëm, Koto Hoxhi e qindra njerëz të tjerë me mendje të ndritur, me guxim të pashoq e me zemër të pastër. Për shkollën shqipe, për alfabetin shqip, që ta mësonin djemtë e popullit, luftoi tërë jetën dhe u vra nga armiqtë mësuesi i lavdishëm Petro Nini Luarasi, u masakrua nga shovinistët grekë Papa Kristo Negovani, u persekujuan me mijëra të tjerë». <sup>19)</sup>

\* \* \*

Një nga çështjet kryesore, që tërhoqën qysh në fillim vëmendjen e patriotëve të Rilindjes, ishte ve-

---

19) Enver Hoxha, Vepra, Vëll. 17, f. 484.

ndosja e një alfabeti të vetëm e të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Kjo ishte një kërkesë e ngutshme, sepse mungesa e një alfabeti të vetëm për shkrimin e shqipes përbënte një pengesë të madhe për përhapjen e diturisë e të arsimit dhe, si rrjedhim, edhe për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar dhe për bashkimin e tij. Shqetësimi dhe përpjekja e rilindasve për zgjidhjen e çështjes së alfabetit kuptohen lehtë, po të kihet parasysh se para vitit 1879, kur u botua alfabetarja e Stambollit, janë përdorur një numër relativisht i madh alfabetesh për shkrimin e shqipes. Ja si paraqitet gjendja e alfabeteve të shqipes para vitit 1879:

Në Shqipërinë e Veriut vazhdonte të përdorej alfabeti tradicional i shkrimtarëve të vjetër. Me këtë alfabet gjatë shekullit XIX u botuan kryesisht një numër veprash fetare nga priftërinj katolikë.

Bejtexhinxjtë si Muhamet Çami, Dalip e Shahin Frashëri etj., ashtu si bejtexhinxjtë e shekullit XVIII, në shkrimet e tyre me përbajtje kryesisht fetare përdorën alfabetin arab.

Në disa vepra të tjera si Bibla e Korfuzit, Bleta Shqiptare e Thimi Mitkos, veprat e Kristoforidhit në dialektin toskërisht etj. u përdor alfabeti grek i plotësuar me disa shkronja konvencionale të sajuara mbi bazën e alfabetit grek. Madje, në veprat e Kristoforidhit, përveç shkronjave konvencionale janë përdorur edhe shkronjat latine b, d.

Në botime të tjera si «Përbledhje këngësh popullore» të Zef Jubanit, veprat e Kristoforidhit në dialektin gegërisht etj. u përdor alfabeti latin i plotësuar me disa shkronja konvencionale të sajuara mbi bazën e alfabetit latin. Në këto vepra të Kristoforidhit, për të plotësuar alfabetin latin, janë për-

dorur edhe shkronjat greke 9, 8. Vlen të përmendet këtu se edhe Vaso Pasha më 1878 përshtati për shqipen alfabetin latin të plotësuar me dyshkronjësha. Këtë alfabet ai e përdori edhe në veprën e tij *Grammaire albanaise* të vitit 1887.

Nuk mund të lihen pa përmendur këtu edhe alfabetet origjinale, që patën një përhapje jo të vogël gjatë shekullit XIX. Përveç alfabetit të Todhrit, që vazhdoi të përdorej në Elbasan, Berat e gjetkë kryesisht në marrëdhënie tregtare e në letërkëmbime, gjatë shekullit XIX pati njëfarë përhapjeje edhe alfabeti origjinal i Naum Veqilharxhit prej 32 shkronjash<sup>20)</sup>. Duhen përmendur gjithashtu edhe alfabetet origjinale të Hoxhë Tahsinit dhe të Vasil Dhimitri Rusos.

Që të kihet një ide më e qartë për gjendjen aq të ndërlikuar të shkrimit të shqipes para vitit 1879, mjafton të kihet parasysh se një njeri, që do të dëshironë të lexonte veprat e Kristoforidhit në dialek-  
tet toskërisht e gegërisht, duhej të njihte si alfabetin grek ashtu edhe atë latin me gjithë shkronjat konvencionale, që ishin sajuar për të paraqitur ata tinguj të shqipes, që i mungonin greqishtes e latinishtes. E për të lexuar edhe veprat e tjera të shkruara me alfabete të ndryshme, njeriu duhej të mësonte një numër jo të vogël alfabetesh.

Para një gjendjeje të tillë patriotët shqiptarë, që ndodheshin në Stamboll, u përpoqën t'i gjenin një zgjidhje këtij problemi. Këto përpjekje filluan

20) Me këtë alfabet Veqilharxhi botoi më 1844 një abetare, të cilën e ribotoi më të zgjeruar një vit më vonë. Abetarja e Veqilharxhit u përhap në Korçë, Përmet e Berat. Shih Historia e Letërsisë Shqipe, II (1960), 220.

që në vitin 1864<sup>21</sup>), por pengesat dhe intrigat e qeverisë turke e të Patrikanës së Stambollit si edhe të feudalëve turkomanë shqiptarë, që nuk ishin të interesuar për zgjimin e popullit tonë, bënë që zgjidhja e këtij problemi të rëndësishëm të zvarritej e të mos merrte udhë.

Nga fundi i dhjetëvjetëshit të shtatë të shekullit të kaluar, kur populli shqiptar nën udhëheqjen e Lidhjes së Prizrenit luftonte me armë në dorë kundër zgjedhës osmane, Fuqive të Mëdha dhe fqinjëve shovinistë pér të ndaluar copëtimin e tokave të tij dhe pér të fituar autonominë, u krijuan kushte të favorshme edhe pér lëvizjen kulturore shqiptare që mori hov.

Është e vërtetë se përpjekjet pér lëvrimin e gjuhës shqipe kishin nisur qysh prej shumë kohësh më parë dhe kishin marrë një hov të mirë sidomos qysh nga gjysma e parë e shekullit XIX, por është gjithashtu po aq e vërtetë se faktorët historikë, që i dhanë shkas drejtëpërdrejt fillimit të asaj lëvizjeje kombëtare, që njihet me emrin Lidhja Shqiptare e Prizrenit, nuk mund të mos u jepnin një shtysë të fortë edhe përpjekjeve pér lëvrimin dhe zhvillimin e gjuhës shqipe. Nuk është aspak një rastësi që pas mbledhjes historike të 10 qershorit në Prizren nuk ka luau më shumë se 10 muaj, kur patriotët shqiptarë në Stamboll arriten t'i kapërcenin mosmarrëvesh-

21) Shih Historia e Letërsisë Shqipe II, 17. Kohët e fundit është shprehur dyshimi mbi fillimin e këtyre përpjekjeve në vitin 1864 dhe është pohuar që ato kanë nisur më 1867; shih pér këtë T. Osmani, «Përpjekjet e rilindasve pér njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe», SF 2, 1978, 48 v. (me literaturë).

jet midis tyre dhe të vendosnin më në fund një alfabet të përbashkët pér shkrimin e gjuhës shqipe. Gjithashtu nuk është një rastësi që midis atyre që nënshkruan «Kanonizmën» e *Shoqërisë së të shtypuri shkronja shqip* në Stamboll në tetor 1879, ishte edhe Abdyl Frashëri, udhëheqësi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Po ajo ndjenjë përgjegjësie dhe po ajo frymë bashkëpunimi e vetëmohimi, që i bënë përfaqësuesit e krahinave të ndryshme të Shqipërisë të mblidheshin në Prizren e të bashkoheshin si një trup i vetëm përballë rrezikut të madh që i kërcenohej atdheut, i nxitën edhe patriotët shqiptarë në Stamboll të kapërcenin vështirësi e pengesa, që pér atë kohë dukeshin si të pakapërcyeshme. Këta patriotë të shquar, që përfaqësonin krahina dhe besime të ndryshme, duke parë rrezikun e madh, që i kanosej gjuhës shqipe në kushtet e rënda të pushtimit shekullor turk dhe të ekspansionit territorial dhe kulturor të shovinistëve fqinjë, me një ndjenjë të lartë përgjegjësie dhe me një frymë bashkëpunimi të singertë, më në fund i hodhën mënjanë pikëpamjet vetjake, që i pengonin të arrinin një vendim të përbashkët pér çështjen e alfabetit. Pra, vendimet historike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nuk mund të mos gjenin jehonë edhe ndër patriotët shqiptarë të Stambollit, aq më shumë kur një pjesë e mirë prej këtyre ishin edhe ideologë të asaj lëvizjeje. Si rrjedhim, ata nuk mund të mos i përgjigjeshim flakë pér flakë njerës prej kërkësave të rëndësishme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe pikërisht kërkësës që të përhapej arsimi në Shqipëri dhe që më shkolla të mësohej edhe gjuha shqipe. Kjo kërkësë, që u formulua pér herë të parë zyrtarisht në Rezolutën e mbledhjes

së Degës së Lidhjes Shqiptare në Dibër më 14 tetor 1878<sup>22)</sup> dhe që u miratua më 1 nëntor të po atij viti në Dibër, nga një mbledhje e përbashkët e përfaqësuesve të Shqipërisë Veriore dhe Jugore, ku mori pjesë edhe Abdyl Frashëri, shtronte para patriotëve shqiptarë të kohës detyra me përgjegjësi të madhe, që duheshin zgjidhur sa më parë.

Një nga këto detyra të ngutshme ishte, në radhë të parë, zgjidhja e çështjes së alfabetit. Çështja e vendosjes së një alfabeti të përbashkët për shkrimin e gjuhës shqipe në ato rrethana historike nuk ishte një çështje me karakter thjesht kulturor apo shkencor, ajo kishte në radhë të parë një rëndësi politike të dyfishtë. Mungesa e një alfabeti të përbashkët jo vetëm që ishte një mjet përçarjeje, që shfrytëzohej nga armiqtë për të mbjellë e thelluar dasitë krahinore dhe fetare midis shqiptarëve, por ishte njëkohësisht edhe një pengesë e madhe për lëvrimin e gjuhës shqipe e si rrjedhim edhe për arsimimin dhe zgjimin e popullit shqiptar. Prandaj vendimi i patriotëve shqiptarë për të krijuar një alfabet të përbashkët, i cili ka kaluar në histori me emrin «Alfabeti i Stambollit», ishte një vendim me rëndësi të madhe, në radhë të parë, politike.

Por arritja e marrëveshjes për këtë alfabet nuk qe një punë e lehtë. Ajo u bë e mundur pas diskutimesh të gjata, nëpërmjet të cilave u sheshuan di-

---

22) Kjo kërkesë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit është botuar më parë në gazeten e Sami Frashërit «Terxhumani Shark» të Stambollit më 15 shtator 1878 (shih S. Pollo e S. Pulaha, Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, botim i Akademisë së Shkencave të RPSSH, Tiranë, 1978, f. 63).

vergjenca të shumta. Siç na dëshmon Jani Vretoja<sup>23)</sup>, gjatë këtyre diskutimeve disa nga myslimanët shqiptarë të Stambollit kishin shprehur mendimin që shqipja të shkruhej me alfabetin arab. Kundër një mendimi të tillë ishin ngritur Ismail Qemali, Pashko Vasa, Konstandin Kristoforidhi dhe Hasan Tahsini (Hoxhë Tahsini). Edhe mendimi i Hasan Tahsinit për krijimin e një alfabeti origjinal nuk gjeti mbështetje<sup>24)</sup>. Jani Vretoja ishte për krijimin e një alfabeti të mbështetur në alfabetin grek e latin të plotësuar me disa shkronja të tjera, kurse Pashko Vasa<sup>25</sup> Sami Frashëri<sup>26)</sup> etj. ishin për një alfabet të mbështetur në alfabetin latin. Më në fund u vendos që si bazë për alfabetin e përbashkët të shqipes të merrej alfabeti latin. Ja si e arsyeton Samiu marrjen e një vendimi të tillë në artikullin e cituar të Alfabetares së Stambollit, f. 30:

«Shqipërija është një copë vënt nga Evropa edhe shqipëtarëtë janë një nga kombet e Evropës; p'andaj edhe gjuha shqip duhet të shkruhetë me shkronjat' e Evropës, do-me-thënë me shkronjatë llatinisht».

Por, sikurse shkruan Samiu në artikullin e por-sacituar të «Alfabetares» së Stambollit, f. 30 v., në përdorimin e alfabetit latin për shkrimin e gjuhës

23) Shih J. Vreto, *Vepra të zgjedhura* (mbledhur dhe përgatitur nga Alfred Uçi), Tiranë, 1973, f. 275.

24) Po ai, po aty, f. 277, Pashko Vasa ishte për një alfabet thjesht latin të plotësuar me anë dyshkronjëshash.

25) Po ai, po aty, f. 285.

26) Për mendimet e Sami Frashërit shih artikullin e tij «Gjuha shqipe» në *Alfabetare e gjuhësë shqip* të Stambollit (1879).

shqipe dilnin dy vështirësi. Vështirësia e parë kishte të bënte me vlerën shqiptimore, që do t'u jepej disa shkronjave latine, që në gjuhë të ndryshme përdoreshin me vlera të ndryshme. Por kjo vështirësi, shton ai, mund të kapërcehet lehtë, duke u dhënë shkronjave latine një vlerë shqiptimore konvencionale, ashtu siç është vepruar edhe në shkrimin e shumë gjuhëve të tjera. Kështu p.sh. shkronjat *c*, *q*, *x*, *y* në alfabetin e Stambollit u përdorën me vlera të ndryshme nga ato të vetë latinishtes si edhe të disa gjuhëve të tjera. Po kështu shkronja e në alfabetin e Stambollit u përdor me vlerën e shkronjës së sotme *ë*, Vështirësia kryesore, sipas Samiut, dilte nga numri i kufizuar i shkronjave latine (gjithsej 25), që ishin të pamjaftueshme për 36 fonemat e gjuhës shqipe. Për këtë ai shton se njëmbëdhjetë shkronjat e tjera u plotësuan ose «duke u ndërruarë pakë fytyrënë» disa shkronjave latine, ose duke marrë disa shkronja nga alfabeti i greqishtes, «që është edhe ajo një nga motërat e vjetëra të gjuhësë sonë, si edhe llatinishtja». (po aty, f. 32).

Siç shihet, alfabeti i Stambollit u ndërtua mbi parimin *një shkronjë* për *çdo tingull*, duke përjashtuar kështu sistemin e dyshkronjësheve.

Nga shkronjat latine të ndryshuara mund të përmenden këtu *g* (si një *g* e kthyer së prapthi) dhe *y* (një *x* e ndryshuar), që u përdorën e para me vlerën e dyshkronjëshit të sotëm *gj* dhe e dyta me vlerën e dyshkronjëshit të sotëm *xh*. Këtu mund të përmenden edhe shkronjat latine me shenja diakritike *ç* dhe *z*, që u përdorën e para me vlerën që ka edhe në alfabetin e sotëm, dhe e dyta me vlerën e dyshkronjëshit të sotëm *zh*.

Në alfabetin e Stambollit, siç u vu' në dukje edhe pak më sipër, u përdorën edhe disa shkronja greke, si: *E*, ε për të sotmet *E*, *e*; shkronja e madhe Γ për të sotmen *Gj*; Λ, λ për të sotmet *Ll*, *ll*, π, ρ për të sotmet *P*, *p*; Θ për të sotmen *Th* (ndërsa e sotmja *th* në atë alfabet jepet me si një *d* pak të ndryshuar); *P*, *p* për të sotmet *Rr*, *rr*, σ për të sotmen *sh*, η (e ngjashme me η të greqishtes) për të sotmen *nj*.


Në alfabetin e Stambollit ka edhe disa shkronja të një tipi të veçantë si Ι (e ngjashme me shkronjën e madh *b* të alfabetit sllav) që në atë alfabet është përdorur me vlerën e së sotmes *Dh*, ndërsa shkronja e vogël e sotme *dh* në atë alfabet jepet me δ (një *d* pak e ndryshuar, e ngjashme me shkronjën e vogël delta të greqishtes). Të kohen parasysh edhe shkronjat Ρ për të sotmen *E*, Κ për të sotmen *Sh* dhe Η për të sotmen *Nj*.

Siç shihet, alfabeti i Stambollit paraqitet shumë kompleks, pra, edhe i vështirë, sidomos, për botime librash. Nga mënyra se si u plotësuan të njëmbëdhjetë shkronjat, që i mungonin alfabetit latin, del se:

1) Autorët e këtij alfabeti e kanë zbatuar me përpikëri parimin që për çdo tingull të kishte një shkronjë të veçantë, duke mënjanuar kështu dy-shkronjëhat.

2) Në plotësimin e alfabetit latin edhe me disa shkronja greke duket qartë ndikimi i mendimit të Jani Vretos.

3) Alfabeti i Stambollit duhet konsideruar frysht i një pune kolektive, ku duken qartë gjurmët e përpjekjeve për të pajtuar pikëpamjet e autorëve kryesore.



2. Fac-simile e faqes së parë të Alfabetares së Stambollit.

sorë të tij, Sami Frashërit, Jani Vretos dhe Pashko Vasës.<sup>27)</sup>

Alfabeti i Stambollit me të tridhjetë e gjashtë shkronjat e tij u përgjigjej plotësisht kërkesave fonologjike të shkrimit të shqipes. Por, duke qenë i përzier (shkronja latine, greke e shkronja të posaçme), paraqiste vështirësi për botim librash në shtypshkronja, që s'i kishin të gjitha këto lloje shkronjash. Ky alfabet, me gjithë pengesat e intrigat e qeveritarëve osmanë e të Patrikanës së Stambollit dhe të veglave të tyre, hoxhallarëve dhe priftërinjve, pati një përhapje të mirë në Shqipërinë Jugore e të Mesme, sidomos nëpërmjet librave të Naimit, Samiut, Vretos etj., që u botuan në shtypshkronjën e shoqërisë «Diturija» të Bukureshtit e më vonë edhe në shtypshkronjën e shoqërisë «Dëshirë» të Sofjes. Ai, pra, luajti një rol të madh në përhapjen e shkrimt shqip ndër shqiptarë brenda dhe jashtë Shqipërisë. Me këtë alfabet u botuan edhe disa të përkohshme si «Drita» (më vonë «Dituria») e Stambollit (1884-1885), «Drita» e Shahin Kolonjës në Sofje (1901-1908), «Kalendar Kombiar» në Sofje (1897-1916), «Liri e Shqipërisë» në Sofje (1911-1914), etj.

Alfabeti i Stambollit, i cili me kohë fillooi të konsiderohej si një alfabet kombëtar nga një shumicë e madhe shqiptarësh, ishte një shuplakë e fortë për të gjithë armiqtë e Shqipërisë. Qarqet zyrtare osmane, siç na dëshmon Jani Vretoja<sup>28)</sup>, që kur morën vesh përpjekjet, që po bënин shqiptarët për kri-

27) Pa dyshim rolin kryesor në këtë rast duhet ta ketë luajtur Sami Frashëri, por kjo nuk na jep të drejtë ta quajmë atë alfabet të Samiut, siç e quajnë disa autorë.

28) J. Vreto, vep. cit., f. 270 v.

jimin e një alfabeti të gjuhës shqipe, ndërhyjnë pranë kryeministrat Ali Pasha që të mos e lejonte një gjë të tillë. Këto qarqe u orvatën t'i frikësonin shqiptarët myslimanë, që merrnin pjesë në mbledhjet për çështjen e alfabetit të përbashkët të shqipes, që të hiqnin dorë nga kjo punë. Më vonë, nga fillimi i shekullit XX, sidomos pas Kongresit të Manastirit, kur panë se shkrimi i shqipes ishte një proces i pandalshëm, siç do të vihet në dukje edhe më tutje, qeveritarët osmanë nëpërmjet veglave të tyre, ho-xhalla rëve fanatikë dhe agjentëve të tjerë turkomannë, filluan të trumbetonin se shqipja duhej shkruar me shkronjat arabe dhe jo me shkronjat latine, që ishin shkronjat e «kaurëve». Gjithashtu edhe qarqet heleniste, që me pikëpamjet e tyre shoviniste të «megali idhesë»<sup>29)</sup> orvateshin t'i paraqitnin ortodokssët shqiptarë si grekë, nëpërmjet Patrikanës dhe veglave të saj, peshkopëve dhe priftërinjve ortodoksë, në fillim bënë çmos që të pengonin shkrimin e gjuhës shqipe prej tyre. Por, kur e panë që ky ishte një proces i pandalshëm, atëherë edhe ata u vërsulën kundër shkronjave latine duke kérkuar zëvendësimin e tyre me shkronjat greke<sup>30).</sup>

Qarqet shoviniste greke dhe veglat e tyre, peshkopët e priftërinjtë ortodoksë, nuk u kufizuan vetëm me «mallékime» e «shkishërime» kundër patriotëve

29) «Megali idheja» («ideja e madhe») ishte platforma politike e qarqeve shoviniste greke, që kërkonin një Greqi të madhe, në të cilën do të përfshiheshin edhe viset e banuara nga ortodokssët jogrekë të Ballkanit.

30) Për këtë qëllim u themelua më 1884 në Athinë shqata «Vllamët shqiptarë» (I Vllamidhes Allvani); shih Historia e Shqipërisë, II, 208.

ortodoksë shqiptarë. Aktet kriminale të qarqeve shoviniste greke dhe «mallëkimet» e qarqeve klerikale ortodokse kundër patriotëve shqiptarë ortodoxë në shekullin XIX fillojnë që me helmimin e Naum Veqilharxhit më 1866 dhe vazhdojnë me vrasjen e Pandeli Sotirit më 1891 në Stamboll, të Papa Kristo Negovanit më 1905, të Petro Nini Luarasit më 1911 etj. Nuk munguan as «mallëkimet» dhe «shkishërimet» nga Patrikana e Stambollit dhe veçanërisht nga peshkop Anthimi i Gjirokastrës kundër librave shqipe dhe patriotëve të tillë si Koto Hoxhi, Jani Vretoja, si edhe nga peshkopi i Korçës, Fillareti, kundër mësuesit patriot, Petro Nini Luarasi, etj.<sup>31)</sup>

\* \* \*

Lufta kundër shkrimit të shqipes nuk mund të ishte e ndarë nga lufta kundër zgjimit të popullit shqiptar, ashtu sikurse përpjekjet për shkrimin e shqipes me një alfabet të vetëm, të përbashkët për të gjithë shqiptarët, nuk mund të ishin të ndara nga lufta për zgjimin e popullit shqiptar me anë të përhapjes së diturisë në gjuhën amtare, me anë të shkollës shqipe. E sa më shumë shtoheshin përpjekjet e patriotëve shqiptarë për hapjen e shkollave shqipe në atdheun e tyre të robëruar dhe të përmbytur nga propagandat helmuese të fuqive imperialiste dhe të shovinistëve fqinjë, aq më të tërbuara bëheshin orvatjet e armiqve të ndryshëm për t'i mbetur që në fillim këto përpjekje.

31) Shih Historia e Letërsisë Shqipe, II, 20, 220; Historia e Shqipërisë, II, 154, 222-223.

Në kohën që u themelua «Shoqërija e të shtypuri shkronja shqip» në Stamboll më 1879, në Shqipëri nuk kishte asnjë shkollë shqipe. Kurse shkollat e huaja, që synonin shkombëtarizimin e popullit shqiptar, kishin nisur të shpeshoheshin, sidomos në krahinat jugore të vendit. P.sh. në krahinat e Gjirokastërës, Vlorës e Beratit, sipas një statistike të vitit 1878, kishte 80 shkolla turke dhe 163 shkolla greke<sup>32)</sup>. Në fshatin Qestorat të Gjirokastrës ishte ngritur edhe një shkollë normale gregjash për djem dhe një tjetër për vajza. Për hapjen dhe mbajtjen e këtyre shkollave greke kujdeseshin organizatat heleniste, të themeluara me interesimin e Patrikanës së Stambollit dhe të qarqeve shoviniste greke, si «Vëllazëria qendrore kulturore» (themeluar më 1867) dhe në mënyrë të veçantë «Sillogu [= klub] kulturor epirot» (themeluar më 1871). Sillogu<sup>33)</sup> u themelua në një kohë kur Patrikana dhe qarqet shoviniste greke zunë të shqetësoheshin shumë nga përparimi, që po bënte lëvizja kombëtare shqiptare edhe në pjesën ortodokse të Shqipërisë. Prandaj krijimi i këtyre organizatave heleniste kishte si qëllim të drejtë përdrejtë të pengonte me çdo mjet pjesëmarrjen e ortodoxëve shqiptarë në lëvizjen patriotike dhe t'i bindonte ata se ishin grekë. Këtij avazi i binte edhe propaganda zyrtare osmane, e cila ortodoksët shqiptarë i konsideronte «rum» [=grekë].

Edhe në krahinat e tjera të Shqipërisë kishte vetëm disa «mejtebe» e «medrese» turke, qendra propagande të pushtuesve osmanë, ku mësonin tur-

32) Shih Historia e Shqipërisë, II, (105. et 106.)

33) Sillogu, në të cilin bënин pjesë edhe disa shqiptarë grekomanë, hapi edhe mjaft shkolla greke.

qisht e arabisht një pjesë shumë e vogël djemsh, në përgjithësi bij të klasave shfrytëzuese, që ishin të lidhura me armiqtë. Në disa qytete si Shkodra, Durresi e Vlora aty nga fundi i shekullit të kaluar u hapën edhe shkolla italiane dhe austriake<sup>34</sup>), që synonin përhapjen e kulturës e të ndikimit italian dhe austriak në Shqipëri.

Pra, gjendja e arsimit në Shqipëri në kohën e themelimit të shoqërisë së Stambollit ishte e tillë që, në vend që ta ndihmonte zgjimin dhe forcimin e ndërgjegjes kombëtare, përkundrazi e pengonte. Edhe mëpërmjet shkollave në gjuhë të huaja, që ishin hapur në Shqipëri, armiqtë e vendit tonë përpinqeshin ta thellonin përcarjen ndërmjet myslimanëve, ortodokseve dhe katolikëve shqiptarë, duke i paraqitur të parët si «turq», të dytët si «grekë» dhe të fundit si «latinë». Dhe në të vërtetë edhe pas reformës arsimore turke të vitit 1864, sipas së cilës çdo kombi të Perandorisë Osmane do t'i lejohej arsimi në gjuhën amtare, myslimanëve shqiptarë nuk iu njoh një e drejtë e tillë, sepse ata konsiderohejshin «turq». Përkundrazi, ikërkesat e qarqeve helegeniste të Stambollit për të hapur sa më shumë shkolla greke në viset e banuara nga ortodoksët shqiptarë, nuk u penguan, nën pretekstin se, siç u vu në dukje edhe më sipër, si Patrikana ashtu edhe qeveria turke ortodoksët shqiptarë i konsideronin «grekë». Edhe qarqet klerikale katolike të mbështetura nga Perandoria Austro-Hungareze hapën ndonjë

---

34) Haus-Hof-und Staatsarchiv — Politisches Archiv — Albanien (më tej do të citohet me shkurtimin H. H. St. A. PA-A.), Informacion i konsullit austriak në Selanik, 16 tetor 1908.

shkollë fetare, ku mësimet jepeshin në gjuhën italiane. Pra, edhe në këtë rast qëllimi i pushtuesve osmanë ishte i qartë: përçë e suundo. Në këtë politikë të tyre ata përkraheshin me zell nga Patrikana e Stambollit, që ishte një vegël e qarqeve heleniste, si edhe nga imperialistët e huaj, që kishin synimet e tyre grabitqare mbi Shqipërinë.

Në të tilla rrethana «Shoqërija e të shtypuri shkronja shqip» e Stambollit i vuri vetes si detyrë që të përhapte në Shqipëri dritën e diturisë me anë librash në gjuhën shqipe dhe, po të siguronte edhe mjetet e nevojshme financiare, të hapte edhe shkolla shqipe<sup>35)</sup>). Kjo shënoi një etapë të re në përpjekjet e patriotëve shqiptarë të shekullit të kaluar përtë përhapur arsimin e diturinë në gjuhën amtare në Shqipëri. Përpjekjet e mëparshme të këtij lloji, të bëra nga patriotë të tillë si Naum Veqilharxhi<sup>36)</sup>, Kostandin Kristoforidhi e Hoxhë Tahsini<sup>37)</sup>, Koto Hoxhi<sup>38)</sup> etj. kishin qenë të veçuara dhe nuk kishin

35) Shih Kanonizmë e Shoqërisë së të Shtypuri Shkronja Shqip, ribotuar në revistën «Diturija» (Tiranë); 2 (1926), 70.

36) Për këtë shih Historia e Letërsisë Shqipe, II, 18-19, si edhe Historia e Shqipërisë, II, 18.

37) Kristoforidhi e H. Tahsini ishin përpjekur të hapnin një shkollë shqipe në Berat më 1875. Shih Historia e Letërsisë Shqipe. II, 18-19.

38) Ky mësues patriot në shkollën normale të Qestoratit në orët e lira u mësonte fshehurazi nxënësve gjuhën shqipe dhe u ngjallte atyre dashurinë për gjuhën, për atdhenë, për gjithë shqiptarët pa dallim feje. Dy nga nxënësit e tij kanë qenë Pandeli Sotiri dhe Petro Nini Luarasi, të cilët ndoqën rrugën e mësuesit të tyre. Shih Historia e Shqipërisë, II, 106-107.

pasur sukses kryesisht për shkak të luftës së egër të armiqve turq e shovinistëve grekë.

Më në fund, pas shumë përpjekjesh, me interesimin e patriotëve shqiptarë të Stambollit dhe me ndihmën financiare të patriotëve shqiptarë të Bukureshit<sup>39</sup>), më 7 mars 1887 u hap në Korçë mësonjëtorja [shkolla] e parë shqipe, drejtori i parë i së cilës është qenë mësuesi patriot Pandeli Sotiri. Më vonë u hapën edhe disa shkolla të tjera shqipe, si ato të rrethit të Kolonjës që u çelën nga mësuesi tjetër patriot, Petro Nini Luarasi<sup>40</sup>), shkolla e vajzave në Korçë<sup>41</sup>) etj. Hapja e këtyre shkollave i tërboi edhe më shumë armiqtë e Shqipërisë, të cilët s'lanë gur pa lëvizur, me qëllim që t'i detyronin këto të pakta shkolla shqipe të mbylleshin sa më parë. Autoritetet osmane dhe veglat e tyre, hoxhallarët fanatikë, bënë çmos që fëmijët e myslimanëve shqiptarë të mos shikonin në shkollat shqipe. Aty nga viti 1890 autoritetet turke i ndaluan fëmijët myslimanë të ndiqnin shkollën shqipe<sup>42</sup>). Jo më pak u tërbuan qarqet klerikale ortodokse nga hapja e shkollave shqipe. Ato u përpoqën me të gjitha mjetet që t'i mbyllnin këto shkolla, të cilat me përpjekjet e patriotëve shqiptarë dhe me përkrahjen morale dhe materiale

39) Leja për hapjen e kësaj shkolle u dha në emër të Pandeli Sotirit. Shih Historia e Shqipërisë, II, 219; Historia e Letërsisë Shqipe, II, 19; Kolë Koci, Mësonjëtorja shqipe e Korçës, në «Arsimi Popullor», 3 (1961), 14-16.

40) P. N. Luarasi çeli një shkollë shqipe në Ersekë që më 1887. Më 1892 ai çeli gjashtë shkolla në fshatrat e Kolonjës. Shih Historia e Letërsisë Shqipe, II, 19.

41) Kjo shkollë u hap nga Gjerasim Qiriazi më 1891.

42) Shih Kolë Koci, art. cit., 14.

të masave të popullit mundën t'u rezistonin për një-farë kohe presioneve dhe intrigave të armiqve. Si-pas urdhreve të Patrikanës greke, dhespoti i Korçës, si pa se me «mallëkime» nga katedralja nuk mundi t'i ndalonte shqiptarët të çonin djemtë dhe vajzat e tyre në shkollat shqipe, së bashku me priftërinjtë dhe agjentët e tjerë grekë fillooi t'i kërcënonte ata që dërgonin fëmijët në shkollat shqipe, me vrasje nga bandat e andartëve, që do të fuste në Korçë<sup>43)</sup>. Prandaj shtypi demokratik shqiptar në atë periudhë vinte në dukje se «pas Turqisë armiku mirëpadashësi i Shqipërisë është kisha greke, patriku grek»<sup>44)</sup>.

Patriotët shqiptarë i rezistuan me guxim presionit të qeverisë turke, të Patrikanës greke dhe të agjenturës së saj, klerit ortodoks, dhe bënë të gjitha përpjekjet për t'i ruajtur shkollat e para shqipe. Por, të ndodhura përballë armiqve të shumtë dhe të tërbuar dhe duke mos pasur as mjetet shkollore dhe financiare të nevojshme, pjesa më e madhe e këtyre shkollave u mbyllën. Disi më gjatë u rezistoi presioneve dhe intrigave të qeveritarëve osmanë dhe të mitropolisë së Korçës mësonjëtorja e parë shqipe e Korçës. Por edhe kjo më në fund u mbyll në vitin 1902, kur autoritetet turke arrestuan mësuesin dhe drejtorin e fundit të saj, Nuçi Naçin, të akuzuar si pjesëmarrës të një organizate të fshehtë shqiptare<sup>45)</sup>.

Në kohën kur pengonte me të gjitha mjetet përhapjen e mësimit të gjuhës shqipe dhe shkollat shqi-

43) «Drita», Sofje, nr. 49, 13 gusht 1904.

44) «Drita», Sofje, nr. 89, 18 maj 1907.

45) H. H. St. A. PA. A. Promemorja e konsullit Kral mbi Shqipërinë nga viti 1901 gjer në fillim të vitit 1905; Vjenë, prill 1905.

pe, qeveria e sulltanit, me qëllim që të thellonte edhe më shumë përçarjen e shqiptarëve, dhe nën presionin e fuqive imperialiste, lejonte hapjen e shkollave të huaja në Shqipëri dhe në mënyrë të veçantë të atyre katolike italiane dhe austriake. Në vitet e para të shekullit XX u hapën shkolla të reja italiane në Shkodër, Durrës, Vlorë, Janinë, Shkup<sup>46</sup>), ku mësimi jepej në gjuhën italiane nga mësues italianë.

Në të njëjtën kohë u rrit edhe numri i shkollave katolike austriake në Durrës, Milot, Rrëshen, në Shkodër (ku austriakët përveç të tjerave kishin shkollën franceskane dhe një shkollë fillore të jezuitëve), Tiranë, Shkup, Prizren, Pejë, Lumë<sup>47</sup>). Sikurse pranonte vetë konsulli austriak në Shkodër, qëllimi i këtyre shkollave ishte «sigurimi i ndikimit austriak në Shqipëri»<sup>48</sup>; ndërsa konsulli Kral në raportin dërguar qeverisë së vet shkruante për shkollat italiane se «ato kanë për qëllim të krijojnë në Shqipëri institucionë kolonizatore me shpresë që një ditë ta pushtojnë këtë vend»<sup>49</sup>.

Si në gjithë politikën e tyre pushtuese në Shqipëri, edhe në çështjen e shkollave imperializmi ita-

46) H. H. St. A. PA. A. Informacion i konsullit austriak në Selanik, 16 tetor 1906; në Shkodër, 7 dhjetor 1908.

47) Po aty, në Shkodër, 25 shtator 1909; në Durrës, 6 tetor 1903. Archives du Ministère des affaires étrangères. France. Correspondance politique. Turquie. Politique intérieure. Albanie, v. VII. Informacion i konsullit francez në Shkup, 18 gusht 1902.

48) H. H. St. A. PA. A. Informacion i konsullit austriak në Shkodër, më 19 shkurt 1907.

49) Po aty. Promemorje e konsullit Kral mbi Shqipërinë nga viti 1901 gjer në fillim të vitit 1905. Vjenë, prill 1905.

lian dhe austriak mbështetetë në agjenturën e vet, në klerin katolik. Në fundin e shekullit XIX gjer në fillim të shekullit XX u zhvillua një luftë e ashpër midis qeverisë austriake, që donte të ruante përgjithmonë të drejtën e protektoratit fetar mbi shqiptarët katolikë, të siguruar me anë të kapitulacioneve, dhe të qeverisë italiane, që filloi të depërtonte në Shqipëri dhe të tërhiqte nga ana e vet klerin katolik<sup>50</sup>). Vetë përfaqësuesit austriakë në Shqipëri kanë qenë të detyruar të pranojnë «korrupsionin e madh të klerit katolik» që ishte blerë nga italianët<sup>51</sup>), ose edhe shërbimet që u bënin vetë atyre, duke deklaruar se «kleri katolik merr subvencionin sipas besnikërisë që shfaq për Austro-Hungarinë»<sup>52</sup>.

Për këtë arsyen shtypi demokratik shqiptar e luftoi me ashpërsi të madhe reaksionin klerikal dhe në mënyrë të veçantë atë katolik. Duke demaskuar politikën reaksionare dhe antishqiptare të jezuitëve, që predikonin në shkollat e veta se gjuha shqipe është krejtësisht e panevojshme, se ajo nuk vlen për asgjë dhe është një «gjuhë e vdekur», gazeta «Kombi» shkruante se «të dy fetë (muhamedane dhe katolike) kanë lidhur besë për të humbur gjuhën dhe kombin shqiptar: në njérën anë muhamedanizmi që mëson se është gjynah të këndosh dhe të mësosh shqip, dhe në anën tjetër kleri katolik që kundër-

50) Po aty. Shtojcë e raportit politik nga Stambolli, më 19 nëntor 1902. Instrukcion nga Vjena, 25 janar 1903.

51) Po aty. Promemorja e konsullit Kral mbi Shqipërinë nga viti 1901 deri në fillim të vitit 1905. Vjenë, prill 1905.

52) Po aty. Informacion i konsullit austriak në Durrës, më 6 tetor 1903.

shton dhe është armiku më i madh i mësimit në gjuhën shqipe»<sup>53)</sup>.

Nëpërmjet faqeve të shtypit shqiptar patriotët demokratë demaskuan dhe hodhën poshtë veçanërisht përpjekjet e klerit katolik për të vendosur kontrollin në lëvizjen kombëtare shqiptare. Rritja e lëvizjes kulturore si një nga shfaqjet e qëndresës së popullit shqiptar kundër sunduesve osmanë dhe shteteve shoviniste fqinje, tërboi dhe i bëri të bashkohen në luftë kundër shkollës dhe gjuhës shqipe gjithë armiqtë dhe reaksionarët që nga feudalët dhe nëpunësit e sultanit dhe deri tek klerikët myslimanë, priftërinjtë ortodoksë dhe katolikë që u shërbenin sunduesve osmanë, qarqeve imperialiste austro-hungareze, italiane dhe atyre të shovinistëve fqinjë.

Nëpërmjet faqeve të shtypit shqiptar patriotët rilindas e demaskuan këtë veprimtari reaksionare dhe antishqiptare të klerit; ata shkruanin se «më-këmbësit e Krishtit janë dërguar që të ndjekin me çfarëdo mënyre ata (shqiptarë) që kanë dashuri për gjuhën shqipe»<sup>54)</sup>, se dhespotët përdorin të gjitha mjetet dhe intrigat për të persekutuar gjuhën shqipe, që nga predikimet nga katedra e mitropolisë dhe mallëkimet e shkishërimet<sup>55)</sup> deri tek vrasjet nga prapa shpine të patriotëve shqiptarë, siç vepruan me

---

53) «Kombi», Boston, 10 korrik 1908, nr. 92, f. 91.

54) «Drita», Sofje, nr. 49, 13 gusht 1904. Letër nga Korça. Autori: Lis'i Stamos.

55) «Drita», Sofje, nr. 71, 15 dhjetor 1905. Gorgonët e kombit shqiptar. Autori: A. S. D. (Aleksandër Stavro Drenova).

ndihmiën e bandave të andartëve grekë me patriotët Papa Kristo Negovanin, Spiro Kosturin etj.<sup>56)</sup>.

Patriotët demokratë i bënin thirrje popullit që t'u rezistonte të gjitha intrigave dhe veprimeve anti-shqiptare të klerit, «të mos trëmbet nga mallëkimet e tyre, t'i mbyllë gojën klerit se dënon atdhetarizmin ndër shqiptarët, të kërkojë prej priftërinjve dhe hoxhëve që të rinë urtë e të mos prekin atdhetarizmin, ndryshe t'u japë teshat dhe t'u kthejë krahët e të shkojnë»<sup>57)</sup>. Mihal Gramenoja shkruante në ato ditë në gazeten «Kombi» se duhet «të bashkohemi dhe së bashku të shkallmojmë këta dy armiq (qeverinë turke dhe klerin) nga atdheu ynë»<sup>58)</sup> se «do të vijë dita kur Shqipëria do të sqohet, do të lirohet edhe pa dashjen e klerit, po atëhere e para e punës që do të bëjë, është të ndjekë tërë ata që iu kundërshtuan dhe e ndaluam për qëllimet e saj»<sup>59)</sup>.

Populli shqiptar dhe përfaqësuesit e tij më të përparuar, patriotët e Rilindjes, jo vetëm që nuk u përkulën përparrë armiqve të vendit tonë, por mobilizuan të gjitha forcat për t'i bërë ballë terrorist të sunduesve osmanë, intrigave të klerit dhe barbarive të bandave të armatosura të qarqeve shoviniste fqinje. Duke shprehur vendosmërinë e popullit tonë për të ruajtur dhe për të shkruar gjuhën e vet am-

56) «Drita», Sofje, nr. 86, 10 dhjetor 1906. Lutje për dëshmorin Spiro Kosturi.

57) «Kombi», Boston, nr. 58, 25 tetor 1907. Për djelmërinë e Shkodrës nga të cilët është shpres'e kombit. Autori: Guri i Capit (M. Grameno).

58) Po aty.

59) «Kombi», Boston, nr. 57, 18 tetor 1907. 18 vjeshtë e II 1907. Artikull i redaksisë.

tare, «Kombi» shkruante në dhjetor të vitit 1907 se «ido që jemi të varfër e që na ndjek qeveria dhe s'na le të çelim mësonjëtore, gjuha shqipe dhe nga gurët e rrugëve do të shkruhet dhe do të këndohet»<sup>60).</sup>

\* \* \*

Shkollat shqipe, nga njëra anë, dhe librat e të përkohshmet e botuara në kolonitë shqiptare të Bukureshtit e të Sofjes, nga ana tjetër, ndihmuani shumë jo vetëm për zgjimin dhe forcimin e ndërgjegjes kombëtare, por edhe për përhapjen e alfabetit të Stambollit, i cili, siç u vu në dukje edhe më sipër, me kohë nisi të konsiderohej nga shumë shqiptarë si një alfabet kombëtar. Megjithatë, çështja e një alfabeti të vetëm për shkrimin e shqipes mbeti e pazgjidhur përfundimisht. Dhe as që mund të zgjidhej në një kohë kur pushtuesit osmanë, shovinistët fqinjë, imperialistët e ndryshëm si edhe veglat e tyre, qarqet klerikale dhe feudale vendase, bënin çmos për t'i mbajtur shqiptarët të përçarë.

Siç u vu në dukje edhe më sipër, alfabeti i Stambollit u përhap vetëm në Shqipërinë Jugore e të Mesme si dhe në disa koloni shqiptare të mërgimit, si në ato të Stambollit, Bukureshtit, Sofjes etj. Përkundrazi, në Shqipërinë e Veriut, me qendër kulturore Shkodrën, ky alfabet nuک u përhap. Priftërinjtë katolikë vazhduan të përdornin alfabetit tradicional të shkrimtarëve të vjetër veriorë. Pas vitit 1899

---

60) «Kombi», Boston, nr. 31, 28 mars 1907. Nga Elbasani. Sotir Peci.

çështja e alfabetit u ndërlikua edhe më keq. Në këtë vit u themelua në Shkodër shoqëria «Bashkimi» e franceskanëve, e cila sajoi një alfabet të ri, të mbështetur në alfabetin latin dhe të plotësuar me disa dyshkronjësha. E pas viti 1901 numri i alfabeteve, që përdoreshin në Shkodër, u shtua, sepse edhe shoqëria e jesuitëve «Agimi» sajoi një alfabet të vetin, të mbështetur gjithashtu në alfabetin latin, por të plotësuar me disa shkronja latine me shenja diakritike. Kështu, në një qytet të vetëm si Shkodra, ku ndesheshin edhe interesat e kundiërtë të Austro-Hungarisë e të Italissë, midis vjetëve 1901-1908 për shkrimin e shqipes përdoreshin të paktën 3 alfabete të ndryshme<sup>61</sup>.

Përveç këtyre alfabeteve dhe alfabetit të Stambollit, para viti 1908 janë përdorur edhe alfabetet tjetra të mbështetura kryesisht në alfabetin latin. P.sh. e përkohshmja «Shqipëria» e Bukureshtit (1897-1898), «Albania» e Brukselit<sup>62</sup> (1897-1909), «Kombi» i Bostonit (1906-1909), «Besa» (1904), «Shqipëria» (1906) «Pellazgu» (1907) të Kajros etj. btoheshin vërtet me alfabetin latin, por me ndryshime midis tyre.

Në rrethana të tilla, për krijimin e një alfabeti

(61) Të kihet parasysh gjithashtu se në Shkodër nuk kanë munguar orvatjet për ta shkruar shqipen edhe me alfabetin arab. Atje pushtuesit osmanë botonin organin e vilajetit «Ishkodra», ku shqipja shkruhej me alfabetin arab (shih për këtë J. Kastrati, *Lufta për njësimin e alfabetit shqip* në vitet 1878-1905, SF 4, 1968, 103). Të kihet parasysh edhe abetarja shqipe e Daut Boriçit me shkronja arabe, e viti 1861 ose 1869 (shih. J. Kastrati, «Mësuesi», 18, 9, 1964, f. 4).

(62) Që nga viti 1902 kjo revistë u botua në Londër.

të vetëm të gjuhës shqipe, ishte e domosdoshme të bëhej një luftë e ashpër jo vetëm kundër reaksionit feudalo-klerikal e osman dhe intrigave të qarqeve shoviniste fqinje, që përpinqeshin të pengonin përhapjen e shkrimit shqip, por edhe kundër frysës dhe interesave lokale dhe egoiste të disa shoqërive dhe grupeve kulturore.

Patriotët shqiptarë me të drejtë e konsideronin mungesën e një alfabeti të përbashkët si një shenjë dasie, që pengonte bashkimin dhe konsolidimin kombëtar të popullit shqiptar. «Shqipëria» e Bukureshtit në artikujt «Për alfabetin», «Vellezër shqipëtarë» etj., botuar në vitin 1898, kritikonte përdorimin e alfabeteve të ndryshme nga organet e shtypit dhe theksonte se «kjo do të na sjellë një prapësi shumë të madhe në punë të gjuhës». Gazeta u bënte thirrje gjithë patriotëve shqiptarë «që gjuha shqip të shkruhet në një alfabet të njëjtë prej gjithë shqiptarëve, që gjithë organet e shtypit të hapin kolonat e tyre për këtë mendim».<sup>63)</sup>

Në fillim të shekullit XX çështja e alfabetit u bë shumë shqetësuese, u shtuan edhe më shumë përpjekjet e shtypit patriotik për vendosjen e një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe. Në vitin 1902 u botua thirrja që bëri «Shqipëria» e Egjiptit (Magaga) për të ngarkuar çdo shoqëri që të organizonte diskutimin e çështjes së njësimit të abecesë, rezultatet e të cilisë do të miratoheshin në një mbledhje përfundimtare, që do ta zgjidhte çështjen me shumicë

63) «Shqipëria», Bukuresht, nr. 44, 15 qershor 1898; Për Alfabetnë Artikull i redaksisë.

64) Po aty.

votash.<sup>65)</sup> Ky propozim u përkrah gjithashtu nga «Kombi» që hapi faqet e veta për diskutimin e alfabetit të vetëm<sup>66)</sup>.

Në përpjekjet e tyre për krijimin e një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe patriotët demokratë shqiptarë u ndeshën ballë për ballë me shovinistët grekë dhe reaksionin feudal dhe klerikal turk, që përpinqeshin t'i impononin popullit tonë alfabetin grek ose atë turko-arab me qëllim që të ndalonin përhapjen e arsimit në Shqipëri dhe të përçanin shqiptarët. Në artikullin e vet «Për Alfabetin» botuar në «Shqipëria» e Bukureshtit në vitin 1898, poeti i shquar i Rilindjes sonë kombëtare, A.Z. Çajupi, hedh poshtë shpifjet e propagandës shoviniste greke, që e quante gjuhën shqipe një dialekt të greqishtes, dhe thekson se «fjala e tyre është aqë e gënjeshtërt, bëre me qëllim të keq, pér nevojat që kanë në dëm të kombësisë tonë që kërkojnë ta shuanjë»<sup>67)</sup>. Edhe «Shqipëria» e Egjiptit në një artikull të A. Xhuvanit, botuar në vitin 1907, hedh poshtë përpjekjet e shovinistëve grekë dhe të grekomaneve pér të detyruar popullin tonë të marrë alfabetin grek me tezat fallso se gjoja «gjuha shqipe është një pemë e gre-

65) «Shqipëria», Magaga (Egjipt), nr. 4, 5 maj 1907. Dy fjalë pér Abecenë. Artikull i redaksisë.

66) «Kombi», Boston, nr. 30, 20 mars 1907. «Shqipëria», Magaga (Egjipt). Artikull i redaksisë.

67) «Shqipëria», Bukuresht, nr. 49, 31 gusht, nr. 50, 15 shtator; nr. 51, 1 tetor; nr. 52, 15 tetor; nr. 53, 1 nëntor 1898. Për alfabetnë. Autori: A. C. Zacua (Andon Çako-Zako Çajupi).

qishtes» dhe shkruan se qëllimi i tyre është që të bëhem «në mënyrë të pakuptueshme grekë»<sup>68</sup>).

Lufta për vendosjen e një alfabeti të njëjtë të gjuhës shqipe u shoqërua edhe me propozime konkrete për çështjen e alfabetit të bëra në shtypin shqiptar. A.Z. Çajupi në artikullin e përmendur më sipër shkruante se shqiptarët «duhet të shkojnë në një udhë të rrahur nga gjithë kombet e qytetëruara duke zgjedhur për gjuhën tonë një alfabet që gjendet lirë, njojurë nga gjithë bota..., po të mos jetë as qy i grekëve, as qy i turqeve, se ata janë ngaja [shkaku] e ndarjesë dhe e armiqësisë që ka hyrë ndë mes tonë»<sup>69</sup>). Çajupi thekson se «alfabeti latin pajtohet pun'e madhe me natyrën e gjuhës shqipe dhe se është e vëtmja mënyrë që mund të shkruanjë mirë gjuhënë tënë edhe të mbaronjë mbodhitë e turkomaneve dhe grekomanëve»<sup>70</sup>).

Për një alfabet të mbështetur në atë latin u shprehën edhe mjaft organe të tjera të shtypit shqiptar si «Shqipëria» e Egjiptit<sup>71</sup>), «Kombi»<sup>72</sup>), «Shpnesa e Shqypnisë»<sup>73</sup>) etj.

68) «Shqipëria», Magaga (Egjipt) nr. 5, 15 qershori 1907. Autori: Dok Sula (Aleksandër Xhuvani).

69) «Shqipëria», Bukuresht, nr. 49, 31 gusht; nr. 50, 15 shtator; nr. 51, 1 tetor; nr. 52, 15 tetor; nr. 53, 1 nëntor 1898. Për Alfabetnë. Autori: A. Ç. Zaçua (Andon Çako-Zako Çajupi).

70) Po aty.

71) «Shqipëria», Magaga (Egjipt), nr. 5, 15 qershori 1907. Autori Dok Sula (Aleksandër Xhuvani).

72) «Kombi», Boston, nr. 30, 20 mars 1907.

73) «Shpnesa e Shqypnisë», Raguzë, nr. 7-8, 28 prill 1907. Çështja e alfabetit. Autori: Kastrensis (Aleksandër Xhuvani).

Mungesa e një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe ishte një nga pasojat e mungesës së unitetit ekonomik dhe politik të vendit tonë, të copëtimit të krahinave të ndryshme të vendit si rrjedhim i prapambetjes ekonomike dhe ndarjes administrative të Shqipërisë, të ndikimit të ideologjisë reaksionare feudale dhe klerikale që helmonte ndërgjegjen e popullit tonë dhe mbillte dasi fetare dhe krahinore, të intrigave të pandërprera të fuqive imperialiste dhe të shteteve shoviniste fqinje, që përpinqeshin të përjetësonin përqarjen e popullit tonë për të gllabëruar tokat e tij. Pra, çështja e një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe që shndërruar në vendin tonë në një çështje politike, zgjidhja e së cilës do të varej nga zhvillimi i përgjithshëm i lëvizjes kom-bëtare në Shqipëri.

## **2. LËVIZJA POLITIKE-KULTURORE NË SHQIPERI NË PRAGUN E KONGRESIT TË MANASTIRIT**

Në fillim të shekullit XX vihet re një hov i ri i lëvizjes kombëtare shqiptare, që ishte i lidhur me forcimin e mëtejshëm të zgjedhës ekonomike dhe politike osmane, me zgjerimin e ndërhyrjes së shteteve imperialiste dhe shteteve fqinje në të ashtuquajturën «çështje maqedone», nën emrin e së cilës ata kérkonin të pushtonin edhe tokat shqiptare.

Kjo periudhë e lëvizjes kombëtare shqiptare karakterizohet nga një aktivizim i mëtejshëm i mësave të popullit, i fshatarësisë dhe i shtresave të varfra dhe mikroborgjeze të qytetit, në luftën për çlirimin kombëtar kundër zgjedhës osmane dhe kundër ndërhyrjes së shteteve imperialiste, nga formimi i rrymës demokratike-revolucionare që përfaqësohej nga elementë mikroborgjezë, kyesisht intelektualë të dalë nga fshatarësia punonjëse dhe mikroborgjezia e qyteteve. Elementët e rinj demokratë, të lidhur më ngushtë me masat e popullit, po vëcoheshin gjithmonë e më shumë nga rryma reformiste e çifligarëve liberalë dhe e borgjezisë liberale dhe po rriteshin në luftë me të.

Përfaqësuesit e rrymës demokratike-mikrobor-gjeze i dhanë lëvizjes kombëtare shqiptare një program më të përparuar në luftën kundër zgjedhës feudale turke dhe imperializmit dhe bënë përpjekje për ta realizuar atë me rrugën e kryengritjes së armatosur të masave të popullit dhe për t'i dhënë kësaj lufte një karakter të organizuar.

Kështu u formuan komitetet e fshehta «Për lirinë e Shqipërisë», si ai i Manastirit<sup>74</sup>), që luante rolin e komitetit qendror, dhe komitetet e tjera lokale që u përhapën me shpejtësi në fillim në Shqipërinë e Mesme dhe në Kosovë, pastaj edhe në Shqipërinë e Jugut dhe në atë të Veriut (Vilajeti i Shkodrës). Merita kryesore historike e komiteteve të fshehta «Për lirinë e Shqipërisë» qëndron në përpjekjet e tyre për t'i dhënë luftës së popullit shqiptar një karakter të organizuar dhe në formimin e çetave të armatosura si pikënisje për të realizuar kryengritjen e armatosur të popullit. Pas formimit të çetës së Bajo Topullit në pranverën e vitit 1906 lufta e çetave mori një përhapje të gjerë dhe në pranverën e vitit 1908, në pragun e revolucionit të turqve të rinj, u forcua edhe më shumë.

Pikërisht kjo luftë e armatosur e popullit shqiptar dhe e çetave maqedonase, nga njëra anë, dhe forcimi i ndërhyrjes së shteteve të mëdha në Turqinë evropiane, nga ana tjetër, i shtyti turqit e rinj (xhonturqit) të fillonin kryengritjen e armatosur më 3. korrik të vitit 1908<sup>75</sup>). Programi i turqve të rinj ishte në kundërshtim të hapur me atë të lëvizjeve

74) H. H. St. A. PA. A. Informacion i konsullit austriak në Manastir, 21 prill 1906.

75) «Hatirati Niazi», İstanbul, 1910; f. 38-40.

kombëtare dhe kishte për qëllim forcimin e zgjedhës turke mbi popujt joutq të perandorisë. A. Rizaj dhe ideologët e tjerë të turqve të rinj ishin kundërshtarë të autonomisë së popujve të shtypur dhe kërkonin të siguronin përkrahjen e tyre vetëm në bazë të luftës për kushtetutën e vitit 1876<sup>76</sup>). «Uniteti, tërësia tokësore e perandorisë, lënia në fron e dinastisë osmane, duke transformuar pushtetin arbitrar, absolutist në një monarki kushtetuese»<sup>77</sup>) përbënин thelbin e programit të lëvizjes së turqve të rinj.

Megjithatë, turqit e rinj, duke shfrytëzuar urrejtjen e popujve të shtypur ndaj regjimit gjakatar të Abdylhamidit, bënë përpjekje për t'i tërhequr ata, në mënyrë të veçantë shqiptarët, nga ana e vet. Në të vërtetë, lufta kundër absolutizmit të sulltanit, që kishte vendosur një regjim terrori të përgjakshëm në Turqi dhe në Shqipëri, ishte një pikë që bashkonte shqiptarët me turqit e rinj, megjithëse synimet e tyre në këtë luftë ishin krejtësisht të kundërtë. Me përmbysjen e regjimit të Abdylhamidit shqiptarët synonin të siguronin autonominë dhe të zhduknin vetë zgjedhën osmane.

Që kur filluan kryengritjen, turqit e rinj i mbështetën shpresat në përkrahjen e popullsisë shqiptare të vilajeteve të Manastirit, Kosovës dhe të gjithë Shqipërisë. Në të vërtetë, baza e kryengritjes u bë Shqipëria dhe Maqedonia. Sikurse pohojnë bashkëkohësit, përkrahja e revolucionit të turqve të rinj nga 30.000 fshatarë shqiptarë të armatosur të mbledhur në Ferizaj dhe bashkimi me ta i ushtrisë dhe

---

76) «Mesveret», Paris, 15 gusht 1897, nr. 41.

77) «Meşveret», Paris, 15 shkurt 1899.

në mënyrë të veçantë i korparmatës II të vendosur në Maqedoni dhe të përbërë krejtësisht prej ushtarësh dhe oficerësh shqiptarë, qenë dy faktorët kryesorë dhe vendimtarë, që e detyruan Abdylhamidin të pranonte rivendosjen e kushtetutës më 23-24 korrik 1908<sup>78)</sup>.

Si përfaqësues të shtresave të larta të borgjezisë së dobët turke, të lidhur akoma me shfrytëzimin gjysmëfeudal të fshatarësisë, turqit e rinj qysh në ditët e para të revolucionit treguan paaftësinë dhe mungesën e plotë të dëshirës për të zgjidhur problemet kryesore të revolucionit, siç ishin çështja agrare dhe çështja nacionale, dhe u kufizuan me shpaljen e kushtetutës, që sipas vlerësimit të V. I. Leninit «ishte vetëm një gjysmëfitore, madje pjesëza më e vogël e fitores»<sup>79)</sup>. Me politikën e tyre kundërrevolucionare dhe shoviniste turqit e rinj likuiduan gradualisht edhe këtë gjysmëfitore, u shkrinë plotësisht me çifligarët gjysmëfeudalë dhe kompradorët dhe ruajtën të paprekur regjimin e vjetër gjysmëfeudal dhe gjysmëkolonial të sulltanit, që tanë maskohej me mbulesën parlamentare dhe me ekzistencën e partisë së turqve të rinj («Bashkim e Përparim»), të organizuar sipas tipit evropian. Duke zbuluar thelbin e revolucionit turk, patriotët demokratë shqiptarë vinin në dukje me të drejtë se «pas ngjarjeve të korrikut të vitit 1908 sundimi i oligarkisë

---

78) «Hatirati Niazi», Istanbul 1910, f. 117. «Shkopi», 15 vjeshtë III, 1908, f. 1-2. S. Kulçe «Firzovik toplantisi ve meşrutiyet» Izmir 1943; «Shpnesa e Shqypnisë», 16-31 korrik 1908, vjeti IV., nr. 2, f. 1.

79) V. I. Lenin, Veprat, Vëll. 15, f. 198.

teokratike u zëvendësua me një despotizëm kush-tetues»<sup>80).</sup>

Në çështjen kombëtare turqit e rinj mbajtën një qëndrim të hapur shovinist dhe kundërrevolucionar, duke shpallur si parim kryesor osmanizmin, që përfshihej edhe në kushtetutën e vitit 1876 dhe që mohonte ekzistencën kombëtare të popujve të shtypur dhe si rrjedhim edhe luftën për lirinë dhe të drejtat e tyre. Në programin e miratuar në shtator të vitit 1908 turqit e rinj hoqën dorë nga të gjitha premtimet e tyre demagogjike të bëra gjatë revolucionit, e zëvendësuan të ashtuquajturën «barazi» me osmanizmin, shpallën gjuhën turke si gjuhë të detyrueshme në organet shtetërore dhe në shkollat dhe u vunë në mbrojtje të interesave të çifligarëve të mëdhenj dhe të borgjezisë kompradore kundër punëtorëve dhe fshatarëve turq si edhe kundër popujve të shtypur të perandorisë. Pranimi i doktrinës reaksionare të osmanizmit ishte në thelb vazhdimi i politikës së vjetër të asimilimit më të egër të popujve të shtypur, të turkizimit të tyre. Duke mbrojtur këtë doktrinë, organi i komitetit xhonturk «Bashkim e Përparim», gazeta «Tanin», shkruante në këtë periudhë se «turqit si pushtues kanë privilegje më të mëdha, prandaj nuk duhet t'u japid kombësive të tjera të drejta politike të njëjtë e t'i numërojnë një me veten e tyre»<sup>81).</sup>

---

80) Archives du Ministère des affaires étrangères. France. Correspondance politique. Turquie. Politique intérieure. Albanie. V. VII «Protestë e shqiptarëve të Egjiptit më 8-nentor 1912».

81) «Lajmëtari», Sofje, viti II, 6 qershori 1912, nr. 44, f. 2-3.

Turqit e rinj bënë të gjitha përpjekjet pér të shuar lëvizjen kombëtare shqiptare dhe në mënyrë të veçantë luftën e masave të popullit pér vetëqeverisje. Duke parë shturjen e plotë të administratës së vjetër turke në Shqipëri dhe mundësinë e kallimit të pushtetit në duart e shqiptarëve, ata shpejtuan të krijonin në të gjitha qytetet e Shqipërisë komitetet osmane «Bashkim e Përparim», që përqëndruan gjithë pushtetin në duart e tyre, duke u mbështetur në forcat ushtarake të vendosura në Shqipëri<sup>82)</sup>. Në përpjekjet e tyre pér të stabilizuar pushtetin e vet dhe pér të shuar lëvizjen kombëtare në Shqipëri, turqit e rinj u përkrahën nga klasat e pasura të Shqipërisë, nga aristokracia feudale, bejlerët, kleri mysliman, ortodoks dhe katolik si edhe nga nëpunësit e lartë, që hynë në përbërjen e komiteteve osmane «Bashkim e Përparim».

Revolucioni i turqve të rinj dhe mbulesa kushtuese e diktaturës së tyre krijoj kushte të favorshme pér bashkëpunimin e rrymës liberale-reformiste të lëvizjes kombëtare shqiptare, që shprehte interesat e çifligarëve liberalë, të borgjezisë librale dhe të nëpunësve të lartë, me turqit e rinj. Kështu gazeta «Liria» e Midhat Frashërit, që filloi të dilte në Selanik, pas shpalljes së kushtetutës i bënte thirrje popullit shqiptar që «të thyejë dufekët, thikat, jataganët»<sup>83)</sup>, d.m.th. të hijte dorë nga lufta e armatosur revolucionare. Bashkëpunimi me xhemijetin që gjoja «i do të mirën dhe i jep të drej-

82) H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Durrës, 29 korrik 1908.

83) «Liria» — Selanik, 14 korrik 1908, vjeti I, nr. 1, f. 3.

tat çdo kombi»<sup>84</sup>), «përkrahja me një fanatizëm të rrezikshëm e regjimit xhonturk»<sup>85</sup>), kufizimi i lëvizjes kombëtare vetëm me kërkesat arsimore-kulturore dhe largimi i saj nga rruga e luftës së armatosur revolucionare ishin synimet kryesore të rrymës liberale-reformiste në atë periudhë.

Ndryshe nga reformistët, demokratët-revolucionarë e quanin gjendjen shumë të favorshme për të realizuar «njohjen e kombit shqiptar dhe të kufijve të tij nga qeveria otomane»<sup>86</sup>), për shpalljen e «vetë-qeverisjes, të autonomisë së Shqipërisë, të kushtutës kombëtare shqiptare dhe të shtetit shqiptar»<sup>87</sup>). Duke konsideruar si detyrë kryesore luftën politike për të siguruar autonominë dhe çlirimin e Shqipërisë nga zgjedha turke, patriotët demokratë shfrytëzuan mundësitetë legale të krijuara përkohësisht pas revolucionit për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare dhe për bashkimin e popullit shqiptar nëpërmjet përhapjes së mësimit të gjuhës dhe shkollës shqipe në gjithë Shqipërinë, nëpërmjet futjes së gjuhës shqipe në të gjitha shkollat e huaja në Shqipëri si dhe me anë të vendosjes së një alfabeti të vetëm, që do të ndihmonte shumë për krijimin e unitetit kombëtar të shqiptarëve<sup>88</sup>). Për të realizuar këto detyra, patriotët demokratë krijuan menjëherë pas revolucionit klubet shqiptane, që u përhapën me shpejtësi në qytete dhe fshatra të vendit tonë si edhe në qytete

84) «Liria» — Selanik, vjeti I, 18 tetor 1908, nr. 12 f.2.

85) «Dielli», Boston, Moti I, 18 qershor 1909, nr. 12, f.2.

86) AShRPSSh, F.Klubi «Bashkimi» i Manastirit D. 5, fl. 135-136. «Shkopi» (Kajro), 15 vjeshtë III 1908; nr. 4, f.2-4.

87) «Kombi» (Boston), 27 korrik 1908; 31 korrik 1908.

88) «Shkopi» (Kajro), 15 vjeshtë III 1908, nr.4, f. 2-4.

të tjera ku kishte shqiptarë dhe që u shndërruan në organizata të gjera me karakter kombëtar, organë të luftës kundër reaksionit xhonturk për bashkimin e popullit shqiptar, për ngritjen e nivelit të tij arsimor dhe kulturor. Menjëherë pas shpalljes së kushtetutës, në ditët e fundit të korrikut u themelua nga patriotët shqiptarë klubi «Bashkimi» i Manastirit<sup>89</sup>), që luajti një rol të madh në formimin e klubave të tjera dhe në zhvillimin e lëvizjes kombëtare shqiptare në periudhën e reaksionit xhonturk. Nën shembullin e klubit «Bashkimi» të Manastirit u formuan në muajt gusht e shtator të vitit 1908 klubit i Korçës, i Elbasanit, i Shkodrës, i Shkupit, i Selanikut, i Stambollit, i Pogradecit, i Janinës, i Vlorës. Në periudhën e mëvonshme u formuan klube shqiptare në Tiranë, Durrës, Berat, Gramsh, Gjirokastër, Strugë, Ohër, Dibër, Tetovë, Vuçitern, Tepelenë, Delvinë, Filat, Follorinë, Kurvelesh, Përmet, Pogon, Konicë, Negovan, Bellkamen<sup>90</sup>) etj. Si pas të dhënavë të shtypit të atëhershëm, në gjithë Shqipërinë u themeluan më shumë se 40 klube<sup>91</sup>).

---

89) H.H.St.A.PA.A. Informacion i konsullit austriak në Manastir, 31 gusht 1908.

AShRPSSh, F. Klubi shqiptar «Bashkimi» i Manastirit, D.1, D.7, fl. 291 D.9, fl.1.

90) H. H. St. A. PA. A. Informacion i konsullit austriak në Manastir, 31 gusht 1908, 15 shtator 1908; në Shkodër, 21 shtator 1908; në Shkup, 1 shtator 1908; në Selanik, 7 shtator 1908, në Vlorë, 3 nëntor 1908; në Durrës, 11 maj 1909; AShRPSSh, F. Klubi «Bashkimi» i Manastirit, D. 5, fl. 73-74; D. 6, fl. 145. AShRPSSh, F. Klubi «Dituria», Korçë, D. 1, dok. = A 30.

91) «Dielli» (Boston), Viti I, 1910, 22 prill; nr. 5, f. 2-3.

Klubet kishin përkrahjen e popullit shqiptar, që i konsideronte ato si organet e veta kombëtare në luftën kundër regjimit xhonturk.

Ekzistanca e dy rrymave në lëvizjen kombëtare shqiptare në atë periudhë dhe struktura komplekse klasore e vendit tonë u pasqyruan edhe në përbërjen heterogjene të klubeve shqiptare, ku krahas elementeve demokratë mikroborgjezë, që luanin rolin kryesor në mjaft klube, gjemjë edhe përfaqësuesit e rrymës liberale-reformiste, çifligarë (bejlerë) dhe borgjezë (tregtarë) liberalë, nëpunës të mëdhenj, officerë si edhe aristokratë feudalë të lidhur me regjimin xhonturk në Shqipëri<sup>92)</sup>. Në këto kushte klubet u shndërruan jo vetëm në një arenë të luftës kundër regjimit xhonturk në Shqipëri, por edhe në një arenë të luftës dhe të kontradiktave klasore brenda forcave të lëvizjes kombëtare, për hegjemoninë e demokratëve mikroborgjezë apo të elementeve liberalë në lëvizjen kombëtare, për programin dhe perspektivat e saj, për metodat revolucionare apo reformiste të luftës etj.

Bashkëpunimin midis rrymës liberale të mode ruar dhe komitetit «Bashkim e Përparim», përveç interesave të përbashkëta ekonomike dhe politike të çifligarëve dhe të borgjezëve tregtarë që përfaqësonin ata, e lehtësoi edhe politika demagogjike e turqve të rinj. Këta në periudhën e parë, për shkak të rolit të madh që luajtën shqiptarët në revolucion dhe të stabilizimit të pamjaftueshëm të diktaturës

---

92) A. H. St. A. PA. A. Informacion i konsullit austriak në Manastir, 31 gusht 1909 dhe 15 shtator 1908; në Shkup 1 shtator 1908; në Selanik 7 shtator 1908; në Vlorë, 3 nëntor 1908.

së tyre ushtarake, dhe sidomos duke dashur ta larginonin lëvizjen kombëtare shqiptare nga rruga e luf-tës së armatosur dhe ta kufizonin atë vetëm me mjete legale kushtetuese, nuk guxuan të dilnin haptazi kundër klubeve dhe lëvizjes kulturore-arsimore në Shqipëri dhe u përpinqën të krijonin përshtypjen se nuk i kundërshtonin ato<sup>93</sup>). Në të njëjtën kohë turqit e rinj bënë përpjekje dhe përdorën mjete nga më të ndryshmet për të shtënë në dorë drejtimin e lëvizjes legale arsimore-kulturore, që kishin filluar klubet shqiptare.

Duke u mbështetur në elementët e moderuar proturq (Midhat Frashërin, Abdyl Ypin, Arif Hiq-metin etj.), turqit e rinj shtinë në dorë dy nga klubet shqiptare, atë të Stambollit dhe atë të Selanikut, dhe u përpinqën që nëpërmjet tyre të vinin nën kontrollin e vet gjithë klubet dhe vetë lëvizjen kombëtare dhe ta futnin atë në rrugën e bashkëpunimit me regjimin xhonturk. Në mbledhjen e organizuar në Selanik në fillim të shtatorit të vitit 1908 përmiratimin e statuteve të klubeve shqiptare, Midhat Frashëri dhe shokët e tij deklaruan se «këto shoqëri (clubet) nuk duhet të ndjekin qëllime politike, por vetëm e vetëm qëllime humanitare» dhe, pasi i bënë lavdërimë kushtetutës, bënë thirrje për unitet me komitetin «Bashkim e Përparim»<sup>94</sup>.

Me gjithë përkrahjen e elementëve proturq, turqit e rinj nuk ia arriten qëllimit të tyre; as klubet

---

93) AShRPSSh. F. Klubi «Bashkimi» i Manastirit, D. 7, fl. 291, D. 9 fl. 1. D. 6 fl. 350.

94) H. H. St. A. PA. A. Informacion i konsullit austriak në Selanik, 7 shtator 1908.

as edhe lëvizja kombëtare shqiptare në këtë periu-dhë nuk e humbën karakterin e tyre luftarak dhe të pavarur. Për këtë dëshmon edhe formimi pranë klubeve i komiteteve të fshehta, që kishin qëllime politike dhe pikërisht «të ngrinin ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve, të farkëtonin bashkimin e tyre që të ishin të gatshëm të kundërshtonin regjimin xhonturk në momentin e përshtatshëm dhe të siguronin autonominë e Shqipërisë»<sup>95</sup>). Sipas njoftimeve të konsujve austriakë, komitete të tilla të fshehta «u formuan në çdo qytet dhe fshat të Shqipërisë»<sup>96</sup>.

Patriotët demokratë shqiptarë, duke konsideruar si detyrë kryesore të lëvizjes kombëtare shqiptare luftën politike për autonominë e Shqipërisë, për cilimin e saj nga zgjedha turke, në kushtet shumë të vështira të reaksionit xhonturk, të përçarjes që mbillnin kleri mysliman, ortodoks dhe katolik, dhe të intrigave të Fuqive të Mëdha dhe të fqinjëve shovinistë, zhvilluan një luftë të ashpër dhe të guximshme për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare dhe bashkimin e popullit shqiptar me anë të lëvrimit të gjuhës e të letërsisë dhe me anë të shkollave shqipe. Klubet shqiptare qysh në ditët e para të formimit të tyre u bënë qendra të kësaj veprimtarie kulturore dhe arsimore të patriotëve shqiptarë, që do të ndihmonte në konsolidimin e mëtejshëm të vetë kombit shqiptar në bazë të lëvrimit të gjuhës dhe të kulturës së përbashkët demokratike shqiptare. Lufta

---

95) Po aty. Informacion i konsullit austriak në Manastir, 7 dhjetor 1908.

96) Po aty. Informacion i konsullit austriak në Manastir, 30 nëntor 1908 dhe 9 maj 1908.

për mësimin dhe lëvrimin e gjuhës dhe për hapjen e shkollave shqipe si mijete për ngritjen e ndërgjegjes dhe bashkimin kombëtar të popullit shqiptar në një kohë kur as sunduesit turq, as imperialistët dhe shtetet shoviniste fqinje nuk donin të pranonin ekzistencën e kombit shqiptar, pati një rëndësi të madhe politike dhe ndihmoi për bashkimin e forcave demokratike dhe përparimtare të popullit tonë në luftën kundër armiqve të brendshëm dhe të jash-tëm.

Nën drejtimin e patriotëve demokratë dhe të klubeve populli shqiptar filloi të realizonte një nga aspiratat e tij shekullore, të drejtën për të shkruar gjuhën e vet dhe për shkollën kombëtare, që ishte një nga kërkesat kryesore të rilindasve. Kështu me inisiativën e klubeve dhe me përkrahjen aktive të masave të popullit në mjaft qytete dhe fshatra të Shqipërisë, menjëherë pas shpalljes së kushtetutës, filluan të hapeshin shkolla shqipe dhe të përhapej mësimi i gjuhës shqipe. Në fillim të gushtit të vitit 1908 u hap në Elbasan shkolla fillore shqipe që pënnonte me abetaren e S. Frashërit<sup>97)</sup>. Në të njëjtën kohë filloi mësimi i gjuhës shqipe edhe në shkollat e Tiranës. Me inisiativën e klubit «Dituria» të Korçës u rihapën gjithashtu dy shkollat shqipe të Korçës. Hapja e dy shkollave shqipe në Berat u shoqërua me një manifestim prej 2.000 vetësh, që u organizua në fillim të gushtit 1908 përpara godinës së klubit «Bashkimi». Në të dyja shkollat e Beratit

---

97) Po aty. Informacion i konsullit austriak në Tiranë-Durrës, 17 gusht 1908.

mësimi jepej nga patrioti Jorgji Karbunara (Babë Dudë Karbunara)<sup>98)</sup>.

Një nga qendrat kryesore të lëvizjes politike-kulturore kombëtare u bë në atë kohë Gjirokastra, ku u çelën gjithashtu klube dhe shkolla shqipe. «Më 1908 — shkruan shoku Enver Hoxha, — u hap në qytetin e Gjirokastërës shkolla e parë shqipe, së cilës populli i dha emrin plot domethënje politike: Liria. Pas dy vjetësh u çelën shkollat shqipe edhe në Libohovë, në Labovën e Madhe e pastaj me radhë në krahina të tjera të qarkut»<sup>99)</sup>.

Nga shkollat e para shqipe të hapura me inisiativën e klubeve shqiptare qenë gjithashtu shkollat fillore të Vlorës, Fierit, Janinës, ku mësimi jepej nga patriotët e rinj shqiptarë, nxënës të shkollave të mesme turke<sup>100)</sup>. Duke marrë parasysh vështirësitë e mëdha për hapjen e shkollave shqipe dhe për zgjerimin e tyre të shpejtë si edhe për të ndihmuar sa më shumë në përhapjen e mësimit të gjuhës shqipe, klubet shqiptare të Elbasanit, Janinës dhe të qyteteve të tjera vendosën që gjuha shqipe të futej si lëndë mësimi në të gjitha shkollat shtetërore turke si edhe në shkollat greke etj. dhe kërkuan nga auto-

---

98) AShRPSSh. Letra e Sotir Kolesë dërguar A. Tashkos — Aleksandri, 24 tetor 1908.

H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Vlorë-Berat, 27 gusht 1908.

99) Enver Hoxha Raporte e fjalime 1972-1973. Tiranë 1974, f. 430.

100) AShRPSSh. Letër e S. Kolesë dërguar A. Tashkos, Aleksandri, 24 tetor 1908.

H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Janinë, 2 nëntor 1908.

ritetet lokale që ky vendim të zbatohet sa më parë. Klubi i Elbasanit me përkrahjen e popullsisë «siguroi edhe të hollat, që nevojiteshin për mbajtjen e mësonjësve që do të jepnin gjuhën shqipe në të gjitha shkollat e qytetit dhe, po ta lypet nevoja, edhe në ato të katundeve»<sup>101</sup>). Por valiu i vilajetit të Manastirit, duke zbatuar politikën shoviniste të turqve të rinj, e hodhi poshtë këtë kërkesë, duke dekluaruar se priste urdhër nga Stambolli. Të njëjtën përgjigje i dhanë reaksionarët xhonturq kërkesës së klubit shqiptar të Janinës pér futjen e gjuhës shqipe në shkollat turke dhe greke të vilajetit.

Megjithatë, edhe në këtë fushë patriotët shqiptarë siguruan sukseset e para në luftën kundër reaksiionit. Në shkollën greke të Elbasanit u fut gjuha shqipe si gjuhë mësimi dhe gjuhës greke iu la vendi i dytë,<sup>102</sup>) ndërsa klubi shqiptar i Janinës siguroi dërgimin e mësuesve të gjuhës shqipe në disa qendra si në Përmet, Frashër etj., ku u hapën gjithashtu shkolla shqipe. Në vjeshtë të vitit 1908, u sigurua futja e mësimit të gjuhës shqipe në gjimnazin shtetëror të Manastirit<sup>103</sup>). Patriotët shqiptarë i shndërruan edhe klubet në shkolla dhe qendra pér mësimin dhe përhapjen e shkrimit shqip. Në shtator të vitit 1908 klubi i Elbasanit u përpoq që të çelej pranë tij një kurs pér të ndihmuar mësuesit, që

---

101) AShRPSSh, F. Klubi shqiptar «Bashkimi» i Manastirit, D. 6, fl. 146.

102) H. H. St. A. PA. A. Informacion i konsullit austriak në Durrës, 7 nëntor 1908.

103) Archives du Ministère des affaires étrangères. France. Correspondance politique. Turquie. Politique intérieure. Albanie, v. VII. Informacion i konsullit françez në Manastir, shkurt 1909.

jepnin gjuhën shqipe në shkollat e fshatrave, ndërsa në titor u çel pranë klubit një shkollë nate<sup>104)</sup>, ku mësonin çdo mbrëmje 60-70 të rinj. Edhe në klubet e Korçës, të Janinës, të Filatit si edhe në të gjitha klubet e tjera shqiptare ishin hapur kurse mbrëmjeje të gjuhës shqipe për të rritur<sup>105)</sup>. Pra, klubet shqiptare plotësonin në njëfarë mënyre mungesën e shkollave shqipe.

Në përshëndetjen që shoku Enver Hoxha i drejtoi popullit të Gjirokastrës më 24 maj 1977, me rastin e inaugurimit të Qendrës së re muzeale dhe të Obeliskut, duke vlerësuar lart përpjekjet dhe luttën heroike të të gjithë patriotëve shqiptarë, themelues të klubeve dhe të shkollave shqipe, tha: «Këto klube e shoqëri patriotike, që u hapën anembanë vendit, u bënë boshti i gjithë asaj lëvizjeje të fuqishme që i kish vënë vetes si qëllim të fitonte pavarësinë e lirinë e Atdheut, të luftonte për gjuhën e shkollën shqipe, për zhvillimin e përparimin e kulturës kombëtare, të muzikës, të teatrit e të folklorit tonë të mrekullueshëm, për demokraci, zhvillim e përparim shoqëror»<sup>106)</sup>.

Hapja e shkollave të para u prit me gjëzim dhe entuziazëm të madh nga gjithë populli shqiptar e kjo u shpreh jo vetëm në letrat e shumta, që u vinin klubeve shqiptare, por edhe me përkrahjen dhe ndih-

104) AShRPSSh. F. Klubi shqiptar «Bashkimi» i Manastirit, D. 5, fl. 137-138. «Korça», viti I, 22 janar 1909 nr. 4. f. 4.

105) AShRPSSh, F. Klubi «Dituria» D. 1, dok. A. 30. H.H.St. A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Janinë, 15 mars 1909.

106) «Zëri i Popullit», Nr. 125 (8984), 25 maj 1977.

mën materiale, që jepte populli për mbajtjen e shkollave shqipe, në një kohë kur qeveria e xhonturqve jo vetëm që nuk jepte as një grosh për to, por nxirrte edhe pengesa të shumta për të ndaluar përhapjen e shkollave dhe klubeve shqiptare<sup>107</sup>).

Duke qenë krijesa të vetë popullit, shkollat shqipe u shndërruan në fole të zgjimit dhe të bashkimit kombëtar të shqiptarëve. Ato ishin jashtë ndikimit të shkollave fetare dhe bashkonin të gjithë fëmijët shqiptarë, myslimanë e të krishterë, dhe kontribuonin kështu në asgjësimin e politikës së dasisë fetare, që zbatonin sunduesit osmanë.

Mësimi i gjuhës shqipe dhe përhapja e shkrimit dhe e shkollës shqipe u shndërruan në një lëvizje të gjerë patriotike, e cila përfshiu masat e popullit, që shfaqën një dëshirë të zjarrtë për të mësuar gjuhën e vet amtare. Për këtë dëshmojnë edhe kërkesat e shumta për qindra e mijëra abetare dhe libra shqipe, që u vinin klubeve shqiptare dhe shoqërise patriotike të Bukureshit dhe Sofjes.<sup>108</sup>)

Kundër përhapjes së shkollave dhe të shkrimit shqip u ngritën jo vetëm autoritetet reaksionare xhonturke, që nxorën njëmijë pengesa dhe «kërcënönin me internim patriotët, që nxisin shqiptarët të mësonin gjuhën e tyre»<sup>109</sup>), por edhe kleri reaksionar mysliman. Në Tiranë, Durrës, Shkodër, Dibër, Ohër

107) ASHPSSh, F. Klubi «Dituria», D. 1, Dok. A. 30. H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Janinë, 15 mars 1909.

108) ASHPSSh, F. Klubi «Bashkimi» i Manastirit, D. 5, D. 6, fl. 182.

109) ASHPSSh, F. Klubi shqiptar «Bashkimi» i Manastirit, D. 5, fl. 55-56.

etj. kleri ultrareaksionar mysliman, duke i shërbyer aristokracisë feudale dhe sundimit xhonturk në Shqipëri, përpiquej të ndalonte shkrimin dhe mësimin e gjuhës shqipe duke e shpallur atë si një veprimitari që ishte në kundërshtim me fenë myslimane edhe me kuranin. Me urrejtje të madhe e priten hapjen e shkollave të para shqipe në Shqipërinë e Jugut edhe shovinistët grekë, të cilët përdorën kundër tyre të gjitha mjetet e mundshme, që nga kërcenimet e klerikëve grekë kundër shqiptarëve që dërgonin fëmijët në shkollat shqipe, ose mësonin vetë shkrimin shqip, deri tek «bandat e andartëve që sulmonin patriotët shqiptarë dhe shkollat shqipe në vilajetin e Janinës»<sup>110</sup>).

Shkolla shqipe, si edhe lëvizja kombëtare në përgjithësi, u rrit në luftë me intrigat dhe përpjekjet e fuqive imperialiste, që përdorën mjete nga më të ndryshmet pér të realizuar planet e tyre pushtuese në Shqipëri. Imperialistët amerikanë me anë të misioneve të tyre bënë përpjekje pér të ngritur shkolla fillore shqipe në Tiranë, Elbasan, ndërsa ata austriakë nëpërmjet konsuve të tyre u përpoqën të ngrinin një shkollë të tillë në Durrës; parashikohej gjithashtu të ngriheshin shkolla austriake në Kastrat dhe Lezhë<sup>111</sup>). Konsulli austriak në Durrës, në reportin që i dërgonte qeverisë së vet, theksonte se këto shkolla do t'i shërbnin rritjes së «ndikimit të tyre

110) AShRPSSh, Dok. 630090. Letër e Kol Kamsit (Vlorë) dërguar N. Ivanajt në 2/15 gusht 1908; Fondi Klubi Shqiptar «Bashkimi» i Manastirit, D. 5.

111) H. H. St. A. PA. A. Informacion i konsullit austriak në Shkodër, 7 dhjetor 1908.

në Shqipëri»<sup>112</sup>), dmth. realizimit të planeve të tyre pushtuese. Kundër shkollave të para shqipe u vërsulën me tërbim dhe me urrejtje edhe imperialistët italianë, përfaqësuesi i të cilëve në Vlorë (Pokardi) sulmoi shkollën e parë shqipe dhe patriotët vlonjatë dhe deklaroi me sarkazëm se «tani së shpejti shqiptarët do të na themelojnë edhe një universitet»<sup>113</sup>). Konsujt e huaj i konsideronin shkollat kombëtare shqipe si antikushtetuese dhe nxisin reaksionarët xhonturq t'i mbyllnin ato<sup>114</sup>). Ndërkaq imperialistët italianë, sikurse ata austriakë, kerkuan të hapnin shkolla të reja italiane në fshatrat më të rëndësishme të Mirditës, një shkollë për djem në Tiranë dhe një në Elbasan. Në njoftimin e vet konsulli austriak në Shkodër vinte në dukje se këto shkolla do të ndihmonin për përhapjen e kulturës dhe të ndikimit italian në Shqipëri<sup>115</sup>). Patriotët demokratë shqiptarë zhvilluan një luftë të ashpër kundër shkollave të huaja, për t'i kthyer ato në shkolla shqipe dhe për të ndaluar hapjen e shkollave të reja të huaja.

Krahas me shkollat një përhapje të gjerë mori në Shqipëri edhe shtypi; patriotët shqiptarë ngritën pranë klubeve shtypshkronja dhe filluan të botonin gazeta shqipe në Manastir («Bashkimi i Kombit» dhe më vonë «Drita»), në Korçë («Korça» etj.), në

---

112) H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Durrës, viti 1908, Ref. 73.

113) Po aty. Informacion i konsullit austriak në Vlorë-Berat, 27 gusht 1908.

114) Po aty.

115) Po aty. Informacion i konsullit austriak në Shkodër, 25 shtator 1909.

Janinë («Zgjimi i Shqipërisë»), si edhe në Elbasan, Shkodër, Stamboll dhe në qytete të tjera<sup>116)</sup>.

Vazhdoi të zgjerohej edhe veprimtaria kulturore e politikë e shoqërive patriotike të mërgimit dhe në mënyrë të veçantë e shoqërisë «Dituria» të Sofjes dhe e «Bashkimit» të Bukureshtit që vunë të gjitha mjetet e tyre në shërbim të përhapjes së mësimit dhe të shkollës shqipe. Një rol të madh në lëvizjen kombëtare dhe në luftën për shkollën shqipe luajtën në këtë periudhë organët e jashtme të shtypit shqiptar si «Shqypeja e Shqypnis» (Sofje), «Rrufeja» (Egjipt), «Shkopi» (Egjipt) etj. Në vitet 1908-1910 botoheshin në Shqipëri dhe jashtë më shumë se 20 organe shtypi.

116) AShRPSSh, F. Klubi shqiptar «Bashkimi» i Manastirit, D. 1, D. 6, fl. 145, D. 4. Kalendar i Korpçës, 1911, Moti II, f. 17-20.

### **3. KONGRESI I MANASTIRIT**

Përhapja e shkollave dhe e shkrimit shqip edhe sukseset, që arritën patriotët shqiptarë në luftën për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar, shtruan domosdoshmérinë e vendosjes së një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe. Por për këtë qëllim ishte e domosdoshme të bëhej një luftë e ash-për jo vetëm kundër reaksionit xhonturk, intrigave të fuqive të huaja dhe reaksionit klerikal, por edhe kundër frysës dhe interesave lokale dhe egoiste të disa shoqërive dhe grupeve kulturore. Krijimi i një alfabeti të vetëm do të ndihmonte jo vetëm në lë-vrimin e mëtejshëm të gjuhës dhe të letërsisë shqipe, por edhe në konsolidimin e unititetit kombëtar të popullit shqiptar, në bashkimin e tij politik në luftën kundër zgjedhës turke dhe kundër synimeve push-tuese të shteteve imperialiste dhe fqinje.

Në letërkëmbimin me klubin e Manastirit, që mori iniciativën për thirrjen e Kongresit të alfabetit, patriotët shqiptarë shkruanin se «çështja e abecesë është një çështje e madhe dhe na pengon shumë përparimin kombëtar», se «me abecenë unike do t'u jepet një goditje e fortë shkollave dhe intrigave greke

në Shqipërinë e Jugut»<sup>117</sup>), se «alfabeti unik provon se kombi ynë është bërë një si komb»<sup>118</sup>), se ai «do të ndihmojë edhe për përparimin e vendit tonë në fushën ekonomike, në industri, tregti etj.»<sup>119</sup>)

Iniciativën për thirrjen e kongresit kombëtar përvendosjen e një alfabeti të vetëm, siç u vu në dukje edhe pak më sipër, e mori klubin shqiptar «Bashkimi» i Manastirit, që luante rolin kryesor midis klubave shqiptare. Qysh në ditët e para të shpalljes së kushtetutës patriotët shqiptarë, duke kuptuar rëndësinë e madhe që kishte çështja e alfabetit të vetëm për zhvillimin e mëtejshëm të lëvizjes kombëtare në Shqipëri, e shpallën atë si detyrën e tyre immediate. Qysh në muajin gusht të vitit 1908 kryesia e klubit «Bashkimi» të Manastirit, u njoftoi gjithë klubave dhe shoqërise brenda dhe jashtë Shqipërisë propozimin përmbledhjen e kongresit të alfabetit më 14 nëntor të vitit 1908, dhe në shtator u shpërndau atyre iftesat per zgjedhjen e delegatëve, ku theksohej se «interesi kombëtar shtron nevojën e njësimit të alfabetit të gjuhës sonë për përparimin e popullit tonë»<sup>120</sup>.

Iniciativa e klubit «Bashkimi» të Manastirit për thirrjen e kongresit të alfabetit u prit me gjërim nga gjithë populli shqiptar dhe pati përkrahjen e tij të

117) AShRPSSh, F. Klubi shqiptar «Bashkimi» i Manastirit, D. 5, fl. 148.

118) Po aty, F. Th. Gërmenji, D. 12.

119) Po aty, F. Klubi «Bashkimi» i Manastirit, D. 7, fl. 9, dok. 50.086.

120) Po aty, F. Shoqëria kulturale shqiptare e Bukureștit, D. 80, fl. 219. F. Klubi «Bashkimi» i Manastirit, D. 7, fl. 9, Dok. 50.086.

plotë. Në letrat, që i erdhën klubit «Bashkimi» të Manastirit nga klubet dhe shoqërítë shqiptare, si nga ai i Elbasanit, i Janinës, i Shkupit, i Shkodrës, i Beratit, i Starovës, i Ohrit, nga kolonitë shqiptare të Kajros, të Aleksandrisë, të Bukureshtit, të Varnës, nga shoqëria «Besa-besën» dhe nga dhjetra klube, shoqëri dhe patriotë shqiptarë brenda dhe jashtë atdheut, shprehej entuziazmi i gjithë patriotëve shqiptarë për thirrjen e kongresit dhe gatishmëria e tyre për të dërguar përfaqësuesit e tyre në këtë kongres.<sup>121)</sup> Vetëm aristokracia feudale turkomane dhe reaksioni klerikal i lidhur me të, si edhe intelektualë të tillë si Faik Konica që qëndronin në pozita anti-kombëtare dhe reaksionare, u shprehën kundër thirrjes së kongresit për njësimin e alfabetit. F. Konica volli vrer kundër veprës së patriotëve shqiptarë, kundër vetë kongresit të cilin e konsideronte «një nga faqet më të zeza të historisë shqipe»<sup>122)</sup>. Demokratët revolucionarë dhe gjithë populli shqiptar i hodhën poshtë me neveri këto pikëpamje reaksionare dhe antikombëtare në çështjen e zhvillimit të gjuhës shqipe dhe i izoluan plotësisht autorët e tyre si F. Konicën me shokë. Duke vazhduar qëndrimin e vet reaksionar dhë antishqiptar, edhe shoqëria e jezuitëve të Shkodrës nuk pranoi të dërgonte përfaqësuesit e vet në Kongresin e Manastirit.<sup>123)</sup>

121) Po aty. F. Klubi Shqiptar «Bashkimi» i Manastirit, D. 5, fl. 148, 283; D. 6 fl. 221, D. 6, dok. 48, D. 6, fl. 170, Dok. 84; Fondi: Shoqërítë kulturale «Drita», «Dituria», «Bashkimi», D. 77.

122) Po aty. F. L. Nosi, D. 55/2, fl. 157; Oakley City, 27/X/1908. Letër e F. Konicës dërguar L. Nosit.

123) Po aty. F. Klubi Shqiptar «Bashkimi» i Manastirit, D. 8, Dok. 50092, D. 10, fl. 387.

Elementët reformistë si M. Frashëri, A. Ypi, F. Ypi e të tjera synonin t'i kufizonin punimet e Kongresit të Manastirit vetëm në çështjen e alfabetit dhe ta lagonin atë nga problemet e tjera politike; ata i mbaheshin pikëpamjes se «duhet përpjekur jo me pushkë e barut, por me pendë»<sup>124)</sup>. Këto tendencia u kundërshtuan nga patriotët shqiptarë dhe në mënyrë të veçantë nga klubi shqiptar i Shkupit<sup>125)</sup>, si dhe nga shqiptarët e Amerikës nëpërmjet Fan Nolit<sup>126)</sup> dhe Sotir Pecit, të cilët kërkuau që Kongresi i Manastirit të mos merrej vetëm me çështjen e njësimit të alfabetit, por të diskutonte dhe të zgjidhët edhe çështjet e tjera politike, që qëndronin përpara lëvizjes kombëtare shqiptare. Dhe me të vërtetë Kongresi i Manastirit, krahas me njësimin e alfabetit, shtrói edhe çështje të tjera politike të rëndësishme të lidhura me luftën kundër regjimit xhon-turk për të drejtat kombëtare të shqiptarëve.

Vendimi mbi thirrjen e Kongresit të Manastirit pati jehonë të madhe edhe në shtypin evropian. Gazetat franceze, italiane, svicerane etj. shkruanin se shqiptarët do të mblidheshin në kongres për qëllime politike, se kishin ndërmend të diskutonin çështjen e pavaresisë<sup>127)</sup> dhe se problemet e literaturës ishin vetëm pretekst<sup>127)</sup>, se «kongresi mund të shndërrohej në një bashkim politik dhe se shqiptarët do të japid

124) Po aty, D. 7, fl. 9, Dok. 50086.

125) Po aty, D. 6, fl. 255.

126) Po aty, D. 80.

127) Po aty. Fondi Th. Germanji, D. 17. Archives du Ministère des affaires étrangères. France. Correspondance politique. Turquie, Politique Intérieure, Albanie. Vol. VII. Informacion i konsullit francez në Manastir, 21 tetor 1908.

besën se do të luftojnë me armë në dorë për të mbrojtur të drejtat e tyre...»<sup>128)</sup> Shtypi i qarqeve shoviniste bullgare, serbe, malazeze, i tërbuar nga vendimi për thirrjen e kongresit për alfabetin, filloj fushatën e shpifjeve kundër popullit shqiptar duke propaganduar se shqiptarët janë barbarë dhe të pa-qytetërueshëm<sup>129).</sup>

\* \* \*

Si rezultat i punës së madhe përgatitore dhe organizative, që zhvilloi klubin Manastirit dhe kllubet e shoqëritë e tjera shqiptare, më 14 nëntor të vitit 1908 u hap në Manastir Kongresi për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe; ai vazhdoi punimet gjer më 22 nëntor. Në Kongres morën pjesë 32 delegatë me të drejtë vote, që përfaqësonin 26 qytete dhe shoqëri të ndryshme shqiptare brenda dhe jashtë atdheut. Meqenëse çdo klub ose shoqëri kishte të drejtë të dërgonte në Kongres 2 delegatë, 32 delegatët kishin 52 vota (disa prej tyre kishin nga 2 vota). Përveç këtyre, në Kongres asistuan gjithashtu edhe 18 delegatë të tjerë si pjesëmarrës pa të drejtë vote; në këtë mënyrë në Kongresin e Manastirit morën pjesë gjithsejt 50 delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë, nga qytetet e vilajeteve të Shkodrës, të Kosovës, të Manastirit dhe të Janinës, si edhe nga shoqëritë shqiptare të Sofjes, të Bukureshit, të Konstancës, të Amerikës, të Egjiptit, të Italisë etj.

Përbërja shoqërore e delegatëve të Kongresit

128) AShRPSSh, F. Klubi «Bashkimi» i Manastirit, fl. 2.

129) Po aty, F. Th. Gërmjenji, D. 17.

ishte e ndryshme dhe pasqyronte përbërjen heterogjene të vetë lëvizjes kombëtare shqiptare, rrymat dhe tendencat e saj të ndryshme. Në Kongres u përfaqësuan si rryma demokratike, ashtu edhe rryma liberale-reformiste. Në këtë mënyrë krahas me luf-tëtarët e çetave të armatosura shqiptare të parare-volucionit dhe, në përgjithësi, me demokratët shqip-tarë siç ishin Bajo Topulli, Çerciz Topulli, Mihal Gramenoja, Luigj Gurakuqi, Sotir Peci, Shahin Kolonja, Thoma Abrami etj., gjejmë në Kongres edhe përfaqësuesit e rrymës liberale-reformiste me tendencia pro-turke, siç ishin Midhat Frashëri, Abdyl Ypi etj., si edhe përfaqësues të reaksionit klerikal katolik si Gj. Fishta.

Përbërja shoqërore heterogjene e Kongresit të Manastirit dhe, si rrjedhim i saj, mungesa e unitetit programatik dhe organizativ të lëvizjes kombëtare shqiptare ndikuau drejtpërsëdrejti në karakterin e vendimeve që mori Kongresi për çështjen e alfabetit si edhe për problemet e tjera politike, që u diskutuan në të.

Ashtu siç pritej, vendin kryesor në punimet e Kongresit të Manastirit e zuri çështja e vendosjes së një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Çështja e alfabetit ishte në radhë të parë një çështje politike, sepse mungesa e një alfabeti të përbashkët, siç u vu në dukje edhe më sipër, ishte një pen-gesë e madhe për bashkimin e gjithë shqiptarëve pa dallim krahine dhe feje dhe për përparimin e mëtejshëm të kombit.

Rrethanat politike, në të cilat u mblohd Kongresi, si edhe përbërja heterogjene e kongresistëve nuk jepnin mundësi për një zgjidhje të plotë të pro-blemit në shqyrtim. Dhe, në të vërtetë, në kushtet e

sundimit dhe të ndërhyrjes së huaj si edhe të dasive krahinore e fetare ishte e vështirë që punimet e Kongresit të kurorëzoheshin me sukses të plotë. Megjithatë, u arrit një sukses i rëndësishëm në rrugën e zgjidhjes së çështjes së alfabetit e kjo u bë e mundur në radhë të parë nga presioni i madh, që ushtruan qarqet patriotike të Shqipërisë si edhe të kolonive shqiptare të mërgimit, që me anë të përfaqësuesve të tyre në Kongres si edhe me anë lettrash e telegramesh i detyruan kongresistët të përpinqeshin për të mos u larguar nga Manastiri pa e zgjidhur çështjen e alfabetit.

Duke marrë parasysh kushtet, në të cilat u mblodh, si edhe vështirësitë e mëdha, që paraqiste në atë kohë zgjidhja e problemit të një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët, Kongresi i Manastirit konsiderohet si një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë së popullit tonë, si një ngjarje që e forcoi dhe e çoi më tej lëvizjen tonë kombëtare në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit XX. Për të parën herë pas Lidhjes së Prizrenit përfaqësues nga të gjitha krahinat e Shqipërisë u mblodhën në një Kongres, ku kuvenduan për nevojën e bashkimit të gjithë shqiptarëve dhe për zgjidhjen e një problemi aq të rëndësishëm, siç ishte ai i alfabetit të përbashkët të gjuhës shqipe.

«Në kushtet e terrorist otoman — shkruan shoku Enver Hoxha — nuk ishte lehtë të bëje atë që bënë ata, të shkruaje, të shtypje e të dërgoje në Shqipëri mijëra abetare e libra të tjerë, të hapje shkollën e parë shqipe më 1887, të organizoje një Kongres të tërë si ai i Manastirit për caktimin e alfabetit unik shqip. Dhe të tëra këto patën pa dyshim reperkusione të mëdha, të cilat gjetën pasqyrimin e tyre më të

mirë në rritjen e vrullshme të lëvizjes revolucionare dhe të kryengritjes së armatosur»<sup>130).</sup>

Mbledhjet e dy ditëve të para të Kongresit, në të cilat qenë të pranishëm përvetë delegatëve edhe shumë shqiptarë të tjerë, ashtu siç ishte parashikuar, u morën me diskutimin e përgjithshëm të problemit. Të gjithë ata që e morën fjalën, vunë në dukje nevojën e ngutshme për t'i gjetur një zgjidhje problemit të alfabetit.

Nga diskutimet e delegatëve doli e qartë se alfabeti, që do të vendosej, duhej të kishte si bazë alfabetin latin. Mbi bazën e këtij alfabeti ishin formuar të tri alfabetet më të përdorura të kohës — alfabeti i Stambollit, alfabeti i shoqërisë «Bashkimi» dhe ai i shoqërisë «Agimi», të Shkodrës. Edhe shumica dërmuese e botimeve shqipe në vende të ndryshme të botës shtypeshin me alfabetin latin. Në të tillë rrethana askush nuk mund të guxonë të ngrinte zërin e të propozonte që të merrej si bazë alfabeti arab<sup>131)</sup> ose grek, megjithëse nuk mungoi ndonjë orvatje për t'u rekomanduar shqiptarëve alfabetin grek<sup>132).</sup>

Por, sadoqë të gjithë u shprehën për bazën latine të alfabetit, që do të vendosej, pikëpamjet e delegatëve më tej nuk pajtoheshin. Diskutimet u përqendruan rreth alfabetit të Stambollit, alfabetit të «Bash-

130) Enver Hoxha. Vepra, Vell. 24, Tirana f. 10-11.

131) Por atë që s'guxonin ta bënin, në Kongres, turqit, e rinj u orvatën ta realizonin pas Kongresit, duke u munduar t'i asgjësonin vendimet e Kongresit dhe t'u impononin shqiptarëve alfabetin arab.

132) Shih «Raportin e Kongresit shqiptar, të mbajtur në Manastir më 1/14. nëntor 1908» të Gjergj Qiriazi (H.H.St. A.P.A.A., Manastir, 20 janar 1909), f. 11.

kimit» dhe atij të «Agimit». Një propozim, që meriton të përmendet, është ai që bëri Hil Mosi, delegat i shoqërisë «Gegëni» të Shkodrës. Në mbledhjen e paradrekës së ditës së dytë ai propozoi të krijohej një alfabet i ri duke bashkuar të tri alfabetet më të përdorura — të Stambollit, të «Bashkimit» dhe të «Agimit». Edhe Luigi Gurakuqi, delegat i Shkodrës dhe i arbëreshëve të Italisë, propozoi që të krijohej një alfabet i ri, në mënyrë që të mos i thyhej zemra askujt<sup>133)</sup>.

Në mbledhjen e ditës së tretë (16 nëntor), që ishte e rezervuar vetëm për delegatët e Kongresit, u diskutua përsëri për zgjidhjen e problemit të alfabetit dhe më në fund u vendos që të zgjidhej një komision prej 11 vetësh, ku të bënин pjesë përfaqësues të alfabeteve të Stambollit, të «Bashkimit» dhe të «Agimit». Këtij komisioni, që u zgjodh me vota të fshehta, iu dhanë fuqi të plota për të vendosur një alfabet, të cilin të gjithë delegatët e Kongresit u zotuan se do ta pranonin si një alfabet të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Në fund të kësaj mbledhjeje u vendos që komisioni i alfabetit të fillonte nga puna që të nesermen, më 17 nëntor.

Për mbledhjet me dyer të myllura, që bëri komisioni i alfabetit gjatë tri ditëve (17-19 nëntor 1908), mungojnë të dhëna të qarta dhe të plota. Në shtypin shqiptar të kohës flitet vetëm për zhvillimin e këtyre mbledhjeve pa dhënë ndonjë sqarim tjetër përvëç vendimit unanim, që shpalli vetë komisioni. Por nga formulimet e përgjithshme dhe, ndonjëherë jo fort të qarta, të këtij vendimi lindin një varg pikëpyetjesh, që mbeten pa përgjigje. Këto mund të sqat-

133) «Liria», 8.XI.1908.

roheshin bindshëm, po të kishim procesverbalet e mbledhjeve me dyer të myllura të komisionit. Por nuk dimë se ç'fat kanë pësuar këto procesverbale. Në Arkivin e Shtetit të RPS të Shqipërisë ruhen vetëm ca shënimë të karakterit të procesverbalit për mbledhjen e datës 20.XI.1908 (2 faqe) dhe për mbledhjen e fundit të datës 22.XI.1908 (4 faqe)<sup>134)</sup>. Gjithashtu në të njëjtin arkiv (Fondi Th. Gërmjeni, nr. 5) ka disa shënimë për mbledhjen e pestë dhe të gjash-tën të datës 18.XI.1908, të shkruar në dialektin gegërisht me alfabetin e Stambollit. Sipas M. Domit (SF 4, 1968, 86, shën. 32), ato mund të janë shkruar nga Luigj Gurakuqi. Ai vëren se në këto shënimë ka edhe ndonjë mospërkim me të dhënat e raportit të Gjergj Qiriazit. Është fjala për «Raportin e Kongresit shqiptar të mbajtur në Manastir me 1/14 nëntor 1908» prej 20 faqesh në gjuhën anglishtë, i cili mbe-tet sot për sot i vërteti burim relativisht i plotë për mbledhjet me dyer të myllura të komisionit të alfabetit.

Nga rapporti i Gjergj Qiriazit, f. 9-12, del se në fillim, pasi anëtarët e komisionit dhanë besën se do të mbanin fshehtësinë mbi punimet, gjersa të vendos-ej puna e alfabetit, komisioni diskutoi gjerë mbi këto tri pika:

- 1) A të adoptohet njëri nga të tri alfabetet kryesore (alfabeti i Stambollit, ai i «Bashkimit» dhe ai i «Agimit»)?
- 2) A të bëhet një kombinimi i këtyre tri alfabeteve?

---

134) Shih për këtë M. Domi, Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit, SF 4, 1968, 86, shën. 30, 32.

3) A të lihen mënjanë këto të tri alfabetet dhe të krijohet një alfabet krejt i ri?

Pas shumë diskutimesh komisioni më parë vendosi që të mos merrej në vështrim asnjeri nga të tri alfabetet e lartpërmendura, por të krijohej një alfabet i ri mbi bazën e alfabetit latin duke u dhënë shkronjave latine vlera fonetike në përputhje me nevojat e gjuhës shqipe. Të gjitha shkronjat latine u shqyrtuan me kujdes dhe u pranuan, duke bërë ndryshime në vlerën fonetike të disa shkronjave. Por autori i raportit nuk jep ndonjë sqarim për këto ndryshime.

Por lidhur me shkronjat e nevojshme për ata tinguj të shqipes, që i mungonin latinishtes, (si **dh**, **gj**, **ll**, **nj**, **sh**, **th**, etj.), komisioni nuk mundi të binte nën udji. Vetëm për shkronjën, me të cilën do të pasqyrohej tingulli ndërdhëmbor **dh**, diskutimet zunë dy mbledhje të tëra pa arritur ndonjë përfundim të kënaqshëm<sup>135)</sup>. Autori i raportit nuk jep ndonjë sqarim në lidhje me mendimet e ndryshme të shprehura për këtë shkronjë. Por, duke marrë parasysh pikëpamjet e përgjithshme të anëtarëve të komisionit, nuk është vështirë të nxirret përfundimi se në këtë rast mendimet, në vija të përgjithshme, duhet tëjenë ndarë dysh. Ata që përfaqësonin alfabetin e Stambollit dhe atë të «Agimit», duhet të kenë ngulur këmbë në parimin që të mos kishte shkronja dyshe (dyshkronjë-

135) Por shënimet e ruajtura në Arkivin e Shtetit për dy mbledhjet e ditës së dytë të komisionit nuk përputhen plotësisht me këtë thënie të Gjergj Qiriazit. Sipas këtyre shënimeve, në ato dy mbledhje u diskutua për disa shkronja, që pjesërisht u vendosën (shih për këtë M. Domi, SF, 4, 1968, 87, shënimet 34, 35).

sha), kurse ata që mbronin alfabetin e «Bashkimit» duhet të kenë ngulur këmbë në të kundërtën.

Duke parë se ishte e pamundur që të binin në ujdi për shkronjat e diskutueshme dhe «të shtyrë edhe nga disa shkake të përjashtme»<sup>136</sup>), anëtarët e komisionit vendosën që «të kthehen prapa», duke pranuar alfabetin e Stambollit «e me të bashkë edhe një abece fjesht latine që të mësohen e të përdoren bashkërisht në mest të shqyptarëvet»<sup>137</sup>.

Pra, arsyet, për të cilat komisioni u shtrëngua të hiqte dorë nga krijimi i një alfabeti krejt të ri mbi bazën e alfabetit latin, qenë dy:

1) Vështirësítë e mëdha për të kapërcyer divergjencat lidhur me karakterin e shkronjave me të cilat do të pasqyroheshin tinguj të tillë, si dh, gj, ll, nj, sh, th, etj.


2) Disa shkake të jashtme.

Në vendimin e komisionit të alfabetit nuk jetet ndonjë sqarim se ç'ishin këto shkake të jashtme. Kur u shpall ky vendim në mbledhjen e hapur të Kongresit më 20 nëntor para dreke, u tha se alfabeti i Stambollit ishte i mjaftueshëm për të plotësuar nevojat e kombit, porse, që të mund të shtypeshın libra jashtë Shqipërisë si dhe për telegramë jashtë vendit, nevojitej edhe një alfabet tjetër thjesht latin<sup>138</sup>). Pra, arsyjeja e adoptimit të një alfabeti të dytë thjesht latin në mbledhjen e hapur të Kongresit

136) Nxjerrë nga vendimi i Komisionit të alfabetit të Kongresit të Manastirit.

137) Po aty.

138) Shih raportin e cituar të Gj. Qiriazit «Raporti i kongresit shqiptar...», f. 12.



### 3. Fac-simile e vendimit të Kongresit të Manastirit

u paraqit si një çështje thjesht teknike. Por, sipas mendimit tonë, arsyja e vërtetë duhet të ketë qenë tjetër e kjo del qartë nga raporti i Gjergj Qiriazit «Përse u zgjodhën dy alfabete», f. 19, ku thuhet:

«Telegramet, që morëm nga Gegëria, na kërkonin që të pranonim alfabetin e «Bashkimit», kurse telegramet nga Toskëria na kërkonin që të merrnim atë të Stambollit ose të Frashërit. Komitetit [kupto: komisionit] iu desh t'i merrte parasysh të gjitha këto letra e telegrame, sepse, po të injoronte njëren apo tjetrën palë, do të kishte një pengesë të madhe në përparimin e kombit dhe, meqë këto dy alfabetet pëndoreshin nëpër shkolla, njëri në Gegëri dhe tjetri në Toskëri, ne vendosëm njëzëri të adoptojmë dy alfabetet, atë të «Bashkimit» dhe atë të Frashërit, me disa ndryshime, sipas nevojave të gjuhës».

Pra, ka mjaft të ngjarë që «shkaqet e jashtme», për të cilat bëhet fjalë në vendimin e komisionit të alfabetit, në radhë të parë të mos kenë qenë gjë tjetër veçse presioni, që kanë ushtruar mbi komisionin qarqet e ndryshme shqiptare, që ishin për alfabetin e Stambollit apo për atë të «Bashkimit».

Komisioni vendosi që në alfabetin e Stambollit të bëheshin këto ndryshime:

1) Shkronjat e dhe ε të këmbeheshin midis tyre, duke përdorur shkronjën greke ε për zanoren ë dhe shkronjën latine e për zanoren e, kurse në alfabetin e viti 1879 ishte e kundërtë.

2) Shkronja p të përdorej me vlerën e bashkëtingëllores p, kurse në alfabetin e viti 1879 ajo kishte vlerën e bashkëtingëllores rrotulllore rr.

3) Bashkëtingëllorja rrotulllore rr të shkruhej, ashtu si në alfabetin e «Bashkimit», me shkronjën e dyzuar rr.

«Bashkëtingëllorja afrikane xh të shkruhej me gërmën konvencionale x, kurse në alfabetin e viti 1879 ajo shkruhej pak ndryshe.

Përsa i takon alfabetit thjesht latin, që komi-

sioni vendosi si alfabet të dytë për shkrimin e shqipës, që në fillim është përhapur mendimi se ai në thelb ishte alfabeti i «Bashkimit» e kështu e cilëson edhe Gjergj Qiriazi në raportin e tij «Përse u zgjodhën dy alfabete» (f. 19). Por në vendimin e komisionit ky alfabet nuk cilësohet kështu. Në të vërtetë, ky është një alfabet kompromisi.

Përhapja e një mendimi të tillë për alfabetin e dytë thjesht latin, që u vendos në Kongresin e Manastirit, do ta ketë burimin në faktin se ky alfabet i ngjan mjaft atij të shoqërisë «Bashkimi», me të cilin ka të përbashkët sistemin e shkronjave dyshe (dyshkronjëhat). Në përhapjen e këtij mendimi natyri i luajtur një rol jo të vogël edhe vetë shoqëria «Bashkimi». Por nga një shqyrtim i hollësishëm i kësaj çështjeje, siç është vënë në dukje edhe më parë<sup>139)</sup>, dël e qartë se alfabeti i dytë thjesht latin i Kongresit të Manastirit, nuk është ai i shoqërisë «Bashkimi». Këto dy alfabete ndryshojnë midis tyre në jo më pak se 11 shkronja dhe pikërisht në shkronjat c, ç, e, è, gj, nj, q, x, xh, z zh; të cilat në alfabetin e «Bashkimit» paragiteshin përkatësisht me ts, ch, é, e, gh, gn, c, z, zh, x, xh.

Nga ana tjetër, edhe sistemi i dyshkronjëshave përtë plotësuar shkronjat që i mungonin alfabetit latin, nuk është një karakteristikë e posaçme e alfabetit të «Bashkimit», sepse një sistem i tillë ndeshet edhe në alfabete të tjera thjesht latine të përdorura qysm mjaft kohë më përpara. Me një sistem të tillë është ndër-

139) Shih për këtë sidomos I. Zamputi, *Kontribut për historikun e alfabetit tonë*, në *Buletin për Shkencat Shoqërore*, I, 1957, 188-199, M. Domi, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, SF 4, 1968, 90-93.

tuar p.sh. alfabeti i Vaso Pashës, i cili ndryshon nga alfabeti i sotëm vetëm në tetë shkronja (dhe pikërisht në shkronjat *c*, *ç*, *e*, *ë*, *ll*, *rr*, *zh*, *x*<sup>140</sup>). Edhe alfabeti thjesht latin i së përkohshmes «Shqipëria» të Bukureshit (1897-1899), i cili ndryshon nga alfabeti i sotëm vetëm në 8 shkronja<sup>141</sup>, është plotësuar, ndër të tjera, edhe me dyshkronjësha. Përdorimi i dyshkronjëshave, si një nga mjetet për të plotësuar alfabetin latin, ndeshet edhe në botime të tjera të përkohshme si tek «Besa» e Kajros (1904), «Pellazgu» i Kajros (1907), etj. Madje alfabeti i së përkohshmes «Besa» është shumë më afër alfabetit të dytë thjesht latin të Kongresit të Manastirit se alfabeti i «Bashkimit»<sup>142</sup>. Prandaj, edhe nga sa u tha përbledhtas këtu sipër, del e qartë se mendimi i përhapur që alfabeti i dytë thjesht latin i Kongresit të Manastirit ishte në thelb alfabeti i shoqërisë «Bashkimi», nuk është i mbështetur.

Po të shqyrtohen me kujdes të dy alfabetet e vendosura në Kongresin e Manastirit, nuk mund të mos bien në sy përpjekjet e bëra për t'i afruar ato sa më shumë midis tyre. Këtu nuk është fjala vetëm për tri ndryshimet e bëra në alfabetin e Stambollit, por edhe për përdorimin e disa shkronjave të përbashkëta në të dy alfabetet. Kështu, në alfabetin e dytë thjesht latin të Manastirit shkronjat *c*, *ç*, *j*, *q*, *x*,

140) Shih T. Osmani, Alfabeti i Pashko Vasës, SF 4, 1968, 118 v.

141) Shih I. Zamputi, art. cit., Bul. për Shkencat Shoqërore, I, 1957, 193.

142) Sipas I. Zamputit, art. cit., Buletin për Shkencat Shoqërore I, 1957, 194, ky alfabet ndryshon nga i sotimi vetëm në tri shkronja.

*y, z, u* përdorën me ato vlera fonetike, që kishin edhe në alfabetin e Stambollit. E, si rrjedhim i këtyre përpjekjeve të dy alfabetet e vendosura në Kongresin e Manastirit ndryshonin midis tyre vetëm në 9 shkronja dhe pikërisht në shkronjat *dh, ë, gj, ll, nj, sh, th, xh, zh*<sup>143</sup>.

Në vendimin e komisionit thuhej se të dy alfabetet do të përdoreshin «bashkarisht në mest të shqyptarëvet» dhe shtohej: «Mësimi ndë shkolla do të jetë i shtrënguar e i detyrueshëm përtë dyja»<sup>144</sup>.

Vendimi i komisionit të alfabetit u shpall në mbledhjen e hapur të Kongresit më 20 nëntor (dita e shtatë e Kongresit) para dreke. Salla e mbledhjes ishte e mbushur plot me shqiptarë, që prisnin me padurim të merrnin vesh përfundimet e komisionit të alfabetit. Vendimi i komisionit u miratua nga mbledhja me brohoritje.

Në mbledhjen e ditës së fundit të Kongresit (22 nëntor) mëruen pjesë vetëm delegatët, të cilët miratuan njëzëri dy rezoluta.

Në rezolutën e parë thuhej që të gjitha klubet dhe shoqërítë, që ekzistonin në Shqipëri, duhej t'i dërgonin çdo muaj nga një raport klubit shqiptar të

---

143) Shkronja është marrë, me sa duket, nga alfabeti, që ka përdorur De Rada pas vitit 1873. Edhe dyshkronjësin *gj* e ka përdorur De Rada pas vitit 1873, ndërsa dyshkronjësin *nj* ai e ka përdorur vetëm përkohësisht.

144) Gjergj Qiriazi në relacionin e tij të lartpërmendorur, f. 19, thotë: «Brenda këtyre dy vjetve, para se të mblidhet kongresi tjetër, do të kuptohet se cili [prej këtyre dy alfabeteve] do të përdoret më shumë dhe ky do të adoptohet si alfabet kombëtar».

Manastirit, i cili nga ana e tij do t'u dërgonte atyre klubeve dhe shoqërive një raport të përgjithshëm.

Në rezolutën e dytë thuhej që pas dy vjetësh (më 10 korrik 1910) të mbahej në Janinë një kongres tjetër për çështje të gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Për mbajtjen e një kongresi të tillë ishte shprehur dëshira edhe në vendimin e komisionit të alfabetit.

Në këtë mënyrë, Kongresi i Manastirit u mbyll me një zgjidhje, e cila, po të kihen parasysh kushtet politike të Shqipërisë në atë kohë, vlerësohet si një hap i rëndësishëm përpëra në rrugën e zgjidhjes përfundimtare të problemit të alfabetit të shqipes. Numri i alfabeteve që do të përdornin shqiptarët paskëtaj, u pakësua në dy dhe këto do të përdoreshin «bashkarisht». Një gjë e tillë, jo vetëm që do të lehtësonë përhapjen e arsimit e të diturisë në Shqipëri, por edhe do ta forconte më tej bashkimin e popullit shqiptar pa dallim krahine dhe feje. Vendimi i Kongresit të Manastirit, pra, ndonëse përbante një zgjidhje jo të plotë, pati një rëndësi të madhe politike për bashkimin dhe përparimin e mëtejshëm të popullit tonë.

Duke vendosur për dy alfabete, që mbështetëshin kryesisht në alfabetin latin, Kongresi i Manastirit ripohoi edhe një herë vendosmërinë e shqiptarëve për të mbrojtur individualitetin e tyre kombëtar. Ky aspekt i vendimit të Kongresit të Manastirit merr një rëndësi të veçantë, po të mbahet parasysh se jo shumë kohë pas Kongresit, turqit e rinj, që nuk ishin më pak të tërbuar se turqit «e vjetër», e hoqën fare maskën dhe u orvatën t'u impononin shqiptarëve alfabetin arab.

Por, duke e vështruar me një sy kritik vendimin e Kongresit të Manastirit, nuk mund të mos arrihet

në përfundimin se zgjidhja, që ai Kongres i dha problemit të alfabetit, qe një zgjidhje jo e plotë, e cila linte shteg për vazhdimin e përçarjes midis shqiptarëve, sepse ishte e qartë se, me gjithë vendimin përti përdorur «bashkarisht» të dy alfabetet, në Shqipërinë Veriore do të përdorej vetëm alfabeti thjesht latin<sup>145</sup>), kurse në Shqipërinë Jugore do të vazhdonte të përdorej kryesisht alfabeti i Stambollit.

Sidoqoftë, atë që nuk e çoi dot gjer në fund Kongresi i Manastirit, e zgjidhi përfundimisht vetë populli shqiptar. Alfabeti i Stambollit, duke qenë laraman, më i vështirë dhe më pak praktik për botime librash etj., me kalimin e kohës filloi të dilte jashtë përdorimit. Kurse alfabeti i dytë, që u vendos në Kongresin e Manastirit, duke qenë më homogjen, më i lehtë dhe më praktik për botime librash etj., erdhi e u përhap gjithnjë e më shumë, duke mbetur më në fund alfabeti i vetëm i përbashkët për të gjithë shqiptarët.

**Me gjithë vendin e madh, që zunë çështjet e njësimit të alfabetit në Kongresin e Manastirit, ky nuk ishte një mbledhje thjesht gjuhësore, por një kongres politik.**

Në saje të luftës së patriotëve demokratë, Kongresi i Manastirit u shndërrua në një manifestim politik të lëvizjes kombëtare shqiptare. Në mbledhjet e hapura të Kongresit u mbajtën fjalime të shumta pa-

145) Nuk dimë që alfabeti i Stambollit të jetë përdorur në Shkodër edhe pas Kongresit të Manastirit.

triotike për bashkimin e gjithë shqiptarëve, toskë e gegë, të krishterë e myslimanë<sup>146</sup>), dhe për zhvillimin e ardhshëm kulturor dhe ekonomik të Shqipërisë.

Një rëndësi të madhe politike patën diskutimet e zhvilluara në mbledhjet e fshehta, programi dhe vendimet e të cilave njiheshin vetëm nga një pakicë delegatësh dhe nuk iu njoftuan mbledhjeve plenare të Kongresit. Sipas disa të dhënave, gjatë gjithë periudhës së Kongresit duket se janë zhvilluar 6 mbledhje të tilla, në të cilat patriotët demokratë shqiptarë, duke diskutuar çështjen e qëndrimit ndaj Turqisë dhe ndaj shteteve evropiane, shfaqën mosbesimin e tyre ndaj turqve të rinj, dhe dënuan ndërhyrjen e shteteve të huaja në Shqipëri dhe në mënyrë të veçantë atë të Austro-Hungarisë dhe të Italisë, që përdornin për këtë qëllim edhe klerin katolik shqiptar<sup>147</sup>.

Objekti kryesor i diskutimeve në mbledhjet e fshehta ishin marrëdhëniet e shqiptarëve me turqit e rinj, lufta për të drejtat kombëtare të popullit shqiptar, për konsolidimin e tij kombëtar si edhe për zhvillimin kulturor dhe ekonomik të vendit<sup>148</sup>). Konkluzionet e këtyre diskutimeve dhe vendimeve, që u morën në mbledhjet e fshehta, u përfshinë në programin kombëtar prej 18 pikash, që iu dha deputitet të Korgës, Shahin Kolonjës, për ta paraqiti

146) H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Manastir, 23 nëntor 1908.

147) Po aty. Inf. i konsullit austriak në Manastir më 30 nëntor 1908 A.B. π. P. φ. π. A., D. 569 f. 164. Inf. i konsullit rus në Manastir, 27 nëntor 1908.

148) H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Manastir, 30 nëntor 1908.

tur në parlament në emër të shqiptarëve<sup>149</sup>). Programi kombëtar i aprovuar në Kongres është një nga dokumentet më të rëndësishme të Kongresit të Manastirit; në këtë dokument u pasqyruan synimet e shqiptarëve për të siguruar autonominë e vendit, sadoqë çështja e autonomisë së Shqipërisë nuk shtrohej haptazi si kërkesë e drejtëpërdrejtë.

Vendin kryesor në program e zënë kërkesat politike të lidhura me «njohjen zyrtare të kombësisë shqiptare dhe të gjuhës shqipe». Në lidhje të ngushtë me këtë kërkohej themelimi i shkollës së pavarur shqipe duke shpallur gjuhën shqipe «si gjuhë mësimimi në të gjitha shkollat shtetërore». Gjuha turke do të mësohej vetëm nga viti i katërt (si gjuhë e dytë). Parashikohej gjithashtu likuidimi i shkollave të huaja dhe shndërrimi i tyre në shkolla kombëtare shqiptare, duke i hequr ato nga administrimi i klerit dhe duke i shpallur shtetërore. Për mbajtjen e shkollave, përvèç shpenzimeve të zakonshme, që duhej të bënte shteti, kërkohej gjithashtu që të përdorej një pjesë e të ardhurave të institucioneve dhe sidomos të atyre myslimanë si edhe të ardhurat nga taksat e veçanta «për shtimin e shkollave», që duhej të vendosni këshillat administrative të sanxhaqeve dhe të vilajeteve. Një nga kërkesat më të rëndësishme në fushën e arsimit kombëtar ishte ajo e themelimit të një universiteti shqiptar. Në këtë kërkesë shprehej aspirata e popullit shqiptar dhe e rilindasve tanë për përparimin kulturor të Shqipërisë, gjë që nuk mund të realizohej kurrë as nën regjinin tiranik të turqve të rinj, as nën atë të çifligarëve dhe borgjezisë shqiptare, që i zëvendësuan ata pas vitit 1912.

149) H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Manastir, 30 nëntor 1908.

Kjo aspiratë u realizua vetëm pas çlirimt të Shqipërisë nga shfrytëzuesit e brendshëm dhe pushtuesit e huaj, pas vendosjes së Pushtetit Popullor.

Pjesë përbërëse e luftës për njohjen e kombësisë shqiptare ishte edhe kërkesa për emërimin e nëpunësve shqiptarë në të gjitha vilajetet shqiptare, zgjedhja e të gjitha organeve lokale dhe zgjerimi i kompetencave të tyre duke u dhënë edhe të drejtën e caktimit të taksave, që do të zhdukte sistemin e shitjeve së taksave, që rëndonte shumë mbi masat e popullit dhe në mënyrë të veçantë mbi fshatarësinë. Po, për këto qëllime kërkohej që shërbimi ushtarak të shkurtohej në dy gjer dy vjet e gjysmë dhe të kryhej në Shqipëri nën drejtimin e oficerëve shqiptarë të dalë nga shkollat ushtarake, që do të ngrihen në vend.

Programi përbante gjithashtu një varg kërkesash, që kishin për qëllim zhvillimin ekonomik të vendit, dhe në mënyrë të veçantë zhvillimin e kapitalizmit, për të cilin ishte e interesuar borgjezia shqiptare. Të tillë ishin kërkesat për hapjen dhe shfrytëzimin e minierave, për ndërtimin e hekurudhave nga sipërmarrës shqiptarë, për ngritjen e dy ekonomive të mëdha bujqësore në Myzeqe dhe të shkollave bujqësore që do të përgatitnin kuadrot për bujqësinë, për rregullime lumenjsh, liqenjsh etj. Për të ndihmuar zhvillimin ekonomik dhe kulturor të vendit, parashikohej gjithashtu që të gjitha burimet financiare të caktuara për ndërtime publike si për rrugët, urat dhe mjetet e tjera të transportit të lihesin në dispozicion të vetë organeve lokale, të cilave duhej t'u jepej gjithashtu edhe një pjesë e të ardhurave të përgjithshme.

Pjesa e programit ekonomik ishte edhe kërkesa

për kufizimin e depërtimit të kapitalit të huaj në ekonominë shqiptare, që kishte për qëllim të ndalon-te ekspansionin ekonomik të shteteve imperialiste dhe në mënyrë të veçantë t'i jepte mundësi borgjezisë shqiptare të shtinte në dorë tregun dhe ekonominë e vendit.

Programi kombëtar i miratuar në Kongresin e Manastirit nuk u pergjigjej, plotësisht kërkesave të lëvizjes kombëtare shqiptare në atë periudhë. Sado-që në thelb ky program përbante kërkesat tradicionale të patriotëve shqiptarë për autonominë e Shqipërisë, në të mungonin çështje të tillë si vëcimi i territoreve shqiptare dhe përcaktimi i kufijve të Shqipërisë, forma e qeverisjes së saj etj. Përveç kësaj, ky program qe akoma larg synimeve të pjesës më të përparuar të demokratëve-revolucionarë shqiptarë, të cilët pas revolucionit të turqve të rinj shtruan kërkesën e shkëputjes së Shqipërisë nga Turqia, dhe të vazhdimit të luftës së armatosur për lirinë e atdheut.

Megjithëse në program parashikoheshin një varg kërkesash ekonomiko-shoqërore dhe kulturore, që ishin në interes të shtresave demokratike të popullit, në të mungonte një kërkesë e tillë siç ishte çështja agrare, që ka të bëjë me realizimin e aspiratave të masave të gjera të fshatarësise dhe i injep lëvizjes një karakter masiv dhe antifeudal.

Këto nuk ishin vetëm dobësi të programit kombëtar të miratuar në Kongresin e Manastirit, por para së gjithash dobësi të lëvizjes kombëtare shqiptare në atë periudhë dhe shpjegohen me kushtet ekonomiko-shoqërore dhe politike, në të cilat zhvillohet kjo lëvizje dhe pikërisht me prapambetjen e përgjithshme të vendit tonë dhe me zhvillimin e pamjaftueshmëm të borgjezisë dhe të proletariatit.

me sundimin e zgjedhës mesjetare turke, që mbësh-tetët në politikën e asimilimit më të egër, të shfaros-jes në masë të popullsisë, dhe me obskurantizmin fetar. Të gjitha këto pengonin ngritjen e ndërgjeg-jes politike të masave punonjëse, nxirrin në plan të parë domosdoshmérinë e luftës kundër politikës shfarosëse dhe shkombëtarizuesë të sunduesve osman-në dhe errësonin çështjet e rëndësishme shoqëroro-ekonomike. Këto ndikuan kështu në zhvillimin e lëvizjes kombëtare shqiptare, e cila nuk mundi të ngrihej atëherë gjer në shkallën e një revolucioni demokratik antifeudal dhe antiimperialist.

Në lidhje të ngushtë me këto kushte objektive ekonomiko-shoqërore qëndron edhe lufta midis dy rrymave në lëvizjen kombëtare shqiptare, që u pas-qyrua si në diskutimet e Kongresit ashtu edhe në vëndimet e tij. Ndërsa patriotët demokratë qëndronin në pozitat e luftës kundër regjimit xhonturk për autonominë dhe çlirimin e Shqipërisë nga zgjedha turke, reformistët synonin ta kufizonin lëvizjen kombëtare shqiptare dhe ta futnin në rrugën e bash-këpunimit me turqit e rinj. Për këtë dëshmojnë edhe fjali met, që mbajtën në Kongres përfaqësuesit e rrymës reformiste, ndër të cilët edhe ato të A. Ypit, Selahedin beut, Gj. Fishtës etj., mbi bashkëpunimin me komitetin «Bashkim e Përparim» dhe të mirat e kushtetutës turke<sup>150)</sup>. Vetë programi kombëtar i Kongresit, në këto kushte, ishte produkt i luftës dhe i kompromisit midis këtyre dy rrymave.

Megjithatë, miratimi i këtij programi pati rën-dësi të madhe, sepse i përbysi orvatjet e turqve të rinj dhe të agjentëve të tyre për ta kufizuar

150) AShRPSSh, F. Klubi i Manastirit, D. 2, fl. 281.

Kongresin vetëm me çështjet e alfabetit dhe për ta mbajtur larg problemeve politike dhe luftës kundër regjimit xhonturk. Miratimi i programit kombëtar tregoi gjithashtu se lëvizja kombëtare shqiptare kishte ruajtur karakterin e saj politik dhe të pavarrur edhe pas shpalljes së kushtetutës, se përpjekjet e turqve të rinj për ta futur atë në rrugën e bashkëpunimit me regjimin e tyre po dështonin.

Po kështu dështuan edhe planet e tyre për t'u imponuar klubeve dhe shoqërive shqiptare udhëheqjen politike, dhe organizative të klubit të Stambollit, krerët ë të cilat qëndronin në pozitat e bashkëpunimit me turqit e rinj. Për të propaganduar bashkëpunimin e shqiptarëve me turqit e rinj, komiteti «Bashkim e Përparim» dërgoi në fund të punimeve të Kongresit përfaqësuesit e klubit shqiptar të Stambollit, Haxhi Vildanin, Fazil Pashë Toptanin dhe Riza beun (Ohrin), të cilët këshilluan (dhe u bënë thirrje shqiptarëve për unitet me turqit e rinj<sup>151</sup>). Pas diskutimesh dhe një lufte të ashpër midis patriotëve demokratë dhe elementëve reformistë proturq u hodh poshtë përpjekja për të konsideruar si qendër drejtuese të klubeve, dhe të shoqërive shqiptare klubin e Stambollit, dhe u vendos që të shpalloj si klub qendror klubit «Bashkimi» i Manastirit, me të cilin duhej të mbanin lidhje të gjitha klubet e tjera. Meqenëse klubit «Bashkimi» i Manastirit qëndronte në radhët e para të luftës për shkrimin dhe shkollën shqipe, për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare dhe bashkimin e shqiptarëve në luftën përliri, zgjedhja e tij si klub qendror mund të konsiderohet si një fitore e lëvizjes kombëtare shqiptare.

---

151) H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Manastir, më 23 nëntor 1908.

#### **4. LUFTA E POPULLIT SHQIPTAR KUNDËR REAKSIONIT XHONTURK PËR SHKRIMIN DHE SHKOLLEN SHQIPE PAS KONGRESIT TË MANASTIRIT (1908-1910)**

Kongresi i Manastirit i dha një hov të mëtejshëm luftës së popullit shqiptar kundër regjimit xhonturk dhe në mënyrë të veçantë luftës për shkollen dhe shkrimin shqip. Në fund të vitit 1908 dhe në fillim të 1909-ës patriotët shqiptarë vazhduan të përhapnin shkollat dhe shkrimin shqip në të gjitha anët e Shqipërisë. Kështu klubi i Elbasanit siguroi në këtë periudhë futjen e gjuhës shqipe në të gjitha shkollat e qytetit. Patriotët shqiptarë ngritën gjithashtu një kurs nate të gjuhës shqipe që ndiqej nga 60 djem pranë shkollës filllore të komunitetit ortodoks (shkolla greke) në Elbasan. Klubi dërgoi gjithashtu 3 mësues shëtitës në Shpat, ku jepnин mësim shqip secili në 10 fshatra.

Me përpjekjet e klubeve shqiptare mësimi i gjuhës shqipe u fut edhe në shkollat qeveritare të Gjirokastrës, (në fillim të vitit 1909). Në Korçë dhe në Kolonjë patriotët shqiptarë në shenjë proteste kundër ndalimit të futjes së gjuhës shqipe në shkollat e qytetit mbyllën shkollen turke dhë greke. Po-

pulli kërkoi që gjuha shqipe të përdorej edhe në gjykatat<sup>152)</sup>. Në përgjithësi lufta për shkollën dhe shkrimin shqip ishte pjesë e luftës për njohjen e kombësisë shqiptare dhe për të drejtat e saj. Kështu klubi i Elbasanit në dhjetor të vitit 1908, duke luftuar kundër pengesave që turqit e rinj u nxirrin shkollave shqipe, u propozoi të gjitha klubeve shqiptare që t'i paraqitnin parlamentit turk kërkësen kategorike për njohjen zyrtare të kombësisë shqiptare si masa e domosdoshme për sigurimin e të drejtave më elementare kombëtare<sup>153)</sup>. Shkolla dhe shkrimi shqip po përhapeshin me shpejtësi edhe në Kosovë, veçanërisht në Gjakovë.

Përhapja e shkollave dhe e shkrimit shqip si pjesë e lëvizjes kombëtare u bë në luftë të ashpër me reaksionin xhonturk dhe klerikal. Një nga mjetet kryesore, që përdorën turqit e rinj për të ndaluar përhapjen e shkollës dhe të shkrimit shqip, për të penguar ngritjen e ndërgjegjes kombëtare dhe bashkimin e shqiptarëve në luftën kundër reaksionit turk, për t'i përcarë ata në bazë të dasisë fetare, që propaganda e tërbuar për shkrimin e gjuhës shqipe me alfabetin arab. Kjo propagandë filloi menjëherë pas Kongresit të Manastirit. Duke dëgjuar zërin e deputetëve shovinistë turq, që kërkonin në shtypin turk shkrimin e gjuhës shqipe me shkronja arabe, ministria e arsimit urdhëroi që në gjithë vilajetin e Kosovës gjuha shqipe të shkruhej me germa arabe.

152) Archives du Ministère des affaires étrangères. France. Correspondance politique. Turquie. Politique intérieure. Albanie. v. VII, Informacion i konsullit francez në Manastir, shkurt 1909.

153) AShRPSSh, F. Klubi shqiptar «Bashkimi» i Manastirit, D. 6, fl. 143.

I njëiti urdhër iu dha në fillim të shkurtit të vitit 1909 gjimnazit të Elbasanit<sup>154</sup>).

Po kështu vepruan autoritet turke dhe komitetet xhonturke në Janinë, në Filat etj. duke kërkuar me forcë e kërcënime mësimin e gjuhës shqipe me shkronja arabe. Kjo fushatë e tërbuar antishqiptare u shoqërua edhe me përpjekjet për të provokuar ndonjë miting të elementeve fanatikë turkomanië kundër përdorimit të alfabetit latin, siç ndodhi në Manastir, Dibër, Përlepe, Follorinë. Sikurse pohon konsulli francez në Manastir, «në këto mbledhje të provokuara në mënyrë sekrete nga vetë autoritetet turke nuk u grumbulluan veçse hoxhallarët dhe vetë turqit fanatikë, ndërsa shqiptarët në mënyrë të përgjithshme nuk pranuan të duken atje»<sup>155</sup>. Nuk qe irastit edhe fakti që të gjitha këto të ashtuquajtura mitingje u zhvilluan nëpër xhami; kleri reaksionar mysliman qe bashkëpunëtori kryesor i turqve të rinj në politikën e tyre antishqiptare. Kështu ulema të dhe hoxhallarët e Shkodrës, sipas udhëzimeve të turqve të rinj, zhvilluan në Shkodër dhe gjatkë një agitacion të madh kundër përdorimit të alfabetit latin<sup>156</sup>.

Për të maskuar propagandën e tyre kundër shkollës dhe shkrimit shqip, Komiteti qendror xhon-

154) AShRPSSh, F. Klubi shqiptar «Bashkimi» i Manastirit, D. 6, fl. 142.

155) Archives du Ministère des affaires étrangères, France. Correspondance politique. Turquie. Politique intérieure — Albanie. v. VII. Informacion i konsullit francez në Manastir, 16 shkurt 1909.

156) H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Shkodër, 16 prill 1909.

turk «Bashkim e Përparim» botoi në mars të vitit 1909 deklaratën e vet demagogjike, në të cilën thuhej se komiteti «do të qëndrojë neutral dhe nuk do të ndërhyjë në çështjen e zgjedhjes së alfabetit të gjuhës shqipe»<sup>157)</sup>. Një deklaratë e tillë e xhemijetit të Stambollit iu dha të gjitha klubeve shqiptare; me gjithatë, ajo nuk pati asnje efekt qetësues dhe u konsiderua si një intrigë e re dhe përpjekje për të mashtruar shqiptarët<sup>158)</sup>.

Politika turkizuese e komitetit «Bashkim e Përparim» kundrejt shkollave dhe shkrimit shqip zbuloi para popullit shqiptar thelbin reaksionar të regjimit xhonturk dhe i acaroi marrëdhënet midis shqiptarëve dhe turqve të rinj.

Patriotët shqiptarë u rezistuan me vendosmëri përpjekjeve të turqve të rinj për të ndaluar përrahjen e shkollës dhe të shkrimit shqip si edhe lëvizjen kombëtare në përgjithësi. Në përgjigjen, që i dërgoi klubit të Filatit më 7 mars të vitit 1909, klubi «Bashkimi» i Manastirit shkruante: «Mos u trembni nga kërcënimet e tyre, por i qëndroni besnikë detyrës... Në qoftë se armiqtë nuk pushojnë së vepruari... dhe në qoftë se thika ka prekur eshtën, atëherë mendoni se ju jeni shqiptarë dhe me armët në dorë mbroni të drejtat dhe nderin tuaj»<sup>159)</sup>. Edhe në përgjigjen dërguar klubit «Dituria» të Korçës klubit «Bashkimi» i Manastirit shkruante se «askush nuk

---

157) AShRPSSh, F. Klubi «Bashkimi» i Manastirit, D. 7, fl. 11, Dok. 50109.

158) H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Vlorë, 5 prill 1909.

159) Po aty. Informacion i konsullit austriak në Manastir, 7 mars 1909.

duhet të guxojë që të na ndalojë çeljen e shkollave dhe të mësuarit e gjuhës sonë. Megjithatë kush guxon, është armik e tradhtar. Kundër këtyre tradhtarëve nuk duhet të veprojmë vetëm me penë, por edhe me armë. Ne nuk duhet të frikësohem nga këto kërcë-nime barbare... Ne duhet të përdorim më në fund edhe armët për të mbrojtur të drejtat tona»<sup>160)</sup>.

Në gjysmën e dytë të vitit 1909 u shtua edhe më shumë reaksioni xhonturk kundër lëvizjes kombëtare shqiptare; turqit e rinj kaluan në sulm të hapur dhe filluan likuidimin e klubeve shqiptare, që drejtonin luftën e popullit kundër sundimit turk. Në maj të vitit 1909 turqit e rinj, pasi burgosën një pjesë të anëtarëve të klubit «Labëria» të Vlorës, ndërsa pjesën tjeter e detyruan të arratisej, e likuiduan klubin e Vlorës, që ishte një nga qendrat më të rëndësishme drejtuese të lëvizjes kombëtare në Shqipërinë e Jugut<sup>161)</sup>. Po kështu vepruan edhe me klubin e Ohrit, kryesinë e të cilit e quan lidhur në Manastir dhe pastaj në Stamboll<sup>162)</sup>.

Për të likuiduar të gjitha klubet dhe shoqëritë shqiptare, turqit e rinj miratuan në parlament, në korrik të vitit 1909, vendimin mbi mbylljen e klubeve shqiptare. Ky vendim shkaktoi zemërim dhe protesta të mëdha në Shqipëri. Klubi i Elbasanit më 29 korrik 1909 protestoi pranë kryesisë së senatit dhe të parlamentit për këtë vendim antishqiptar dhe njoftoi klubet e Selanikut, Manastirit, Shkupit, Janinës që me klubet, që kishin nën vartësinë e ty-

---

160) H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Manastir, 7 mars 1909.

161) AShRPSSh, F. Klubi «Vllaznia» në Elbasan, fl. 25.

162) Po aty.

re, t'i bënin një protestë të përbashkët parlamentit<sup>163).</sup>

Në fund të korrikut të vitit 1909 turqit e rinj vendosën të likuidonin klubin shqiptar të Tiranës në kohën kur ky filloi të zgjeronte veprimtarinë e vet patriotike, duke hapur një shkollë nate shqipe dhe duke futur gjuhën shqipe në të gjitha shkollat qeveritare të qytetit. Më 23 korrik, kur do të inauguroheshin këto punë, komiteti lokal xhonturk, në bashkëpunim me klubin e oficerëve të Tiranës dhe të Durrësit dhe me autoritetet lokale, organizoi një grusht rrugaçesh dhe fanatikësh proturq, që sulmu-an klubin dhe gjithë patriotët dhe simpatizantët e lëvizjes kombëtare. Në këtë mënyrë u likuidua edhe klubi i Tiranës. I njëjti regjim terrori u vendos edhe në Durrës dhe në qytetet e tjera të Shqipërisë. Në Gjirokastër anëtarët e klubeve shqiptare u thirrën në gjyq në Stamboll nga komiteti xhonturk<sup>164).</sup>

Patriotët shqiptarë protestuan kundër terrorist xhonturk. «Dielli» shkruante në ato ditë se «sot punërat në Shqipëri janë më keq se në kohërat e Abdylhamidit dhe gjuha shqipe ndiqet më tepër se kurrë ndonjëherë» dhe u bënte thirrje shqiptarëve «të bashkohen dhe të zënë luftën e vërtetë kundër armiqve të kombit tonë, luftën e vërtetë dhe të fundit kundër xhonturve»<sup>165).</sup>

Një hov të mëtejshëm luftës për shkollën dhe shkrimin shqip i dha Kongresi i Elbasanit, që u mblodh në javën e parë të shtatorit të vitit 1909<sup>166).</sup>

163) AShRPSSh, F. Shoqëritë e Elbasanit, Dok. 74099.

164) «Dielli» (Boston), Moti I, 17 shtator 1909, nr. 25, f. 2.

165) Po aty.

166) AShRPSSh, F. «Shoqëritë e Elbasanit».

Në këtë kongres patriotët shqiptarë treguan vendosmérinë e popullit tonë për të përhapur arsimin dhe kulturën shqipe pa marrë parasysh terrorin dhe egërsitë e turqve të rinj. Në përpunësje me vendimet e Kongresit të Elbasanit në fund të shtatorit u formua në Korçë shoqëria qendrore shkollore «Përparimi», që kishte për qëllim të ndihmonte dhe të mbante shkollën pedagogjike të Elbasanit, që u hap gjithash tu me vendim të Kongresit më 1 dhjetor të vitit 1909, si edhe shkollat e tjera shqipe. Themelimi i shkollës pedagogjike të Elbasanit për përgatitjen e mësuesve për shkollat shqipe ishte kurorëzimi i përpjekjeve të patriotëve tanë për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare për përgatitjen e mësuesve për shkollat shqipe<sup>167)</sup>.

Në shkollën normale të Elbasanit erdhën nxënës nga të gjitha anët e Shqipërisë. Nga 160 nxënës, që kishte shkolla në vitin e parë të ekzistencës së saj në maj 1910, një pjesë e mirë ishin të ardhur nga Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit. Këta dërgoheshin nga klubet shqiptare të Shkupit, Dibrës etj.<sup>168)</sup>

Shkolla shqipe u hapën në këtë periudhë edhe në qendra të tjera të Shqipërisë si në Negovan (me 40 nxënës), ku punonte mësuesi patriot P.N. Luarasi<sup>169)</sup>, në Kaninë etj. Po në këtë periudhë përfaqësuesit e popullsisë së Kurbinjt të mbledhur në Gjorm, myslimanë e katolikë, kërkuan nga autori-

---

167) AShRPSSh, F. Shoqëria «Dituria», Korçë, D. 56.

168) AShRPSSh, F. Klubi shqiptar «Bashkimi» i Manastirit, D. 8, fl. 367. H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Durrës, 27 maj 1910.

169) AShRPSSh, F. Shoqëria «Dituria», Korçë, D. 2.

tetet turke që të çelej në krahinën e tyre një shkollë shqipe<sup>170</sup>).

Shkolla dhe shkrimi shqip po përhapeshin me shpejtësi edhe në Kosovë, ku vepronë me sukses në këtë kohë klub i arsimit i krijuar në dhjetor të vitit 1908. Klubi hapi shkolla të reja shqipe në Gjilan dhe në Mitrovicë dhe siguroi futjen e mësimit të gjuhës shqipe në shkollën e mesme të Shkupit. Me përpjekjet e Hasan Prishtinës u hap në një fshat afër Vuçiternit (Posharan) një shkollë shqipe, ku shkonin fëmijët e shumë fshatrave përreth. U bënë përpjekje për të çelur një shkollë shqipe brenda në Vuçiternit<sup>171</sup>), ndërsa klub i Dibrës në fillim të vitit 1910 mori iniciativën për të hapur një numër të madh shkollash të reja shqipe.

Përhapja e mëtejshme e shkollave dhe e shkrimit shqip hasi në kundërshtimin e reaksionit xhonturk, i cili mobilizoi kundër lëvizjes kombëtare shqiptare, dhe në mënyrë të veçantë kundër klubeve dhe shkollave shqipe, gjithë aparatin shtetëror, reaksionin klerikal dhe ekspeditat ndëshkimore të gjeneralëve turq.

Duke u mbështetur në ligjin reaksionar «mbi shoqëritë» të miratuar nga parlamenti turk në vjetën e shtë të vitit 1909, që ndalonte të gjitha organizatat kombëtare përvèç atyre osmane, turqit e rinj filluan fushatën për mylljen e klubeve shqiptare në Manastir e kudo, bënë arrestime dhe internime në masë të patriotëve shqiptarë, që dërgoheshin në skajet më

170) H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak, Tiranë-Durrës, 4 shtator 1909.

171) «Dielli» (Boston), Moti I, 26 nëntor 1909, nr. 35, f. 1-2.

të largëta të Azisë së Vogël, dhe transferonin nëpunësit patriotë.

Qeveria turke kaloi tani në sulm kundër alfabetit latin dhe filloj të fuste me forcë alfabetin arab në të gjitha shkollat e vendit. Në fillim të vitit 1910 ministri turk i arsimit dhe i kultit deklaroi se «qeveria do të qëndrojë neutrale në punët e alfabetit, por në shkollat shtetërore do të verë në zbatim alfabetin arab»<sup>172)</sup>.

Në luftën kundër shkollës dhe shkrimit shqip turqit e rinj gjetën përkrahjen e elementeve turkomane, qendër e të cilëve u bë një shoqëri e vegantë (Mahfeli) e Stambollit, e organizuar në fillim të vitit 1910 dhe e kryesuar nga deputeti Haxhi Ali Elbasani. Me të u bashkuan edhe krerët e klubit të Stambollit, që u bënë së bashku organizatorë të luftës kundër alfabetit latin dhe propagandonin përdorimin e alfabetit arab për shkrimin e gjuhës shqipe, duke përgatitur për këtë qëllim edhe abetaret e para, që filluan t'i shpérndanin në Shqipëri<sup>173)</sup>. Këta shtytën edhe të ashtuquajturit 14 deputetë shqiptarë (që nuk dinin asnjë fjalë shqip) të kërkonin në parlament «në emër të shqiptarëve» futjen e alfabetit arab për gjuhën shqipe në vilajetin e Shkupit, të Manastirit dhe të Shkodrës<sup>174)</sup>. Këto veprime anti-shqiptare të reaksionarëve turkomanë shkaktuan protesta të forta nga ana e deputetëve patriotë të par-

---

172) H.H.St.A.P.A.A. Informacion i ambasadorit austriak në Stamboll, më 16 mars 1910.

173) «Kalendari Kombiar» (Sofje), Moti XV, viti 1911, f. 21-25.

174) «Lidhja ortodokse», Moti I, 27 janar 1910, nr. 17, f. 2.

lamentit dhe nga gjithë klubet shqiptare, që i dërguan telegramë qeverisë turke<sup>175</sup>).

Në bashkëpunim me elementët turkomanë si Arif Hiqmeti, dëgjues i shkollës juridike turke në Selanik, nënkyretar i klubit shqiptar të Selanikut, Mahfeli dhe kërret e klubit të Stambollit, duke u shërbypër me besnikëri reaksionarëve xhonturq, organizuan në fillim të vitit 1910 të ashtuquajturat mitingje kundër shkronjave shqipe në Shkup, Manastir, Elbasan, Gjakovë, në të cilat morën pjesë vetëm «një grusht të pasurish dhe fanatikësh turkomanë»<sup>176</sup>), që ishin të lidhur me regjimin xhon-turk. Rolin kryesor në luftën kundër shkollës dhe alfabetit shqiptar e luante kleri reaksionar mysliman, që u vu tërësisht në shërbim të reaksionit xhon-turk dhe përpiquej të mbante në errësirë dhe padije popullin shqiptar, për të penguar ngritjen e ndërgjegjës së tij kombëtare dhe çlirimin nga zgjedha turke. Duke shfrytëzuar fanatizmin e klerikëve myslimanë dhe duke shpresuar të gjente mbështetje në popullsinë myslimanë dhe ta përcante atë nga shqiptarët e krishterë, Shejh Islami dhe fill pas tij shehlerët dhe hoxhallarët mallëkuani alfabetin latin, u ndaluan myslimanëve ta përdornin atë dhe kërkonin prej tyre që ta shkruanin gjuhën shqipe vetëm me shkronjat e shenjta të kurianit<sup>177</sup>.

Në Manastir organizatorë të mitingut, që u zhvi-

175) «Kalendar Kombiar» (Sofje), Moti XV, viti 1911, f. 21-25.

176) «Shqypja e Shqypnisë» (Sofje), 2-II-1910, nr. 18, f. 3. AShRPSSh, F. Klubi shqiptar «Bashkimi» në Manastir, D. 11, fl. 46.

177) «Dielli e Flamuri» (Boston), 27 janar 1911. Volumi III, nr. 8, f. 2.

llua në xhami, qenë myderrizët dhe hoxhallarët, që hynë në konflikt me masat e popullit dhe ushtarët shqiptarë, të cilët morën në mbrojtje klubin shqiptar të Manastirit dhe shtypshkronjën «Bashkimi i kombit» duke i nxjerrë reaksionarët jashtë qytetit.

Reaksionarët klerikalë të Manastirit i bënë thirrje gjithashtu klerit, parisë dhe popullit të Elbasanit, që të ndalonin alfabetin latin dhe të përdornin atë arab<sup>178)</sup>. Hoxhallarët dhe myderrizët e tipit të Hasan efendi Isakut qenë gjithashtu organizatorë të mitingjeve të zhvilluara në xhamitë e Gjakovës dhe të Elbasanit. Një propagandë të madhe bëri Myftiu i Manastirit, Rexhep Nuredini, në bashkëpunim me fanatikët dhe klubin e oficerëve në Vlorë, në favor të alfabetit arab, por si kudo edhe këtu nuk pati sukses. Rexhep efendiu ishte njëkohësisht autor i njerës prej 3 abetareve shqipe me shkronja arabe, që qarkullonin atëhere.

Pas kësaj guvernatori i vilajetit të Janinës urdhëroi që në shkollat shtetërore të Janinës, Prevezës, Gjirokastrës, Beratit dhe Vlorës mësimi i gjuhës shqipe të bëhej me alfabetin arab<sup>179)</sup>. Përpjekje të njëjta bëri guvernatori i vilajetit të Shkodrës në Durrës, ku u orvat të mbyllte klubin shqiptar, që ishte e vëtmja qendër në këtë sanxhak, ku mësohej gjuha shqipe në kurset e natës, të hapura pranë klubit<sup>180)</sup>.

---

178) AShRPSSh, F. Klubi shqiptar «Bashkimi» i Manastirit, D. 11, fl. 40.

179) H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Janinë, më 9 mars 1912.

180) Po aty. Informacion i konsullit austriak në Durrës, 1 shkurt 1910.

Në luftën e tyre kundër shkollës dhe lëvizjes kombëtare në Shqipëri turqit e rind dhe reaksiuni klerikal mysliman patën mbështetjen e klerit ortodoks dhe katolik, që qëndronin gjithashtu në pozita anti-kombëtare dhe reaksionare.

Në periudhën kur populli shqiptar filloi të kri-jonte shtypin dhe shkollën e vet kombëtare, reaksiuni klerikal, dhe në mënyrë të veçantë priftërinjtë jezuitë të Shkodrës organizuan sulmin kundër tyre. Organi i jezuitëve të Shkodrës «Elçia i zemrës së Jezu Krishtit», i shqetësuar përpara rritjes së ndikimit të shtypit demokratik shqiptar mbi të rindjtë e Shkodrës, sulmonte gazetat dhe librat me përbajtje përparimtare dhe demokratike, duke i quajtur «të mbrapshta, që turbullojnë mendjet e njerëzve»<sup>181</sup>), «një mjet fort i keq në duert e të pazotëve, të atyne që kanë ngritun luftën kundër kishës, që prishin zemrën dhe mendjen e njeriut»<sup>182</sup>).

Qysh në ditët e para të themelimit të shkollave shqipe, të cilat nuk mbështeteshin në parimet fetare, përkundrazi bashkonin gjithë fëmijët, të krishterë e myslimanë, reaksiuni klerikal katolik filloi sulmin kundër tyre dhe kundër shkollave laike dhe propagandonte shkollat fetare të bazuara në obskurantizmin fetar katolik. «Shkollat janë laicizue fare dhe prej tyne janë largue priftërinjtë»<sup>183</sup>), deklaronin me pakënaqësi edhe shqetësim jezuitët. Ata sulmonin me tërbim shkollën shqipe dhe shpifnin kundër saj duke deklaruuar se në to përdoren libra dhe jepen mësime plot me helme<sup>184</sup>) «se shkolla pa religion asht si një

---

181) «Elçia i zemres së Jezu Krishtit», 1908, shtator, nr. 9.

182) Po aty, 1911, dhjetor, nr. XII.

183) Po aty, 1910, prill nr. IV.

184) Po aty, 1910, prill nr. IV.

pyllë me bisha t'egra»<sup>185</sup>), se «shkollat, në mos qof-shin të shenjta, janë shpellat e djallit» etj.

Reaksioni klerikal në përpjekjet e tij për ta mbajtur popullin tonë në errësirën e obskurantizmit fetar, për të penguar forcimin e ndërgjegjes së tij kombëtare dhe luftën për gjirim, synonte të vendoste kontrollin e vet në gjithë sistemin arsimor të vendit, të mbronte shkollën fetare katolike. Pikërisht në propagandën e ideologjisë reaksionare klerikale ose, siç shpreheshin vetë jezuitët, në «bashkimin dhe qindresën në veprat katolike»<sup>186</sup>) ata shihnin rrugë-daljen, dmth. mjetin më të mirë për të luftuar shkollën shqipe dhe patriotët shqiptarë, që përpinqeshin të çonin përpara kulturën demokratike dhe përparrimtare të popullit shqiptar.

Krahas me klerin mysliman e katolik edhe kleri ortodoks ishte vënë në shërbim të plotë të fuqive të huaja dhe veçanërisht të shovinistëve grekë dhe luftonte me të gjitha mjetet lëvizjen kombëtare dhe kulturore në Shqipëri. Shtypi shqiptar fliste në këtë periudhë për intrigat e grekëve dhe të dhespotit të Kosturit, që mundonte popullsinë e katundeve shqiptare. Dhespoti i Kosturit terrorizonte me bandat e andartëve, që vepronin lirisht edhe pas shpalljes së kushtetutës, popullsinë e Negovanit, Bellkamenit dhe të fshatrave të tjera që luftonin për lirinë kombëtare dhe shkollën shqipe<sup>187</sup>).

Patriotët shqiptarë, duke kuptuar plotësisht se «kleri, çështja fetare është armiku më i keq midis

---

185) «Elçia i zemrës së Jezu Krishtit», 1911, dhjetor, nr. 12.

186) Po aty, 1910, prill, nr. IV.

187) «Liria» viti II, nr. 81, 27 mars 1910.

armiqve të shumtë që ka populli ynë»<sup>188</sup>), demaskonin pa pushim «kryepriftërini të, që dërgoheshin në Shqipëri për të mbytur me gjak qdo lëvizje kulturore...»<sup>189</sup>). Shtypi shqiptar shkruante në ato ditë se «krahas me agjentët e fshehtë kleri i kishës greke haptazi me anë të fjalës së ungjillit dhe të kryqit të shenjtë po preqatit në Shqipëri idenë e mallkuar të panhelenizmos»<sup>190</sup>). Të njëjtën gjë bënte edhe kisha serbe dhe agjentët e saj në Kosovë, në Maqedoni e gjetkë.

Kjo fushatë e tërbuar e reaksionit xhonturk dhe klerikal kundër kulturës dhe lëvizjes kombëtare shqiptare në përgjithësi u thyte përparrë rezistencës së fuqishme të popullit shqiptar, i cili u ngrit në mbrojtje të shkollës dhe të shkrimit shqip si edhe të të drejtave të tij kombëtare.

Populli shqiptar dhe përfaqësuesit më të përparuar të plejadës së rilindasve tanë e shikonin luftën për shkollën dhe kulturën shqiptare si pjesë të pandarë të luftës për qirimin kombëtar nga zgjedha turke. Pra, në këtë çast kritik të shpërthimit të reaksionit xhonturk kundër shkollës dhe gjuhës shqipe populli shqiptar tregoi një vendosmëri shumë të madhe për mbrojtjen e tyre. Fakti që lufta për shkollën dhe shkrimin shqip u bë çështje e gjithë masave të popullit, bëri që të dështonin përpjekjet e turqve të rinj për t'i imponuar popullit tonë alfabetin arab dhe për të zhdukur shkollën shqipe, si masë paraprake për të shuar vetë lëvizjen kombëtare shqiptare.

188) «Korça», viti I, 10 tetor 1909.

189) «Korça», viti I, 4 shkurt 1910.

190) «E vërteta», 3/16/ prill 1911, nr. 3, f. 1.

Në radhët e para të luftës përmbrojtjen e shkrimit shqip qëndronin nxënësit dhe rinia shkollore, që ndesheshin drejtpërsëdrejti me politikën shkombëtarizuese dhe antishqiptare të turqve të rinj në fushën e kulturës. Në fillim të vitit 1910, kur qeveria turke u përpoq të fuste alfabetin arab në mësimin e gjuhës shqipe, hasi në rezistencën e vendosur të nxënësve dhe të mësuesve patriotë. Gazeta «Flamuri» shkruante në mars të vitit 1910 se nxënësit e shkollës së mesme të Korçës braktisën mësimet, posa morën vesh urdhrin e drejtorit përmësimin e gjuhës shqipe me abecenë arabe<sup>191</sup>). Shumica e nxënësve të Korçës kaloi në shkollën shqipe. Po kështu vepruan edhe vajzat «që bojkotonin shkollën greke dhe kalluan në shkollën shqipe të Korçës që u mbush plot e përplot»<sup>192</sup>). E njëjtë gjë ndodhi edhe me nxënësit shqiptarë të vilajetit të Kosovës; 16 nxënës të Shkupit u dërguan në shkurt të vitit 1910 me ndërmjetësinë e klubit shqiptar të atyshëm në shkollën normale të Elbasanit<sup>193</sup>.

Në Janinë nxënësit e shkollës së mesme turke në shenjë proteste kundër futjes së alfabetit arab në janar të vitit 1910 bojkotuan gjithashtu shkollën dhe shkuatë në klubin shqiptar përmësimin e gjuhës amtare. «Shqypja e Shqypnisë», që shkruan përmësimin e gjuhës amtare, vë në dukje se «si këta nxënës gjimnazistë edhe të tjerë në shumë qytete të Shqipërisë bojkotuan shkollat dhe protestuan kundër autoriteteve, që i detyrojnë të mësojnë gjuhën amtare me shkronja

---

191) «Flamuri» (Boston), 18-III-1910, nr. 5, f. 1.

192) «Shqypja e Shqypnisë» (Sofje), 2-II-1910, nr. 18, f. 3.

193) AShRPSSh, F. Klubi shqiptar «Bashkimi» i Manastirit, D. 8, fl. 367.

arabe»<sup>194</sup>). Dhe në të vërtetë edhe nxënësit e shkolave të Beratit protestuan kundër ndalimit të mësimit të shqipes me alfabetin latin dhe në mënyrë të përgjithshme braktisën shkollat e qytetit<sup>195</sup>). Po kështu vepruan edhe shumë mësues patriotë. «Dielli» shkruante në shkurt të vitit 1910 se mësuesi i gjuhës shqipe në gjimnazin e Durrësit nuk pranoi t'u shpërndante nxënësve abetaret me shkronja arabe, protestoi dhe dha dorëheqjen<sup>196</sup>). Edhe rinia shqiptare, që mësonte në shkollat e Stambollit, protestoi kundër futjes së alfabetit arab në mësimin e gjuhës shqipe si edhe kundër qëndrimit tradhtar të kërëve turkomanë të klubit të Stambollit, që kundërshtuan alfabetin latin<sup>197</sup>).

Populli shqiptar u ngrit i téri pér të mbrojtur shkollën dhe shkrimin shqip, kulturën e vet kombëtare kundër të gjithë reaksionarëve xhonturq dhe klerikalë. Sikurse shkruante «Drita», në ato ditë «kombi shqiptar tregoi sheshazi dhe me vepra të plota se ka etje të zhuritur pér dituri dhe kështu nga të katër çipat e Shqipërisë dolli zjarr e flakë pér mbrojtjen e diturisë»<sup>198</sup>.

Populli i Elbasanit iu përgjegj mitingut të reaktionit klerikal, të nxitur nga turqit e rinj në mbrojtje të alfabetit arab, me një manifestim masiv, që u organizua më 4 shkurt të vitit 1910 në një nga she-

194) «Shqypja e Shqypnisë» (Sofje), 2-II-1910, nr. 18, f. 3.

195) «Dielli» (Boston), Viti I, 1910, 22 prill, nr. 56, f. 1.

196) «Dielli» (Boston), 18 shkurt 1910, Vol. II, nr. 47, f. 2.

197) H.H.St.A.P.A.A. Informacion i ambasadorit austriak në Stamboll, 26-I-1911.

198) «Drita» (Manastir), Viti I, 20 Vjeshtë e dytë, 1911, nr. 40, f. 1.

shet e qytetit, ku morën pjesë 7.000 vetë, qytetarë dhe fshatarë të ardhur nga Shpati dhe katundet e tjera të Elbasanit<sup>199</sup>). Në këtë miting populli i Elbasanit tregoi vendosmërinë e tij për të mbrojtur shkollën dhe shkrimin shqip dhe protestoi pranë qeverisë dhe parlamentit kundër futjes së alfabetit arab.

Më 14 shkurt 1910 u organizua nga klubi «Dituria» një miting i madh në Korçë në mbrojtje të abecësë shqipe, ku morën pjesë 12-15.000 vetë nga qyteti dhe rrethi i Korçës, nga Kolonja, Starova, Devollli, Opari dhe nga fshatrat rreth Korçës. Mitingu qe një manifestim i vërtetë i lëvizjes kombëtare shqiptare, i luftës së popullit shqiptar kundër reaksionit xhonturk për lirinë e gjuhës dhe për të drejtat kombëtare. Në emër të popullit të mbledhur në këtë miting iu dërguan telegrame proteste kundër futjes së alfabetit arab qeverisë turke dhe deputetëve shqiptarë të parlamentit. Gazetat shqiptare të kohës, duke vënë në dukje karakterin masiv të lëvizjes, theksonin se klubi kishte mundësi të mblidhte në këtë miting 30.000 vetë, që qenë të gatshëm të vinin nga fshatrat me thirrjen më të parë.

Një karakter masiv pati edhe mitingu, që u zhvillua në Berat më 28 shkurt 1910 kundër futjes së alfabetit arab dhe për mbrojtjen e alfabetit shqip. Në të morën pjesë 15.000 vetë, nxënës, punonjës të qytetit dhe fshatarë të rretheve<sup>200</sup>). Lëvizja në Berat filloj me bojkotimin e shkollave nga nxënësit dhe përfshiu pastaj shtresat e gjera të popullit. Duke shprehur urrejtjen e vet kundër politikës shkombë-

199) «Shqypja e Shqypnisë» (Sofje), 2-II-1910, nr. 18, f. 3.

200) «Dielli» (Boston), viti I, 1910, 22 prill, nr. 56, f. 1.

tarizuese të reaksiionit xhonturk, populli dogji në mëtë qytetit abetaret e shtypura me shkronja arabe, që qenë dërguar nga Stambolli.

Në këto ditë të shkurtit të vitit 1910 vala e protestës kundër politikës reaksiionale të turqve të rinj ndaj kulturës shqiptare përfshiu të gjitha qytetet e Shqipërisë. Telegrame proteste kundër futjes së alfabetit arab dhe për mbrojtjen e alfabetit latin iu dërguan qeverisë dhe parlamentit turk në emër të popullit të Gjirokastrës (nga shoqëria «Bashkimi»), në emër të Çamërisë (nga klubi i Filatit), nga Janina, Preveza, në emër të fshatarësise së Gramshit, të popullsisë së Përmetit, Frashërit, Tepelenës, Konicës, Leskovikut<sup>201</sup>).

Popullsia e Prishtinës kundërshtoi gjithashtu me vendosmëri përpjekjet e autoriteteve turke për të ndaluar përdorimin e shkronjave shqipe dhe për t'i imponuar asaj alfabetin arab. Në një letër që i dërgohej deputetit Hasan Prishtina në emër të popullsisë e parisë së Prishtinës më 16 dhjetor 1909 thuhet se «shkronjat shqipe janë të nevojshme për të mësuar mirë gjuhën shqipe..., se përdorimi i tyre do të sjellë dobi të madhe». Populli i Prishtinës kërkonte që Hasan Prishtina të ndërmjetësonte [në parlament] që në shkollat fillore mësimet të bëheshin në gjuhën shqipe.

Vala e mitingjeve dhe e protestave, që shpërthyen në gjithë Shqipërinë në fillim të vitit 1910 për mbrojtjen e shkrimit shqip kundër alfabetit arab, ishte pjesë përbërëse e luftës së ashpër politike, që zhvillonte populli ynë kundër reaksiionit xhonturk. Kjo valë qe njëkohësisht paralajmërim i kryengri-

---

201) «Dielli» (Boston), prill 1910, vol. II, nr. 53. «Kalen-dari Korça», 1911, Moti II, f. 17-20.

tjes, që shpërtheu në Vilajetin e Kosovës në prill-maj të vitit 1910, gjatë së cilës populli shqiptar shkroi faqe të reja heroizmi në luftën për çlirimin kombëtar nga zgjedha turke.

Duke qenë të pafuqishëm të thyenin rezistençën e armatosur të shqiptarëve, hordhitë turke të Shefqet Turgut Pashës bënë shkrumb e hi fshatrat e Kosovës dhe u vërsulën me tërbim kundër patriotëve dhe lëvizjes kombëtare në Shqipërinë e Mesme. Një regjim i egër terrori u vendos edhe në Shqipërinë e Jugut. Në verën e vitit 1910 gjyqet ushtarake vepronin kudo, në Shkup, Prizren, Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Shkodër, Dibër, Peqin, Elbasan, Tiranë. Reaksiioni xhonturk u vërsul në mënyrë të veçantë kundër shkollave dhe klubeve shqiptare. Në Manastir u arrestuan drejtuesit e klubit dhe të gazetës «Bashkimi i Kombit»<sup>202)</sup>. Në të njëjtën kohë gjyqi i Dibrës vendosi të mbyllte shtypshkronjën «Bashkimi i Kombit» të Manastirit, shkollën normale të Elbasanit nën pretekstin se aktiviteti i saj ishte «i rrezikshëm për fenë dhe kushtetutën», si dhe shkollën shqipe të Korçës. U mbyllën gjithashtu gazeta «Korça» dhe gazeta të tjera shqipe.

Në kohën kur mbylleshin shkollat shqipe dhe persekutoheshin mësuesit shqiptarë, qeveria turke lejonte shovinistët grekë të hapnin shkollat e veta në fshatrat e Kolonjës, ku mësohej gjuha shqipe. Po kështu qeveria turke lejoi shovinistët serbë të ri-hapnin 300 shkolla serbe në Shqipëri dhe në Maqedoni<sup>203)</sup>. Megjithatë, as terrori i egër i turqve të rinj

---

202) H.H.St.A.P.A.A. Informacion i konsullit austriak në Selanik, 30 qershori 1910.

203) «Shkreptima» Nr. 12, dt. 5/18 dhjetor 1910, f. 2-3.

as intrigat e shteteve fqinje dhe imperialiste nuk e thyen vendosmërinë e shqiptarëve për të siguruar lirinë dhe të drejtat e tyre. Ata, pa marrë parasysh asnjë sakrificë, e vazhduan luftën e pabarabartë «me pushkë e me penë», duke treguar shembuj të rinj guximi dhe trimërie, gjersa më në fund arritën ta hiqnin qafe zgjedhën e rëndë shekullore turke më 28 Nëntor 1912, kur Kuvendi i Vlorës shpalli pavarësinë e Shqipërisë dhe formimin e shtetit kombëtar shqiptar. Kjo ishte një fitore e madhe në historinë e lavdishme të popullit tonë, që shpartalloi planet e Fuqive të Mëdha dhe të qarqeve shoviniste fqinje për zhdukjen përfundimtare të kombit shqiptar. Megjithatë, për shkak të politikës antishqiptare të Fuqive të Mëdha dhe agresionit të hapur ushtarak të shteteve fqinje trualli shqiptar u cungua rëndë duke u shkëputur prej tij vise të tëra me popullsi kompakte shqiptare.

Akti i shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë qe, pra, kurorëzimi me sukses i luftës shekullore përliri e pavarësi, luftë kjo që mori përpjesëtime më të gjera dhe një organizim më të ndërgjegjshëm sidomos në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar dhe në fillim të shekullit XX, kur vetëdija kombëtare e masave popullore të vendit tonë shënoi një rritje të madhe. E në rritjen e vazhdueshme të kësaj vetëdije kombëtare, krahas luftës së armatosur, një rol të rëndësishëm luajti pa dyshim edhe lufta për shkrimin shqip dhe për shkollën shqipe. Kjo luftë erdh e u bë edhe më e ashpër dhe më e vetëdijshme pas Kongresit të Manastirit, i cili u dha një hov të mëtejshëm jo vetëm lëvrimit të gjuhës shqipe dhe përhapjes së arsimit e të diturisë në këtë gjuhë,

por edhe përpjekjeve për bashkimin e popullit shqiptar në luftën e tij për liri e pavarësi.

Prandaj, Kongresi i Manastirit është një ngjarje me rëndësi të madhe në lëvizjen kombëtare të popullit shqiptar, në luftën e tij jo vetëm për shkrimin dhe shkollën shqipe, por edhe për lirinë e pavarësinë e Atdheut. Është e vërtetë se në rrethanat politike, në të cilat u zhvillua, Kongresi i Manastirit nuk mundi t'i conte gjer në fund çështjet që kishin të bënин me shkrimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe. Por është gjithashtu po aq e vërtetë se vendimet e tij i dhanë fund kaosit, që mbretëronte gjer atëhere në çështjen e shkrimit të shqipes dhe krijuan parakushtet për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së alfabetit të gjuhës sonë që, siç u vu në dukje edhe gjatë këtij punimi, u zgjidh më në fund nga vetë populli shqiptar me përgjithësimin e alfabetit të dytë thjesht latin, që u vendos në Manastir.

Edhe çështjet e tjera të gjuhës shqipe, që Kongresi i Manastirit vendosi të shqyrtohesin pas dy vjetësh në një kongres tjeter në Janinë, kongres ky që për shkak të rrethanave politike të kohës nuk u organizua dot, vazhduan të mbeteshin në qendër të vëmendjes së patriotëve shqiptarë. Është fjala, në radhë të parë, për çështjen e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, që ndërlikohej edhe më shumë nga mungesa e një gjuhe letrare të njësuar për të gjithë shqiptarët. Është e vërtetë se me punën e madhe të Kristoforidhit, Samiut, Naimit dhe të rilindasve të tjerë, lëvrimi i gjuhës shqipe kishte bërë mjaft hapa përparrë në të gjitha drejtimet, duke përfshirë këtu edhe vendosjen e disa normave drejtshkrimore dhe afrimin gradual të dy variantave kryesore të shqipes së shkruar. Por këto përpjekje duhenin

vazhduar, gjersa të realizohej ëndrra e patriotëve shqiptarë për krijimin e një shqipeje letrare të njësuar. Këtu nuk është rasti të vihen në dukje të gjitha përpjekjet e bëra pas Kongresit të Manastirit nga gjuhëtarët, shkrimtarët dhe arsimtarët përparimtarë shqiptarë, në luftë me forcat regresive, të përfaqësuara sidomos nga kleri katolik reaksionar, përpunimin e normave drejtshkrimore e gramatikore dhe për afrimin e të dy varianteve kryesore të shqipes së shkruar<sup>204)</sup>. Por, nuk mund të mos vihet në dukje se si rezultat i këtyre përpjekjeve dhe i qëndrimit gjuhë-dhe-arsimadashës të popullit tonë, lëvrimi i gjuhës shqipe, me gjithë pengesat e mëdha të forcave regresive të jashtme e të brendshme, bëri gjithnjë përpara.

Megjithatë, ëndrra e patriotëve tanë të së kaluarës për krijimin e një shqipeje letrare të njësuar, me norma drejtshkrimore, gramatikore dhe leksikore të përpunuara dhe të fiksuarë mirë, nuk mund të realizohej, pa u krijuar më parë kushtet e nevojshme objektive dhe subjektive. Këto kushte, për arsyet e njoitura historike, nuk mundën të krijoeshin jo vetëm në periudhën e pushtimit të huaj, por as gjatë sundimit të feudo-borgjezisë vendëse.

Vetëm pas fitores së Luftës Antifashiste Nacionallirimtare dhe të Revolucionit Popullor u krijuan kushtet e nevojshme objektive dhe subjektive përkapërcimin gradual të vështirësive, që pengonin vendosjen e një gjuhe letrare të njësuar për të gjithë shqiptarët, me norma drejtshkrimore, gramatikore e

---

204) Shih për këtë A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme të drejtshkrimit të saj*. Tiranë, 1973.

leksikore të përpunuara në përputhje me prirjet e zhvillimit të gjuhës shqipe. Siç e theksoi shoku Enver Hoxha në fjalën e 7 marsit 1968 «Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë», «ndryshime kolosale janë bërë në vendin tonë që nga koha e rilindasve e deri sot në fushën ekonomike, shoqërore, kulturore, arsimore. Shqipëria nuk është më ajo e para, as ekonomia e saj, as kultura, as arsimi, as gjuha, as regjimi, as politika, as ideologjia»<sup>204/b</sup> Ritmet e shpejta të zhvillimit të gjithanshëm të vendit tonë pas Çlirimt dhe kapërcimi revolucionari dasive të vjetra krahinore dhe fetare jo vetëm që i dhanë një shtysë të fortë zhvillimit të shpejtë e të gjithanshëm të shqipes letrare, por shtruan në rendin e ditës si një nevojë të ngutshme edhe përpunimin e normave të njësuara drejtshkrimore, gramatikore e leksikore. Përpunimi i këtyre normave gjuhësore të njësuara, në përputhje me stadin e ri të evolucionit të shqipes dhe me prirjet e zhvillimit të saj të mëtejshëm si gjuhë letrare e përbashkët për të gjithë shqiptarët, është rezultat i një pune të vetëdijshme të disa brezave gjuhëtarësh, shkrimtarësh, arsimtarësh, shkencëtarësh etj. Por kjo punë mori një formë më të organizuar dhe u kurorëzua me sukses të plotë vetëm pas Çlirimt të Shqipërisë, kur me interesimin e vazhdueshi të Partisë e të Pushtetit Popullor iu dha një rëndësi e posaçme çështjes së studimit shkencor të gjuhës sonë.

Si rrjedhim, puna e kryer gjatë disa brezave u konsakrua më në fund me vendimet historike të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, që u

---

204/b) Shih Enver Hoxha, Raporte e fjalime 1967-1968, Tiranë, 1969, f. 371-372.

mbajt në Tiranë nga 20 gjer më 25 nëntor 1972. Ky Kongres, në të cilin morën pjesë 87 delegatë nga të gjitha rrethet e vendit, përfaqësues të popullsisë shqiptare të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, si edhe përfaqësues të arbëreshëve të Italisë, qe një ngjarje e madhe në jetën shkencore e kulturore të popullit shqiptar, «një fitore e pallogaritshme në mes të aq fitoreve të tjera madhështore që ka korrur populli ynë me luftë, me përpjekje, me zotësi», siç e karakterizoi atë shoku Enver Hoxha në fjalën e mbajtur në Vlorë me rastin e 60-vjetorit të shpalljes së pavarësisë dhe 28-vjetorit të çlirimt të At-dheut<sup>205</sup>). Nga punimet e atij Kongresi doli fare e qartë se gjuha letrare shqipe, duke përbushur gjithnjë më mirë kërkesat e shumanshme të veprimtarisë shoqërore, «ka arritur një shkallë të tillë zhvillimi, që na lejon të pohojmë shkencërisht se *populli shqiptar ka tashmë një gjuhë letrare të njësuar*»<sup>206</sup>.

---

205) Shih Enver Hoxha, Raporte e fjalime 1972-1973, Tiranë 1974, f. 187.

206) Shih Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, 20-25 nëntor 1972, I, Tiranë 1973, f. 183.

## PASQYRA E LËNDES

Faqe

Parathënie .....	5
1. Dy fjalë mbi historikun e shkrimit shqip .....	7
2. Lëvizja politike-kulturore në Shqipëri në pragun e Kongresit të Manastirit .....	50
3. Kongresi i Manastirit .....	69
4. Lufta e popullit shqiptar kundër reaksionit xhon-turk për shkrimin dhe shkollën shqipe pas Kongresit të Manastirit (1908-1910). ....	94

Tirazhi 6000 kopje      Format 70x100/32      Stash 2204-72

---

Shtypur: Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «Mihal Duri», — Tiranë, 1978